REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org. / Org. Jedin / Org Unit: 013
Nr. Prot. / Br. Prof. / Prof.No.: 2148
Data: / Datum: / Date: 06.11.26
PRISHTINË / PRISHTINA NO.1

KMDK.SH.A
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C
KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD
Nr. 01/2280
Dt. 30 / 10 / 2026
Shtojce 63
Prishtinë

KMDK
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN
E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A.

PLANI I BIZNESIT (KMDK)

2027–2029

Tabela e përmbajtjes

1. Përmbledhja Ekzekutive 6
1.1 Qëllimi dhe përdorimi i planit 6
1.2 Vizioni, misioni dhe parimet 6
Vizioni 6
Misioni 6
Vlerat dhe Parimet 7
1.3 Çështjet parësore të periudhës 2027–2029 7
1.4 Përmbledhja financiare 7
2. Përshkrimi i Ndërmarrjes 7
2.1 Historia, pronësia dhe mandati 7
2.2 Korniza ligjore dhe rregullative 8
Mbikëqyrja dhe raportimi 9
2.3 Shërbimet aktuale dhe shërbimet që zhvillohen 9
2.4 Modeli dhe burimet e të hyrave 2027 - 2029 10
3. Bazat Strategjike 11
3.1 Politikat drejtuese 11
Politika e Cilësisë 11
Politika e Mjedisit 12
Parimet Themelore të Politikës së Mjedisit 13
Politika e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë 13
3.2 Harmonizimi me politikat ndërkombëtare dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 14
3.3 Parimet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në vendimmarrje 15
4. Analiza e Tregut dhe Industrisë 16
4.1 Pozita e KMDK-së në sektor 16
4.2 Palët e interesit 16
4.3 Trendet dhe mundësitë 17
4.4 Analiza PESTEL 17
5. Vlerësimi i Rreziqeve 18
5.1 Qasja ndaj identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve 18
5.2 Rreziqet ligjore dhe gjyqësore 2027–2029 19
5.3 Menaxhimi i kontesteve dhe ekspozimit gjyqësor 21
5.4 Ndërlidhja me planifikimin financiar dhe operacional 21
5.5 Prioritetet juridike për periudhën 2027–2029 21
6. Drejtimi Strategjik 21
6.1 Prioritetet dhe objektivat strategjike 21
6.2 Zhvillimi përmes projekteve dhe shërbimeve të reja 22
6.3 Fokusi i rritjes dhe zhvillimit 23
6.4 Partneritetet dhe bashkëpunimi me donatorë 24
7. Objektivat SMART dhe faktorët e që masin suksesin 25
7.1 Treguesit kryesorë të performancës 25
7.2 Matrica e KPI-ve SMART 25
7.3 Lista e aktiviteteve për periudhën trevjeçare 2027–2029 26
7.3.1 Kostot dhe mbulimi financiar i aktiviteteve 27
7.4 Miratimi dhe zbatimi i draft-rregulloreve të brendshme 27
7.5 Sfidat dhe pengesat 28
7.6 Faktorët e suksesit 28
8. Analiza SWOT 29
9. Struktura Organizative 30
9.1 Organogrami funksional 30
9.2 Qeverisja dhe mbikëqyrja 31
9.3 Struktura e stafit 31
9.4 Analiza e nevojave për ngritje të kapaciteteve 31
10. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore 32
10.1 Planifikimi i fuqisë punëtore dhe rekrutimi 32
10.4 Performanca dhe rreziku i BNj-së 32

10.5 Politikat e Burimeve Njerëzore 32
Mundësi të barabarta 32
Siguria në punë 32
Motivimi 33
11. Plani Operacional 33
11.1 Aktivitetet kryesore 33
11.2 Zhvillimi i teknologjisë dhe infrastrukturës 33
11.3 Digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve 33
12. Standardet dhe Kornizat Ndërkombëtare 34
12.1 Udhërrëfyesi i sistemeve ISO 34
12.2 Përdorimi proporcional i standardeve dhe kornizave 34
13. Investimet dhe Aktivitetet e Planifikuara 34
13.1 Programi për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV 34
Shtrirja, qeverisja dhe struktura e financimit 35
Plani i aktiviteteve 2027–2029 35
Rreziqet kritike dhe kontrolli 36
Qëndrueshmëria, ESG-ja dhe SDG-të 36
13.2 Programet e tjera zhvillimore dhe investive 36
13.2.1 Pikat ndarëse të mbeturinave 36
13.2.2 Zgjidhja për rajonin e Mitrovicës 37
13.2.3 Mbyllja dhe rikultivimi i deponisë së Mirashit 37
13.2.4 Trajtimi i fraksionit të pareciklueshëm 37
13.2.5 Rrjeti i stacioneve të transferit 38
13.2.6 Trajtimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi 38
13.2.7 Trajtimi i mbeturinave organike 38
13.3 Vlerësimi dhe miratimi i investimeve 38
14. Plani i Marketingut dhe Komunikimit 39
14.1 Qëllimet dhe rezultatet e komunikimit 39
14.2 Audiencat, temat dhe kanalet 39
16. Digjitalizimi 40
16.1 Prioritetet e të dhënave dhe sistemeve 40
17. Sasitë historike dhe projeksionet e mbeturinave 2027–2029 40
17.1 Mbeturinat komunale nga KRM dhe operatorët privatë 40
17.2 Mbeturinat për asgjësim, produktet e pakonsumueshme, dheu dhe personat fizikë 43
18. Projeksionet Financiare 44
18.1 Përmbledhje e Përgjithshme 44
18.2 Të hyrat, shpenzimet dhe rezultati para tatimit 44
18.2.1 Të Hyrat (2027–2029) 45
Baza e llogaritjes së të hyrave të planifikuara 46
18.2.2 Shpenzimet operative (2027–2029) 47
18.2.3 Pagat dhe faktorët e ndryshimit 49
18.2.4 Baza e planifikimit të shpenzimeve 49
18.2.5 Provizionet për llogaritë e arkëtueshme 51
18.3 Buxheti i Planifikuar (qarkullimi i përgjithshëm i parasë) 51
Rezervat dhe kufizimet e përdorimit të parasë 52
18.4 Programi II–IV dhe kontributi i KMDK-së në llogarinë e veçantë 53
18.6 Projektet kapitale të financuara nga KMDK 55
Pajisja për përpunimin e inerteve më 2028 56
19. Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi 56
19.2 Mekanizmi i rishikimit vjetor 56
19.3 Raportimi te aksionarët dhe palët e interesit 57
20. Përmbyllje 57
Shtojca 1. Plani i Veprimit 2027–2029 58
Veprimet prioritare 58
Shtojca 2. Afatet e zbatimit sipas tremujorëve 60
Shtojca 3. Plani i trajnimeve 2027–2029 61

Lista e Akronimeve dhe Shkurtesave

- AI – Inteligjenca artificiale.
- AMMK – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.
- BE – Bashkimi Evropian.
- BERZH – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
- BNj / HR – Burimet njerëzore.
- BoQ – Lista e sasive të punimeve, përkatësisht paramasa.
- CAPA – Veprime korrigjuese dhe parandaluese.
- CAPEX – Shpenzime kapitale.
- DF – Departamenti i Financave.
- DO – Departamenti i Operimeve.
- DPZh / DPZH – Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim.
- DS – Deponi sanitare.
- DShM – Departamenti për Shërbime Mbështetëse.
- E&S – Çështjet mjedisore dhe sociale.
- EBITDA – Rezultati para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit.
- EC – Komuniteti Evropian; shkurtesë që paraqitet në emërtimin e direktivave evropiane të cituara.
- EIA / VNM – Vlerësimi i ndikimit në mjedis.
- ESG – Aspektet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes.
- ESIA – Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social.
- FAQ – Pyetjet më të shpeshta dhe përgjigjet përkatëse.
- GIS – Sistemi i informacionit gjeografik.
- GIZ – Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit/ Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar.
- GPS – Sistemi global i pozicionimit.
- IFI – Institucion financiar ndërkombëtar.
- IFRS – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
- IPSAS – IFRSet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.
- ISO – Organizata Ndërkombëtare për Standardizim.
- IT – Teknologjia e informacionit.
- JICA – Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar.
- KfW – Banka Gjermane për Zhvillim.
- KMDK – Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë.
- KPI / IKP – Indikator kryesorë i performancës.
- KRM – Kompania Rajonale e Mbeturinave.
- LRP – Plani i Rimëkëmbjes së Jetesës.
- M&V – Matja dhe verifikimi.
- MBT – Trajtimi mekanik-biologjik i mbeturinave.
- ME – Ministria e Ekonomisë.
- MFA – Autentikimi me shumë faktorë.
- MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- MNRR / C&D – Mbeturina nga ndërtimi dhe rrënimi.
- PPM – Pajisje personale mbrojtëse.
- O&M – Operimi dhe mirëmbajtja.
- OJQ – Organizatë joqeveritare.
- OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara.
- OPEX – Shpenzime operative.
- PESTEL – Analiza e faktorëve politikë, ekonomikë, shoqërorë, teknologjikë, mjedisorë dhe ligjorë.
- PIU – Njësia për zbatimin e projektit.
- PZP / EPR – Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit.
- QR – Kod me përgjigje të shpejtë, që përdoret për identifikim dhe qasje në informacion.
- RDF – Lëndë djegëse e prodhuar nga mbeturinat.

- SDG – Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.
- Sh.A. – Shoqëri aksionare.
- Sh. mbështetëse – Shërbimet mbështetëse.
- SLA – Marrëveshja për nivelin e shërbimit.
- SMART – Objektiva specifikë, të matshëm, të arritshëm, të rëndësishëm dhe të përcaktuar në kohë.
- SMC – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.
- SMM – Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit.
- SShP – Siguria dhe shëndeti në punë.
- ST – Stacion transferi.
- STF – Stacioni i Transferit.
- SWOT – Analiza e fuqive, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve.
- TCO – Kostoja totale e pronësisë gjatë ciklit jetësor.
- TM – Tremujor.
- TM1, TM2, TM3 dhe TM4 – Tremujori i parë, i dytë, i tretë dhe i katërt i vitit.
- UA – Udhëzim administrativ.
- WBIF – Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor.
- ZKFTH – Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit.

Lista e tabelave

Tabela 1. Përmbledhja e treguesve financiarë të planifikuar për periudhën 2027–2029.
Tabela 2. Korniza ligjore dhe rregullative dhe lidhja me veprimtarinë e KMDK-së.
Tabela 3. Parimet themelore të Politikës së Cilësisë së KMDK-së.
Tabela 4. Parimet themelore të Politikës së Mjedisit të KMDK-së.
Tabela 5. Parimet themelore të Politikës së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.
Tabela 6. Lidhja e veprimtarisë së KMDK-së me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
Tabela 7. Palët e interesit, nevojat dhe mënyrat e angazhimit të KMDK-së.
Tabela 8. Analiza PESTEL e KMDK-së.
Tabela 9. Vlerësimi i rreziqeve ligjore dhe gjyqësore dhe masat për menaxhimin e tyre, 2027–2029.
Tabela 10. Prioritetet juridike për periudhën 2027–2029.
Tabela 11. Prioritetet strategjike të KMDK-së për periudhën 2027–2029.
Tabela 12. Objektivat strategjike dhe fushat prioritare të veprimit për periudhën 2027–2029.
Tabela 12a. Shërbimet e propozuara dhe produktet e periudhës 2027–2029
Tabela 13. Matrica e treguesve kryesorë të performancës (KPI) për periudhën 2027–2029.
Tabela 14. Lista e aktiviteteve të planifikuara për periudhën 2027–2029.
Tabela 14a. Lidhja e aktiviteteve me buxhetin dhe burimin e financimit
Tabela 15. Analiza SWOT e KMDK-së për periudhën 2027–2029.
Tabela 16. Udhërrëfyesi për zbatimin dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit sipas standardeve ISO, 2027–2029.
Tabela 17. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV, 2027–2029.
Tabela 18. Rreziqet kritike dhe masat e kontrollit në zbatimin e Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV.
Tabela 19. Qëllimet, rezultatet e synuara dhe treguesit e komunikimit.
Tabela 20. Audiencat, nevojat për informacion dhe mjetet e komunikimit.
Tabela 21. Prioritetet për digjitalizimin, rezultatet e synuara dhe njësitë përgjegjëse.
Tabela 22. Planifikimi mujor i sasive të mbeturinave sipas deponive dhe Stacionit të Transferit në Ferizaj, 2026–2029.
Tabela 23. Përmbledhja e sasive të mbeturinave sipas kategorive dhe deponive për periudhën 2026–2029.
Tabela 24. Planifikimi i sasive të mbeturinave për asgjësim dhe kategorive të tjera, 2026–2029.
Tabela 25. Projeksioni i të hyrave, shpenzimeve dhe rezultatit financiar për periudhën 2027–2029.
Tabela 26. Planifikimi i të hyrave sipas kategorive për periudhën 2027–2029.
Tabela 26a. Faktorët e planifikimit për kategoritë e të hyrave

Tabela 27. Planifikimi i shpenzimeve operative sipas kategorive për periudhën 2027–2029.
Tabela 27a. Baza e kostimit të shpenzimeve operative
Tabela 28. Buxheti i planifikuar i qarkullimit të parasë për vitin 2027.
Tabela 29. Struktura e planifikuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre për vitin 2027.
Tabela 30. Të hyrat e dedikuara për investime në programin për Menaxhimin e Mbeturnave të Ngurta II-IV, 2023–2027.
Tabela 30a. Referencat financiare të programit dhe kufijtë e krahasimit
Tabela 31. Planifikimi financiar i llogarisë së veçantë për Programin KfW.
Tabela 32. Projektet kapitale të planifikuara për financim nga KMDK, 2027–2029.
Tabela 33. Plani i Veprimit 2027–2029: aktivitetet, rezultatet, treguesit dhe njësitë përgjegjëse.
Tabela 34. Afatet tremujore të zbatimit të Planit të Veprimit 2027–2029 (Gantt).
Tabela 35. Plani i trajnimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve për periudhën 2027–2029.

Lista e figurave

Figura 1. Organogrami funksional i KMDK-së.
Figura 2. Tre shtyllat ESG të lidhura me kontrollin e përditshëm.

1. Përmbledhja Ekzekutive

1.1 Qëllimi dhe përdorimi i planit

Ky plan biznesi është hartuar me qëllim të ofrimit të një dokumenti strategjik dhe praktik që udhëzon zhvillimin, menaxhimin dhe rritjen e aktivitetit të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-së). Plani përshkruan vizionin, objektivat afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe masat konkrete që duhet të ndërmerren për të siguruar një funksionim të qëndrueshëm dhe konkurrues të kompanisë në treg. Plani i Biznesit 2027–2029 është dokumenti drejtues i KMDK-së për operimin, investimet, zhvillimin e projekteve, financat dhe organizimin e brendshëm. Ai e lidh planifikimin trevjeçar me buxhetin vjetor, planin e veprimit, raportimin dhe vendimmarrjen e Bordit. Projektet dhe aktivitetet për të cilat financimi ende nuk është konfirmuar mbeten në listën e propozimeve për shqyrtim dhe përgatitje të mëtejshme, duke shprehur gatishmëri për zbatimin e tyre. Këto projekte dhe aktivitete mund të zbatohen vetëm pas përfundimit të analizave të nevojshme, miratimit nga organet përkatëse dhe sigurimit të financimit.

- Për Bordin e Drejtorëve | paraqet objektivat dhe rezultatet e sunyara nga KMDK, burimet dhe kufizimet financiare, rreziqet kryesore si dhe bazen per vendimarje per monitorim dhe zbatim te planit
- Për menaxhmentin | përcakton përgjegjësitë dhe afatet për zbatimin e planit, treguesit kryesorë të performancës (KPI-të) dhe masat që duhen ndërmarrë kur rezultatet nuk arrihen sipas parashikimeve.
- Për departamentet | shërben si bazë për hartimin e planeve vjetore të punës, ndarjen e detyrave dhe raportimin e rezultateve të mbështetura në të dhëna.
- Për aksionarin | paraqet prioritetet e zhvillimit të KMDK-së, fazën e përgatitjes së projekteve dhe financimin e nevojshëm për realizimin e tyre.

KMDK do të vazhdojë të menaxhojë deponitë dhe stacionet e transferit që ka në përgjegjësi, duke punuar për zgjidhjen e problemeve ekzistuese dhe përmirësimin e kushteve të operimit. KMDK synon të sigurojë vazhdimësinë e shërbimit dhe pranimin e deponimin e mbeturinave në kushte të sigurta për shëndetin dhe mjedisin. Kujdesi për cilësinë e shërbimit dhe përmbushja e detyrimeve ndaj klientëve e partnerëve do të mbeten pjesë e punës së përditshme të kompanisë.

1.2 Vizioni, misioni dhe parimet

Vizioni

Të jemi udhëheqës për zhvillimin dhe menaxhimin e infrastrukturës moderne, të sigurtë dhe të qëndrueshme të menaxhimit të integruar të mbeturinave në Kosovë, në funksion të ekonomisë qarkore, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Misioni

Të menaxhojmë dhe zhvillojmë infrastrukturën publike të mbeturinave në mënyrë profesionale, të sigurtë dhe të qëndrueshme, duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin publik, rritur cilësinë e shërbimeve dhe siguruar përgjegjësi financiare e institucionale.

Vlerat dhe Parimet

- **Integritet** – Veprojmë me ndershmëri, paanshmëri dhe përgjegjësi, duke mbrojtur interesin publik.
- **Përgjegjësia mjedisore** – Mbrojmë mjedisin dhe shëndetin publik përmes praktikave të qëndrueshme.
- **Transparencë** – Qeverisim dhe operojmë në mënyrë të hapur, të qasshme dhe të kuptueshme për publikun dhe palët e interesit.
- **Profesionalizëm dhe efikasitet** – Ofrojmë shërbime sipas standardeve të larta profesionale dhe përdorim me përgjegjësi burimet publike.
- **Zhvillim i qëndrueshëm** – Zhvillojmë dhe modernizojmë infrastrukturën, si dhe promovojmë ndarjen e mbeturinave, reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre.
- **Bashkëpunim dhe përfshirje** – Bashkëpunojmë me komunitetin, institucionet publike, shoqërinë civile, donatorët dhe sektorin privat.
- **Llogaridhënie** – Marrim përgjegjësi për vendimet dhe rezultatet tona dhe raportojmë progresin në mënyrë të matshme dhe të verifikueshme.

Mesazhi i kompanisë

Drejt ekonomisë qarkore

1.3 Çështjet parësore të periudhës 2027–2029

- Bashkëpunimi me aksionarin, donatorët dhe organizatat për mbështetje financiare dhe teknike me qëllim të inicimit dhe implementimit të projekteve transformuese mjedisore në fushën e menaxhimit të mbeturinave.
- Profesionalizimi i vazhdueshmëm i ndërmarrjes dhe zhvillimi i stafit.
- Digjitalizimi i proceseve operative dhe administrative.
- Qeverisja korporative në përputhje me standardet më të mira të integritetit, etikës dhe menaxhimit modern publik.

1.4 Përmbledhja financiare

Për periudhën 2027–2029, të hyrat e përgjithshme planifikohen në 6.305.986 €, 6.757.865 € dhe 7.175.319 €. Rritja vjetore është përkatësisht 7,2% më 2028 dhe 6,2% më 2029; ajo nuk është një normë uniforme prej 5%. Rezultati i paraqitur më poshtë është fitimi para tatimit, jo fitimi neto pas tatimit. Financimi i investimeve, njohja e granteve në të hyra dhe disponueshmëria e parasë trajtohen veçmas në kapitullin 18.

Treguesi	2027	2028	2029
Të hyrat gjithsej (€)	6,305,986	6,757,865	7,175,319
Shpenzimet operative (€)	4,037,291	4,012,408	4,240,675
Investimet kapitale (€)	745,000	300,000	100,000
Fitimi i planifikuar para tatimit (€)	1,523,695	2,445,457	2,834,643

Tabela 1. Përmbledhja e treguesve financiarë të planifikuar për periudhën 2027–2029.

2. Përshkrimi i Ndërmarrjes

2.1 Historia, pronësia dhe mandati

KMDK Sh.A. është ndërmarrje publike qendrore në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërmarrja është themeluar në vitin 2005 dhe operon infrastrukturë për pranimin, peshimin, dhe deponimin e mbeturinave. KMDK-ja, krahas menaxhimit të përditshëm të deponive dhe stacioneve të transferit, përgatit dhe zbaton investime për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo veprimtari synon të sigurojë vazhdimësinë dhe cilësinë e shërbimit, si dhe përmirësimin e infrastrukturës në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet evropiane, duke kontribuar në përmbushjen e objektivave të integrimit evropian në fushën e menaxhimit të mbeturinave.

Periudha 2027–2029 është fazë kalimi nga një model i përqendruar kryesisht në deponim drejt një portofoli më të gjerë. Kjo përfshinë rehabilitim dhe ndërtim të infrastrukturës sipas standardeve evropiane për mbeturinat, përkujdesje e monitorim mjedisor, ndarja dhe trajtimi i mbeturinave, zgjidhje për fraksione të veçanta të mbeturinave, shfrytëzimi i mundshëm për energji dhe projekte të ekonomisë qarkore. Zgjerimi i fushëveprimtarisë bëhet me vendim të organeve kompetente dhe me model të qartë financiar e operacional.

2.2 Korniza ligjore dhe rregullative

Veprimtaria e KMDK-së mbështetet në legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe në Statutin e kompanisë. Kjo kornizë përcakton mënyrën e qeverisjes dhe organizimit të kompanisë, përgjegjësitë për menaxhimin e deponive, kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe detyrimet ndaj punonjësve. Në planifikimin e zhvillimit dhe të investimeve, KMDK-ja merr parasysh edhe drejtimet e përcaktuara në strategjinë kombëtare për menaxhimin e mbeturinave dhe standardet përkatëse të Bashkimit Evropian. Aktet dhe dokumentet kryesore paraqiten më poshtë. Direktivat e Bashkimit Evropian përfshihen si referenca për përafrimin me standardet evropiane. Detyrimet konkrete të KMDK-së përcaktohen nga legjislacioni i Kosovës dhe kushtet e lejeve përkatëse.

Akti ligjor ose dokumenti	Përshkrimi i shkurtër dhe lidhja me veprimtarinë e KMDK-së
Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 04/L-111, Nr. 05/L-009 dhe Nr. 08/L-276	Përcakton rregullat e qeverisjes së ndërmarrjeve publike dhe përgjegjësitë e aksionarit, Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit. Për KMDK-në, përbën bazën për hartimin dhe miratimin e planit të biznesit, raportimin, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen e rezultateve të kompanisë.
Statuti i Shoqërisë Aksionare "Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë" Sh.A.	Përcakton veprimtarinë dhe organizimin e kompanisë, si dhe kompetencat e aksionarit, Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit. Shërben si bazë për vendimmarrjen dhe ndarjen e përgjegjësive brenda KMDK-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare	Rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare, përfshirë shoqëritë aksionare. Për KMDK-në, zbatohet për çështjet e organizimit të shoqërisë, të drejtat e aksionarit dhe përgjegjësitë e organeve drejtuese, përveç rasteve kur Ligji për Ndërmarrjet Publike përcakton ndryshe.
Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 08/L-071 dhe Nr. 08/L-262	Përcakton rregullat për menaxhimin e mbeturinave dhe detyrimet e subjekteve që ushtrojnë këtë veprimtari. Për KMDK-në, është baza kryesore ligjore për pranimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave brenda veprimtarive të lejuara, si dhe për mbajtjen e të dhënave dhe raportimin përkatës.
Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i ndryshuar dhe plotësuar	Përcakton parimet dhe detyrimet për parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit. Për KMDK-në, lidhet me masat për kufizimin e ndikimeve nga deponitë dhe stacionet e transferit, monitorimin

Akti ligjor ose dokumenti	Përshkrimi i shkurtër dhe lidhja me veprimtarinë e KMDK-së
me ligjet Nr. 08/L-276 dhe Nr. 08/L-283	mjedisor dhe përgjegjësinë për parandalimin e dëmeve dhe sanimin e tyre.
Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 08/L-142 dhe Nr. 08/L-283	Rregullon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Në KMDK, shërben si bazë për kontratat e punës, orarin, pushimet, pagat dhe procedurat që lidhen me punësimin dhe përfundimin e marrëdhënies së punës.
Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 08/2017 për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave	Përcakton kërkesat për menaxhimin e deponive gjatë operimit dhe pas mbylljes së tyre. Për KMDK-në, shërben si bazë për procedurat e pranimit të mbeturinave, kontrollin dhe monitorimin e deponive, si dhe masat për mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes.
Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, i ndryshuar dhe plotësuar me **UA (MMPHI) Nr. 01/2025**	Përcakton kërkesat dhe procedurat për pajisjen me leje mjedisore dhe vazhdimin e saj. Për KMDK-në, lidhet me përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave për objektet dhe veprimtaritë që i nënshtrohen këtij lloji të lejes.
Strategjia 2024–2035 për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë dhe Plani i Veprimit 2024–2026	Përcakton drejtimet e zhvillimit të sektorit dhe përmirësimit të shërbimeve e të infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave. Për KMDK-në, shërben si orientim për planifikimin e investimeve dhe zhvillimin e kapaciteteve për trajtim dhe deponim, në përputhje me përgjegjësitë e kompanisë.
Direktiva 2008/98/EC për mbeturinat, me ndryshimet përkatëse	Përcakton renditjen e përparësive në menaxhimin e mbeturinave: parandalimin, përgatitjen për ripërdorim, riciklimin, rikuperimin tjetër dhe, së fundi, asgjësimin, ku përfshihet deponimi. Për KMDK-në, shërben si referencë evropiane për planifikimin e zhvillimit të shërbimeve dhe të infrastrukturës.
Direktiva 1999/31/EC për deponimin e mbeturinave, me ndryshimet përkatëse	Përcakton kërkesat evropiane për deponimin e mbeturinave dhe kufizimin e ndikimeve të deponive në shëndet dhe mjedis. Për KMDK-në, shërben si referencë për përmirësimin e kushteve teknike, pranimin e mbeturinave, monitorimin, mbylljen dhe kujdesin pas mbylljes së deponive.

Tabela 2. Korniza ligjore dhe rregullative dhe lidhja me veprimtarinë e KMDK-së.

Mbikëqyrja dhe raportimi

KMDK është subjekt i:

- Mbikëqyrjes nga Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Ekonomisë.
- MMPH si institucion përgjegjës për orientimin e politikave mjedisore dhe për menaxhimin e mbeturinave.
- Auditimeve financiare të cilat sigurojnë transparencë dhe përputhje me ligjin.

Përputhshmëria me kornizën ligjore dhe rregullative është thelbësore për funksionimin e qëndrueshëm të KMDK. Ajo siguron që aktivitetet e kompanisë të jenë në harmoni me objektivat kombëtare të menaxhimit të integruar dhe të qëndrueshëm të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit.

2.3 Shërbimet aktuale dhe shërbimet që zhvillohen

Lista e Shërbimeve:

Menaxhimi i Deponive Sanitare

- KMDK është kompani e autorizuar në nivel qëndror për menaxhimin e deponive sanitare të mbeturinave në Republikën e Kosovës.

Menaxhimi dhe monitorimi i Deponive të Mbyllura

- Monitorimi dhe mirëmbajtja e deponive të mbyllura për të siguruar përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe për të parandaluar ndotjen.

Menaxhimi i Stacioneve të Transferit

- Operimi i stacioneve të transferit për mbeturinat, duke lehtësuar transportin efikas drejt deponive rajonale.


Zhvillimi i Infrastrukturës për Menaxhimin e Mbeturinave

- Planifikimi dhe implementimi i projekteve për ndërtimin dhe zgjerimin e kapaciteteve të reja për menaxhimin e mbeturinave, në bashkëpunim me qeverinë dhe donatorë ndërkombëtarë.

Mbështetje për Komunat dhe Ndërmarrjet Publike

- Bashkëpunim me komunat dhe ndërmarrjet publike për të përmirësuar sistemet e menaxhimit të mbeturinave dhe për të siguruar shërbime efikase për qytetarët.

Procesi i operimit



2.4 Modeli dhe burimet e të hyrave 2027 - 2029

- **Klientët kryesorë** | Kompanitë Rajonale të Mbeturinave (KRM-të), komunat, operatorët privatë, personat fizikë të cilët dorëzojnë mbeturina në objektet që menaxhon KMDK-ja.
- **Të hyrat nga shërbimet ekzistuese** | Sigurohen nga tarifat për çdo ton mbeturinash të pranuara, tarifat për pranimin dhe trajtimin e kategorive të veçanta të mbeturinave dhe shërbimet e tjera të përcaktuara në kontrata.
- **Të hyrat nga shërbimet e reja zhvillimore** | Mund të krijohen nga ndarja dhe trajtimi i mbeturinave, trajtimi i inerteve, kompostimi dhe shfrytëzimi i gazit, sipas portofolit të seksionit 6.2. Për këto shërbime

nuk parashikohet e ardhur automatike në skenarin financiar bazë: njohja në plan kërkon kapacitet funksional, leje, kontratë ose kërkesë të dokumentuar, tarifë të miratuar dhe datë të besueshme të fillimit.

- **Burimet e financimit të investimeve** | Përfshijnë burimet vetanake të KMDK-së, kontributin e saj të dedikuar për Programin II–IV dhe financimin nga partnerët e programit. Qeveria Gjermane përmes KfW dhe Bashkimi Evropian janë partnerë financues të programit; kontributet publike vendore dhe komunale evidentohen sipas marrëveshjeve përkatëse. Grantet e tjera, asistenca teknike dhe financimi nga institucione të tjera financiare ndërkombëtare trajtohen si mundësi për aplikim, deri në nënshkrimin e marrëveshjes dhe plotësimin e kushteve të saj.

Burimi, destinimi dhe siguria e financimit përcaktohen veçmas për çdo projekt. Një kontakt me donatorin, aplikim apo studim nuk përbën financim të siguruar. Dosja financiare përmban marrëveshjen, përfituesin, shumën, komponentin e mbuluar, bashkëfinancimin, kushtet e disbursimit dhe detyrimet e operimit pas investimit. Financimi eventual me kredi paraqitet si detyrim dhe me koston e shërbimit të borxhit, jo si e hyrë nga shitja ose grant.

Ndarja e një pjese të tarifës për llogarinë e veçantë është destinim i të hyrave vetanake të KMDK-së. Transferimi ndërmjet llogarive të kompanisë nuk krijon të hyrë të dytë dhe nuk është donacion nga KfW. Tabelat 30–31 dhe shpjegimi në seksionin 18.4 e ndajnë objektivin e kontributit nga saldoja bankare dhe nga pagesat reale të projektit.

- **Kostot kryesore** | Përfshijnë pagat, karburantin për makineritë dhe pajisjet e punës, mirëmbajtjen, pajisjet për mbrojtje personale, monitorimin mjedisor, sigurimin dhe sigurimin e energjinë elektrike. Në planifikimin financiar përfshihen edhe kostot për kujdesin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e deponive pas mbylljes.

3. Bazat Strategjike

3.1 Politikat drejtuese

Politikat e cilësisë, mjedisit dhe sigurisë e shëndetit në punë udhëheqin veprimtarinë e KMDK-së dhe zbatimin e Planit të Biznesit 2027–2029. Ato përcaktojnë parimet që ndiqen në punën e përditshme, menaxhimin e deponive sanitare dhe stacioneve të transferit, si dhe në planifikimin e investimeve.

Politika e Cilësisë

KMDK Sh.A., si kompani publike me rëndësi shtetërore, angazhohet të ofrojë shërbime të rregullta, të sigurta dhe cilësore në pranimin dhe deponimin e mbeturinave dhe në menaxhimin e objekteve nën përgjegjësinë e saj. Këto shërbime janë pjesë e sistemit të menaxhimit të integruar të mbeturinave në Kosovë dhe kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.

Duke operuar në një fushë kritike për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik, KMDK synon të jetë model i menaxhimit modern, profesional dhe transparent, në përputhje me kërkesat ligjore, rregullative dhe standardet ndërkombëtare.

Në përputhje me këtë vizion, Politika e Cilësisë është ndërtuar mbi këto parime thelbësore:

01.Fokus në klienta dhe palët e interesuara
Përmbushja dhe tejkalimi i kërkesave të qeverisë, komunave, partnerëve dhe qytetarëve.

07.Transparencë, përgjegjësi dhe besueshmëri institucionale
Veprim me integritet, llogaridhënie dhe transparencë për të ndërtuar besim afatgjatë.

POLITIKA E CILËSISË

02. Përmirësim i vazhdueshëm i proceseve dhe shërbimeve
Analizë dhe optimizim i vazhdueshëm përmes standardizimit, digjitalizimit dhe trajnimeve.

06.Zhvillim profesional dhe përfshirje e burimeve njerëzore
Trajnime, përfshirje në vendimmarrje dhe motivim i stafit për përmirësim të cilësisë.

03.Lidership dhe kulturë organizative për cilësi
Menaxhmenti siguron që cilësia të jetë prioritet në të gjitha nivelet e organizatës.

05.Përputhshmëri me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare
Zbatim i legjislacionit në fuqi dhe i kërkesave të sistemit të menaxhimit të cilësisë.

04.Marrje vendimesh të bazuara në fakte dhe të dhëna
Vendimmarrje mbi indikatorët e performancës, auditime, ankesa dhe feedback për masa korrigjuese.

Tabela 3. Parimet themelore të Politikës së Cilësisë së KMDK-së.

Politika e Mjedisit

KMDK, si kompani publike përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e deponive sanitare dhe stacioneve të transferimit nën administrimin e saj, angazhohet të parandalojë ndotjen dhe të zvogëlojë ndikimet e veprimtarisë në mjedis. Ky angazhim është pjesë e sistemit të menaxhimit dhe e objektivave të Planit të Biznesit 2027–2029.

Vëmendje e veçantë i kushtohet mbrojtjes së tokës, ujërave dhe ajrit, përmes operimit të kontrolluar, mirëmbajtjes së infrastrukturës, rehabilitimit të qelizave të vjetra dhe ndërtimit të qelizave të reja sipas kërkesave përkatëse.

Duke vepruar në një sektor me ndikim të drejtpërdrejtë në komponentët kryesorë të mjedisit, përfshirë tokën, ujin dhe ajrin, KMDK është e vetëdijshme për përgjegjësinë e saj në minimizimin e ndikimeve negative dhe në avancimin e standardeve më të larta për menaxhimin e mbeturinave.

Parimet Themelore të Politikës së Mjedisit

01. Kërkesat ligjore dhe lejet
Respektimi i kërkesave ligjore, kushteve të lejeve dhe detyrimeve kontraktuale.

07.Mjedisi në vendimmarrje
Integrimi i kërkesave mjedisore në blerje, kontrata, planifikim dhe operimin e deponive.

02.Parandalimi dhe përmirësimi
Parandalimi i ndotjes dhe kontrolli i rreziqeve mjedisore, me përmirësim të vazhdueshëm.

POLITIKA E MJEDISIT

06. Objektivat strategjike
Objektiva vjetore për infrastrukturën, reduktimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e shëndetit e biodiversitetit.

03. Burimet e qëndrueshme
Përdorim efikas i burimeve, promovim i riciklimit dhe ripërdorimit, si dhe përmirësim i infrastrukturës.

05.Palët e interesuara
Komunikim transparent me institucionet, komunat, shoqërinë civile dhe qytetarët.

04. Punonjësit dhe ndërgjegjësimi
Pjesëmarrje aktive, trajnime periodike dhe fushata vetëdijesuese.

Tabela 4. Parimet themelore të Politikës së Mjedisit të KMDK-së.

Politika e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

KMDK, si institucion publik përgjegjës për menaxhimin dhe operimin e deponive sanitare dhe stacioneve transfer në nivel kombëtar, shpreh përkushtim të fuqishëm ndaj krijimit të një mjedisi pune të sigurt, të shëndetshëm dhe mbështetës për të gjithë punonjësit dhe bashkëpunëtorët.

Duke operuar në një fushë me rreziqe të larta për sigurinë fizike, përfshirë menaxhimin e mbeturinave, operimin e mjeteve të rënda dhe ekspozimin ndaj faktorëve biologjikë dhe kimikë, KMDK ka për qëllim parandalimin e lëndimeve, sëmundjeve profesionale dhe çdo incidenti të lidhur me shëndetin dhe sigurinë në punë.

Parimet Themelore të Politikës për SShP:

	01. Përmbushja e kërkesave ligjore Zbatimi i legjislacionit, kërkesave rregullatore dhe standardeve të sigurisë në punë.	
07. Integrimi në strategji dhe vendimmarrje Përfshirja e sigurisë në projekte, blerje, kontrata dhe planifikim vjetor.	**POLITIKA PËR SIGURI DHE SHËNDET NË PUNË**	**02. Parandalimi i rreziqeve** Identifikimi, vlerësimi dhe kontrolli i rreziqeve në aktivitetet operative.
06. Reagimi ndaj ngjarjeve dhe mësimet e nxjerra Dokumentimi, analiza e incidenteve dhe zbatimi i masave përmirësuese.		**03.Përfshirja dhe konsultimi i punonjësve** Pjesëmarrja aktive përmes takimeve, trajnimeve dhe komunikimit të brendshëm.
05.Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit Auditime të brendshme, analiza të incidenteve dhe rishikim i performancës.		**04. Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi** Trajnime periodike dhe ndërgjegjësim sipas planit vjetor.

Tabela 5. Parimet themelore të Politikës së Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

3.2 Harmonizimi me politikat ndërkombëtare dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Plani i Biznesit i KMDK-së mbështetet në drejtimet e përcaktuara nga politikat kombëtare për menaxhimin e integruar të mbeturinave, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e ekonomisë qarkore. Brenda përgjegjësive të saj, kompania kontribuon në këto drejtime përmes pranimit dhe deponimit të kontrolluar të mbeturinave, përmirësimit të kushteve në deponi dhe zhvillimit të kapaciteteve të reja.

Pra, KMDK do t'i harmonizojë politikat dhe planet e saj me drejtimet e Agjendës së Gjelbër dhe SDG-të që lidhen me veprimtarinë e kompanisë. Këto do të shërbejnë si orientim për përmirësimin e kushteve në deponi, rehabilitimin e qelizave të vjetra, zhvillimin e kapaciteteve të reja dhe përdorimin më efikas të energjisë. Masat konkrete do të përcaktohen sipas nevojave, përgjegjësive dhe mundësive financiare të KMDK-së.

Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është një kornizë bashkëpunimi që synon mbrojtjen e mjedisit, uljen e ndotjes dhe përdorimin më të mirë të energjisë dhe burimeve natyrore. Ajo përfshin edhe përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave, ripërdorimin dhe riciklimin.

Këto angazhime lidhen edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara. Ato synojnë përmirësimin e mirëqenies së njerëzve, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin ekonomik e shoqëror që merr parasysh edhe nevojat e brezave të ardhshëm. Për KMDK-në, kjo lidhje pasqyrohet në punë konkrete: rehabilitimin e qelizave të vjetra, ndërtimin e qelizave të reja, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe gazit të deponive, sigurinë në punë dhe përdorimin e kujdesshëm të mjeteve financiare.

Drejtimi	Kontributi i KMDK-së	Objektivat përkatëse
Infrastrukturë e sigurt dhe e qëndrueshme	Rehabilitimi i qelizave ekzistuese, ndërtimi i kapaciteteve të reja dhe mbyllja e kujdesi pas mbylljes, përfshirë ndërhyrjet në kuadër të Programit të Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta II–IV.	SDG 9 dhe 11
Menaxhim i integruar i mbeturinave dhe ekonomi qarkore	Përgatitja e projekteve për trajtimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit, mbeturinave organike, ndarjen, riciklimin dhe rikuperimin, përfshirë prodhimin e lëndës djegëse nga mbeturinat (RDF).	SDG 8 dhe 12
Mbrojtja e ujërave, tokës dhe ajrit	Menaxhimi i ujërave të ndotura dhe gazit të deponive, monitorimi i ujërave nëntokësore përmes piezometrave dhe ndërmarrja e masave sipas rezultateve të monitorimit.	SDG 6 dhe 13
Përdorimi i energjisë dhe zvogëlimi i ndikimit në klimë	Përgatitja e zgjidhjeve për kapjen dhe shfrytëzimin e gazit të deponive, përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe vendosjen e sistemeve fotovoltaike në sipërfaqe të përshtatshme.	SDG 7 dhe 13
Qeverisje e përgjegjshme dhe transparencë	Raportimi i rregullt mbi të dhëna të verifikueshme, zbatimi i procedurave të prokurimit dhe ndjekja e detyrimeve kontraktuale.	SDG 16

Tabela 6. Lidhja e veprimtarisë së KMDK-së me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

3.3 Parimet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes në vendimmarrje

ESG – parimet për mjedisin, aspektet shoqërore dhe qeverisjen (Environmental, Social and Governance). Këto tri parime ndihmojnë një kompani të vlerësojë ndikimin e punës së saj në mjedis dhe te njerëzit, si dhe mënyrën se si drejtohet dhe i përdor burimet. Trajtimi i tyre së bashku ndihmon në identifikimin e problemeve dhe marrjen e vendimeve që mbështesin funksionimin afatgjatë të kompanisë.

Për KMDK-në, parimet ESG lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësinë për pranimin dhe deponimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja. Ato mund të përdoren si orientim gjatë planifikimit, punës së përditshme dhe shqyrtimit të investimeve, duke marrë parasysh kushtet konkrete në secilën deponi dhe stacionin e transferimit.

KMDK i merr parasysh parimet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) gjatë planifikimit të punës, shqyrtimit të investimeve dhe përmirësimit të shërbimeve. Këto parime shërbejnë si orientim praktik dhe përfshihen gradualisht në proceset ekzistuese të kompanisë, në përputhje me nevojat dhe kapacitetet e saj.

Gjatë shqyrtimit të një aktiviteti ose investimi, krahas kostos dhe nevojës operative, merren parasysh:

- **Ndikimi në mjedis:** pasojat për ujërat, tokën dhe ajrin, përdorimi i energjisë dhe masat për kufizimin e ndotjes.
- **Ndikimi te njerëzit:** siguria dhe shëndeti i punonjësve, kushtet e punës dhe shqetësimet e komuniteteve pranë objekteve që menaxhon KMDK-ja.
- **Përgjegjësia në drejtim dhe administrim:** qartësia e përgjegjësive, respektimi i procedurave, arsyetimi i shpenzimeve dhe raportimi i saktë.

Vëmendje u kushtohet veçanërisht çështjeve që mund të ndikojnë në sigurinë e operimit, vazhdimësinë e shërbimeve dhe gjendjen financiare të kompanisë. Thellësia e shqyrtimit përshtatet me natyrën, madhësinë dhe rrezikun e aktivitetit ose investimit.

Këto çështje trajtohen përmes planifikimit, buxhetimit dhe raportimit të zakonshëm të KMDK-së. Kur identifikohet nevoja për ndërhyrje, përcaktohen masa e nevojshme, përgjegjësi për zbatimin, afati dhe financimi përkatës. Në këtë mënyrë, parimet ESG ndihmojnë në marrjen e vendimeve të arsyetuara dhe të zbatueshme.

4. Analiza e Tregut dhe Industrisë

4.1 Pozita e KMDK-së në sektor

Menaxhimi i mbeturinave në Kosovë përfaqëson një nga fushat më të rëndësishme të mbrojtjes së mjedisit, por njëkohësisht edhe një nga sfidat më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm. Gjatë viteve të fundit, institucionet qendrore dhe lokale kanë ndërmarrë hapa për forcimin e bazës ligjore, rritjen e kapaciteteve dhe promovimin e metodave më moderne të trajtimit të mbeturinave, duke e konsideruar këtë sektor si element kyç për mirëqenien e qytetarëve dhe integrimin evropian.

KMDK operon në një treg të rregulluar ku kërkesa nuk përcaktohet vetëm nga çmimi, por nga mandati publik, kapaciteti i pranimit të mbeturinave, rregullat mjedisore dhe marrëveshjet me komunat e operatorët. Pozita e kompanisë është e fortë për shkak të infrastrukturës dhe rolit shtetëror, por kjo pozitë sjell përgjegjësi më të lartë por ku kapaciteti i kufizuar, pajisjet e amortizuara ose mospërputhshmëria mjedisore ndikojnë drejtpërdrejt në një shërbim publik esencial.

Rritja e qëndrueshme nuk matet vetëm me tonët e pranuar. Për KMDK-në, rritje do të thotë edhe kosto më e ulët dhe e kontrolluar për ton, arkëtim më i mirë, më pak ndërprerje, projekte të reja të financueshme dhe aftësi për të operuar infrastruktura të reja pa krijuar deficit të përhershëm.

4.2 Palët e interesit

KMDK nuk ka një publik të vetëm, por secila palë kërkon një lloj tjetër vendimi dhe prove; prandaj angazhimi organizohet sipas nevojës, me hartën e palëve të interest.

Pala	Interesi	Veprimet e KMDK-së	Raporti/komunikimi
Aksionari dhe Bordi	Performanca, rreziku, financat dhe investimet	Raport me vendimet që kërkohen	Tremujor/vjetor
ME, MMPH, AMMK dhe inspektoratet	Lejet, monitorimi dhe përputhshmëria	Regjistër kërkesash, raporte dhe njoftim incidenti	Sipas lejes/kërkesës
Komunat dhe KRM-të	Kapaciteti, kontrata dhe cilësia	Takim operativ dhe raport klienti	Mujor/tremujor
Operatorët privat dhe personat fizikë	Rregulla të barabarta pranimi dhe pagesa	Kushte të publikuara dhe komunikim kontraktual	Sipas kontratës
Donatorët dhe IFI-të	Gatishmëria, parimet mjedisore, prokurimi dhe rezultatet	Raporte PIU, dosje projekti dhe komitet drejtues	Sipas projektit

Pala	Interesi	Veprimet e KMDK-së	Raporti/komunikimi
Komunitetet dhe shoqëria civile	Erë, pluhur, trafik, siguri dhe ndikim social	Mekanizëm ankese, konsultim dhe informacion i kuptueshëm	Vazhdueshëm
Punonjësit	Siguria, rolet, pajisjet, trajnimi dhe ndryshimi	Briefime, konsultim dhe plan zhvillimi	Javor/mujor

Tabela 7. Palët e interesit, nevojat dhe mënyrat e angazhimit të KMDK-së.

4.3 Trendet dhe mundësitë

Trendet dhe mundësitë paraqiten në planin e biznesit për të kuptuar ndryshimet në sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe ndikimin e tyre në KMDK. Ky vlerësim ndihmon kompaninë të përcaktojë prioritetet për zhvillimin e shërbimeve dhe investimet, duke marrë parasysh nevojat, kapacitetet dhe mundësitë e financimit.

KMDK do të përcjellë zhvillimet në sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe do të vlerësojë mundësitë për investime, financim dhe bashkëpunim. Përparësi do t'u japë projekteve që përmirësojnë infrastrukturën dhe shërbimet e saj dhe kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve të mbeturinave në nivel vendi, në përputhje me mandatin e kompanisë.

- Zgjerimi përtej deponimit deri tek menaxhimi i integruar i mbeturinave, ku rritet nevoja për ndarje, trajtim, rikuperim dhe treg për materiale.
- Kërkesat për mbrojtjen e klimës, duke përfshi , kontrolli i metanit e tjera.
- Digjitalizimi, me peshoret digjitale, asetet, faturimi, GPS, raportimi mjedisor, permbajtja e mbeturinave, inqizimet topografike me dron, të dhënat e motit, nivelin e ujërave nëntokësore, moti; dhe mirëmbajtja e këtyre të dhënave duhet të lidhen në një rrjedhë të vetme të të dhënave.
- Projektet që adresojnë një nevojë të përcaktuar qartë, kanë përgjegjësi institucionale të caktuara, mbështeten në studime dhe parashohin mënyrën e operimit pas realizimit, kanë më shumë mundësi për të siguruar financim.
- Tregu privat, ku partneritetet janë të dobishme aty ku ndarja e rrezikut, tarifa dhe standardi i shërbimit janë të përcaktuara qartë.

4.4 Analiza PESTEL

Analiza PESTEL paraqet faktorët e jashtëm që ndikojnë në veprimtarinë e KMDK-së dhe ndihmon në përcaktimin e përparësive për shërbimet dhe investimet. Për periudhën 2027–2029, KMDK-ja synon përmirësimin e vazhdueshëm të operimit, qëndrueshmërinë financiare, mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit, si dhe arritjen e përputhshmërisë me kërkesat ligjore. Ndërhyrjet dhe investimet do të planifikohen sipas nevojave dhe burimeve të disponueshme, duke u dhënë përparësi çështjeve më urgjente.

Faktori	Çështjet kryesore dhe synimet e KMDK-së
Politik dhe institucional	Vendimet institucionale, çështjet pronësore dhe marrëveshjet e financimit ndikojnë në menaxhimin e deponive dhe realizimin e projekteve. KMDK-ja synon koordinim të rregullt me institucionet përkatëse dhe qartësimin e përgjegjësive për çdo angazhim të ri.
Ekonomik dhe financiar	Arkëtimi, sasitë e mbeturinave dhe ndryshimet në kosto ndikojnë në financimin e shërbimeve. Përparësi do të kenë përmirësimi i arkëtimit, kontrolli i shpenzimeve dhe planifikimi i investimeve sipas mundësive financiare.
Shoqëror dhe komunitar	Veprimtaria e deponive dhe projektet ndikojnë te punonjësit dhe komunitetet përreth. KMDK-ja synon të përmirësojë sigurinë, komunikimin dhe trajtimin e ankesave, si dhe të zbatojë masat e miratuara për personat e prekur nga projektet.

Faktori	Çështjet kryesore dhe synimet e KMDK-së
Teknologjik	Pajisjet dhe sistemet e të dhënave ndikojnë në cilësinë e shërbimit, faturimin dhe raportimin. KMDK-ja synon mirëmbajtjen dhe përmirësimin gradual të tyre, në përputhje me nevojat e operimit.
Mjedisor dhe klimatik	Ujërat e ndotura, gazi i deponive, zjarret dhe kushtet e motit kërkojnë monitorim dhe masa mbrojtëse. Përparësi do të kenë ndërhyrjet që zvogëlojnë rrezikun për njerëzit dhe mjedisin dhe sigurojnë vazhdimësinë e shërbimeve.
Ligjor dhe rregullativ	KMDK-ja synon përputhshmërinë e veprimtarisë së saj me kërkesat ligjore dhe kushtet e lejeve. Kjo përfshin ndjekjen e afateve, përmbushjen e detyrimeve dhe adresimin e mangësive të identifikuara në operim dhe infrastrukturë.

Tabela 8. Analiza PESTEL e KMDK-së.

5. Vlerësimi i Rreziqeve

5.1 Qasja ndaj identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve

Vlerësimi i rreziqeve e ndihmon KMDK-në të identifikojë në kohë problemet që mund të pengojnë punën, të rrisin kostot ose të rrezikojnë punonjësit dhe mjedisin. Për secilin rrezik vlerësohen mundësia e shfaqjes dhe pasojat e mundshme, pastaj përcaktohen masat parandaluese ose korrigjuese, personat përgjegjës dhe afatet për zbatim.

Rreziqet merren parasysh gjatë organizimit të punës së përditshme, planifikimit financiar dhe zhvillimit të projekteve. Regjistri i rreziqeve shqyrtohet çdo gjashtë muaj dhe përditësohet sa herë që një incident, ndryshim në kontratë, leje, projekt apo kërkesë ligjore ndikon në veprimtarinë e kompanisë. Në të pasqyrohen edhe detyrimet e reja dhe zhvillimet në kontestet gjyqësore që mund të kenë pasoja për KMDK-në.

Rreziqet kryesore ndahen në këto kategori:

- **Rreziqet operative:** lidhen me shterimin e kapaciteteve për deponimin e mbeturinave, vështirësitë ose ndërprerjet në pranimin dhe deponimin e mbeturinave. Ato përfshijnë mungesën ose defektet e makinerive, zjarret, grumbullimin e pakontrolluar të gazit, paqëndrueshmërinë e trupit/argjinaturave të deponisë, si dhe problemet në grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura nga mbeturinat.
- **Rreziqet mjedisore:** lidhen me ndotjen e ujërave, tokës dhe ajrit, shpezët, kafshët, qenët, brejtësit, insektet, zvarranikët, tejkalimin e kufijve mjedisorë të lejuar dhe mosplotësimin e kushteve të lejeve.
- **Rreziqet financiare:** përfshijnë vonesat ose mosarkëtimin e pagesave nga klientët, rritjen e shpenzimeve dhe mungesën e mjeteve për përmbushjen e pagesave. Në këtë kategori hyjnë edhe detyrimet e mundshme nga kontestet apo kontratat dhe marrja e detyrimeve për investime pa financim të siguruar.
- **Rreziqet ligjore dhe të besueshmërisë:** lidhen me mosrespektimin e kërkesave ligjore, procedurave të prokurimit, kontratave dhe të drejtave të punonjësve. Kontestet, parregullsitë në vendimmarrje, keqpërdorimi i të dhënave dhe raportimi i pasaktë mund të sjellin kosto shtesë dhe të cenojnë besimin e klientëve, institucioneve dhe publikut në kompani.
- **Rreziqet e projekteve:** përfshijnë çështjet e pazgjidhura të pronësisë ose shfrytëzimit të tokës, vonesat në leje, analizat e pamjaftueshme teknike e financiare dhe mungesën e financimit. Vlerësohet gjithashtu nëse KMDK-ja ka stafin, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për të marrë në menaxhim, operuar dhe mirëmbajtur kapacitetet e reja pas përfundimit të investimit.

5.2 Rreziqet ligjore dhe gjyqësore 2027–2029

Analiza e rreziqeve ligjore përdor një shkallë nga 1 deri në 10, me nivelet 1–3 trajtohen si të ulëta, 4–6 i mesëm, 7–10 i lartë. Për secilin rrezik përcaktohen masa, përgjegjësi dhe mënyra e raportimit.

Nr	Rreziku ligjor	Përshkrimi dhe pasoja	Vlerësimi	Masat kryesore
1.	Kontestet gjyqësore dhe përmbarimore aktive.	Zvarritja e proceseve, vendime të pafavorshme për KMDK, pagesa e kostove procedurale.	8 – I LARTË	Regjistër unik i lëndëve; monitorim mujor; strategji për secilën lëndë; rezervim financiar sipas ekspozimit.
2.	Ekspozimi financiar nga detyrimet dhe vendimet gjyqësore.	Detyrime të paplanifikuara, kamata që paguhet konform legjislacionit në fuqi, shpenzime procedurale dhe ndikim në likuiditet.	9 – I LARTË	Parashikim financiar për kontestet aktive; kontroll i detyrimeve që KMDK i detyrohet palëve të treta; verifikim juridik & financiar para pranimit ose krijimit të detyrimeve.
3.	Mosarkëtimi i kërkesave financiare të KMDK-së.	Rrezik për humbje ose vonesë në arkëtimin e të hyrave dhe rritje të portofolit të debitorëve.	6 – I MESËM	Klasifikimi i debitorëve; përcaktimi i afateve për pagesë; ndërmarrja e masave për arkëtim dhe inicimi i procedurave përmbarimore; raportim tremujor mbi arkëtimin.
4.	Kontestet e punës në gjykatë.	Padi për moskompensim të pagave, ndërprerje të marrëdhënies së punës, për masa disiplinore, sistemimin në pozitë dhe nivel të pagës etj.	8 – I LARTË	Unifikimi i formës dhe përmbajtjes së akteve të brendshme lidhur me marrëdhënien e punës; verifikimi juridik para shqiptimit të masave disiplinore ndaj punonjësve; dokumentimi i rregullt dhe i plotë i të gjitha fazave të procedurave.
5.	Rreziku nga mospërputhjet dhe mangësitë në kontrata dhe në menaxhimin e tyre.	Mosrespektim i afateve, specifikimeve, detyrimeve, penaliteteve ose procedurave të ndërprerjes.	6 – MESATAR	Mbajtja dhe përditësimi i regjistrit të kontratave; monitorimi i përmbushjes së detyrimeve kontraktuale; përdorimi i klauzolave standarde; shqyrtimi juridik i kontratave para nënshkrimit dhe para çdo ndryshimi ose plotësimi të tyre.
6.	Rreziqet ligjore në prokurim dhe procedurat e ankesave.	Rreziku nga ankesat dhe kontestet në procedurat e prokurimit.	9 – I LARTË	Shqyrtim juridik i dokumentacionit; monitorim i afateve ligjore dhe procedurale.
7.	Rreziku nga mosrespektimi i kërkesave mjedisore dhe ligjore.	Mosrespektimi i kërkesave mjedisore dhe kushteve të licencave mund të rezultojë në masa administrative, gjoba, detyrime për ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe inicimin e kontesteve ligjore.	10 – I LARTË	Mbajtja dhe përditësimi i regjistrit të lejeve dhe detyrimeve; kontrolli periodik i përmbushjes së kërkesave ligjore dhe mjedisore; evidentimi dhe përcjellja e masave korrigjuese; bashkëpunimi ndërmjet njësive juridike dhe teknike.
8.	Rreziku ligjor në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.	Aksidentet në vendin e punës dhe moszbatimi i masave parandaluese mund të rezultojnë në përgjegjësi civile, administrative dhe penale.	9 – I LARTË	Kontroll dhe përditësim i dokumentacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë; trajnime të punonjësve; evidencë e pajisjeve mbrojtëse dhe kontrolleve; hetim dhe dokumentim i incidenteve dhe aksidenteve.

Nr	Rreziku ligjor	Përshkrimi dhe pasoja	Vlerësimi	Masat kryesore
9.	Rreziku nga shkeljet penale dhe cenimi i integritetit të KMDK-së.	Procedurat penale, kallëzimet penale dhe pretendimet për veprime të kundërligjshme mund të cenojnë reputacionin dhe të ndikojnë në funksionimin e KMDK-së.	9 – I LARTË	Mekanizma për raportimin e parregullsive; ruajtje dhe administrim i dokumentacionit; zbatim i procedurave për konfliktin e interesit; bashkëpunim i koordinuar me organet kompetente.
10.	Rreziku nga ndryshimet në legjislacion.	Ndryshime në legjislacion mund të kërkojnë përshtatje të procedurave, kontratave, tarifave dhe akteve të brendshme.	6 – I MESËM	Monitorim i ndryshimeve ligjore; informim periodik për ndryshimet në legjislacion; plan vjetor për harmonizimin e akteve dhe procedurave; përcaktim i personave përgjegjës për zbatimin e kërkesave ligjore.
11.	Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti	Mosrespektimi i kërkesave ligjore për mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin mund të rezultojë në shkelje të të dhënave, masa administrative, gjoba dhe përgjegjësi ligjore për KMDK-në.	6 – I MESËM	Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe procedurave; kontrolli i autorizimeve të qasjes; nënshkrimi i deklaratave të konfidencialitetit; trajnimi i punonjësve.

Tabela 9. Vlerësimi i rreziqeve ligjore dhe gjyqësore dhe masat për menaxhimin e tyre, 2027–2029.

Rreziqet e larta lidhen me veprim konkret dhe raportohen pa pritur ciklin vjetor. Regjistri shërben për prioritizim e eskalim; dosja e secilës lëndë mbetet burimi i plotë juridik dhe financiar.

5.3 Menaxhimi i kontesteve dhe ekspozimit gjyqësor

Për secilën lëndë gjyqësore ose përmbarimore mbahet një dosje e unifikuar me palët, objektin, fazën, afatet, vlerën e pretenduar, vlerësimin juridik, kostot e mundshme dhe veprimin e ardhshëm. Zyrtari ligjor e përditëson statusin, ndërsa Drejtoria e Financave vlerëson trajtimin kontabël dhe ndikimin në likuiditet. Asnjë provizion nuk vendoset automatikisht; ai mbështetet në vlerësim rast pas rasti dhe në standardet kontabël të zbatueshme.

Vëmendje e veçantë i kushtohet kontesteve të punës, kërkesave financiare të paarkëtuara, kontratave me ndikim material, ankesave në prokurim, çështjeve mjedisore dhe të sigurisë në punë. Qasja parandaluese kërkon kontroll juridik para vendimit, dokumentim të plotë dhe reagim brenda afateve procedurale.

5.4 Ndërlidhja me planifikimin financiar dhe operacional

Raporti tremujor i rrezikut përmban ndryshimin e ekspozimit, afatet kritike, pagesat ose arkëtimet e mundshme, masat e marra dhe vendimet që kërkohen. Informacioni përdoret në parashikimin e parasë, planin e prokurimit, menaxhimin e kontratave dhe prioritetet operative, por nuk paraqitet si shifër e miratuar pa pajtim ligjor e financiar.

5.5 Prioritetet juridike për periudhën 2027–2029

Viti	Prioriteti
2027	**vendosja e kontrollit** - krijimi i regjistrave për rreziqet, kontestet, kontratat, lejet dhe detyrimet; standardizimi i opinioneve juridike dhe plani për rastet e trashëguara.
2028	**zbatimi dhe analiza** - kontrolle periodike të përputhshmërisë, rishikim i kontratave dhe analizë e shkaqeve të përsëritura të kontesteve.
2029	**vlerësimi i efektivitetit** - matja e ndryshimit të ekspozimit, përditësimi i politikave dhe raporti vjetor mbi rrezikun juridik.

Tabela 10. Prioritetet juridike për periudhën 2027–2029.

6. Drejtimi Strategjik

Drejtimi strategjik i KMDK përcakton orientimin e kompanisë për 3 vitet e ardhshme, duke u fokusuar në forcimin e kapaciteteve të brendshme, përmirësimin e shërbimeve dhe zgjerimin e mundësive të bashkëpunimit. Ky drejtim ndërtohet mbi bazën e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe nevojës për t'iu përgjigjur sfidave të sektorit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.

6.1 Prioritetet dhe objektivat strategjike

Për periudhën 2027–2029, KMDK përcakton tri prioritete dhe pesë objektiva strategjike. Prioritetet përcaktojnë fushat kryesore ku do të përqendrohet kompania, ndërsa objektivat shprehin përmirësimet që synon të arrijë në këto fusha.

Kodi	Prioriteti strategjik
PS1	Operimi i sigurt dhe mbrojtja e mjedisit
PS2	Zbatimi i investimeve dhe zhvillimi i projekteve e shërbimeve të reja
PS3	Qëndrueshmëria financiare dhe zhvillimi institucional

Tabela 11. Prioritetet strategjike të KMDK-së për periudhën 2027–2029.

Pesë objektivat e mëposhtme zbërthejnë këto prioritete dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e aktiviteteve dhe investimeve.

Prioriteti	Objektivi strategjik	Fokusi për periudhën 2027–2029
PS1	**OS1 – Të sigurojë vazhdimësinë dhe sigurinë e shërbimeve.**	Ruajtja e kapaciteteve për pranimin dhe deponimin e mbeturinave, mirëmbajtja dhe plotësimi i nevojave për makineri e pajisje, zbatimi i procedurave të punës dhe parandalimi i incidenteve.
PS1	**OS2 – Të përmirësojë mbrojtjen e mjedisit dhe përputhshmërinë e operimit me kërkesat ligjore.**	Monitorimi mjedisor, përmirësimi i menaxhimit të ujërave të ndotura dhe gazit të deponive, përdorimi më efikas i energjisë dhe masat për përballimin e kushteve të rënda të motit.
PS2	**OS3 – Të përmirësojë infrastrukturën dhe të krijojë mundësi për zhvillimin e shërbimeve dhe të hyrave.**	Zbatimi i investimeve dhe i Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV, përfshirë rehabilitimin dhe ndërtimin e qelizave. Përgatitja e projekteve të reja të mbështetura në nevoja të qarta, analiza teknike e financiare dhe mundësi financimi.
PS3	**OS4 – Të forcojë qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.**	Përmirësimi i arkëtimit, kontrolli i kostove dhe planifikimi i mjeteve për vazhdimësinë e shërbimeve, detyrimet dhe investimet. Vlerësimi i mbulimit të kostove nga tarifat dhe i nevojave për shpenzime të paparashikuara.
PS3	**OS5 – Të forcojë kapacitetet e stafit, qeverisjen dhe besimin publik.**	Plotësimi i pozitave kyçe, trajnimi, zbatimi i standardeve përkatëse ISO dhe qartësimi i përgjegjësive. Raportimi i rregullt, komunikimi me publikun dhe përfshirja e çështjeve mjedisore e shoqërore në vendimmarrje.

Tabela 12. Objektivat strategjike dhe fushat prioritare të veprimit për periudhën 2027–2029.

Në kuadër të këtyre prioriteteve, KMDK synon:

- **Përmirësimin e kushteve në deponitë që menaxhon**, përmes rehabilitimit të qelizave të vjetra, ndërtimit të qelizave të reja dhe plotësimit të kërkesave teknike, mjedisore dhe të sigurisë.
- **Zgjerimin gradual të veprimtarisë përtej deponimit**, duke zhvilluar kapacitete për trajtimin dhe rikuperimin e mbeturinave aty ku nevojitet një zgjidhje e përbashkët për disa komuna ose në nivel vendi, në përputhje me mandatin dhe mundësitë e kompanisë.
- **Krijimin e burimeve të reja të të hyrave**, përmes shërbimeve që u përgjigjen nevojave të sektorit dhe mbështeten në analiza të kostove, kërkesës dhe mundësisë së financimit.
- **Modernizimin e infrastrukturës, makinerive dhe pajisjeve**, për të zvogëluar ndërprerjet, përmirësuar efikasitetin dhe rritur sigurinë në punë.
- **Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë së punonjësve**, përmes zbatimit të procedurave të qarta dhe standardeve ndërkombëtare përkatëse.
- **Forcimin e kapaciteteve të stafit**, përmes trajnimeve dhe zhvillimit profesional të lidhur me detyrat e punës, pajisjet dhe shërbimet e reja.
- **Rritjen e kontributit në ekonominë qarkore**, përmes zhvillimit të projekteve për trajtim, riciklim dhe rikuperim, si dhe bashkëpunimit me komunat dhe operatorët për të mbështetur ndarjen e mbeturinave në burim.

6.2 Zhvillimi përmes projekteve dhe shërbimeve të reja

KMDK e zhvillon portofolin e shërbimeve në funksion të nevojave të dokumentuara të komunave dhe operatorëve që dorëzojnë mbeturina. Për periudhën 2027–2029, prioritetet konkrete janë ndarja e materialeve të rikuperueshme, trajtimi i fraksionit të mbetur pas ndarjes, përpunimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, trajtimi i mbeturinave organike, shfrytëzimi i gazit të deponive dhe përmirësimi i rrjetit të transferit. Përgatitja e tyre nuk barazohet me fillimin e shërbimit komercial.

DPZh koordinon përgatitjen me DO dhe DF. Në mungesë të mbështetjes së posaçme teknike, zhvillohen paralelisht deri në dy studime prioritare dhe një aplikim kryesor për financim. Menaxhmenti miraton

renditjen sipas rrezikut mjedisor, nevojës për kapacitet, gatishmërisë së lokacionit, kostos së plotë dhe mundësisë së financimit. Ky kufizim shmang shpërndarjen e burimeve në më shumë projekte sesa kompania mund të përgatisë dhe ndjekë.

Tabela 12a. Shërbimet e propozuara dhe produktet e periudhës 2027–2029

Shërbimi ose projekti	Produkti që përgatitet	Kushti për fillimin e shërbimit
Pika ndarëse në Gjilan	Bilanc i materialeve, analizë e lokacionit dhe fizibilitet; model operimi me komunat dhe blerësit e materialeve.	Financim i dokumentuar, leje dhe marrëveshje për furnizim e shitje.
Fraksioni i pareciklueshëm dhe MBT/RDF	Karakterizim, krahasim alternativash dhe analizë e kostos për ton e e tregut për produktin.	Zgjidhje e përzgjedhur dhe kontratë për pranimin e RDF-së ose mbetjes së trajtimit.
Mbeturina nga ndërtimi dhe rrënimi	Projekt pilot për pranim, ndarje, thërrmim dhe kontroll të cilësisë së agregatit.	Lokacion e leje; përdorim i ligjshëm i produktit; pajisje e përshtatshme dhe kapacitet për operim.
Mbeturina organike	Analizë e ndarjes në burim dhe e kompostimit kundrejt biodigjestionit.	Fluks i kontrolluar pa ndotje të tepërt dhe përdorues i produktit.
Gazi i deponive	Matje të sasisë e cilësisë së gazit dhe krahasim i djegies së kontrolluar me prodhimin e energjisë.	Siguri teknike, qëndrueshmëri e furnizimit me gaz, fizibilitet dhe financim.
Stacione transferi dhe zgjidhja rajonale e Mitrovicës	Analizë e flukseve, distancave, alternativave të lokacioneve dhe përgjegjësive ndërinstitucionale.	Marrëveshje për menaxhim, financim dhe mbulim të kostove të operimit.

KMDK do të ofrojë pranim dhe trajtim në objektet që i janë besuar. Çdo rol i ri në grumbullim ose transport jashtë funksionimit të stacioneve të transferit kërkon përcaktim të veçantë institucional e kontraktual. Mënyra e zhvillimit të secilit projekt, rezultatet sipas viteve dhe kushtet e financimit paraqiten në seksionet 13.2.1–13.2.7.

Gjatë periudhës së planit, puna përqendrohet në:

- **Përgatitjen e propozimeve prioritare**, me një përshkrim të qartë të nevojës, zgjidhjes së propozuar, kostove të pritshme dhe mënyrës së funksionimit.
- **Aplikimin për financim**, kur ka thirrje ose mundësi bashkëpunimi që përputhen me nevojat dhe përgjegjësitë e KMDK-së.
- **Provimin në shkallë të kufizuar të shërbimeve të reja**, kur kjo ndihmon për të vlerësuar rezultatet dhe kostot përpara një investimi më të madh, pasi të jenë siguruar financimi dhe kushtet për zbatim.
- **Planifikimin e kujdesshëm të të hyrave të reja**, duke i përfshirë në buxhet vetëm kur ka bazë të dokumentuar për fillimin e shërbimit, kërkesën dhe pagesat e pritshme.
- **Përgatitjen për menaxhimin e objekteve të reja**, duke përcaktuar paraprakisht stafin, mirëmbajtjen, tarifat dhe përgjegjësitë për pajisjet e infrastrukturën.
- **Shqyrtimin e ndikimeve të projekteve**, veçanërisht në mjedis, sigurinë e punonjësve dhe komunitetet pranë tyre, në përputhje me kërkesat përkatëse.
- **Bashkëpunimi me universitetet dhe organizatat profesionale** synon të mbështesë përgatitjen e projekteve përmes hulumtimeve, matjeve, analizave laboratorike dhe trajnimit të stafit, sipas nevojave konkrete të kompanisë.

6.3 Fokusi i rritjes dhe zhvillimit

- Zgjerimi i mbulimit territorial si dhe i shërbimeve në fushën e trajtimit (ndarjes) të mbeturinave organike dhe shërbimeve inovative për komunat.
- Diversifikimi i burimeve të të ardhurave, duke përfshirë projekte të financuara nga qeveria dhe donatorët.
- Përdorimi i teknologjive të reja për optimizimin e transportit dhe menaxhimin e deponive.

- Rritja e ndërgjegjësimit publik, përmes fushatave informuese dhe edukative mbi ndarjen e mbeturinave dhe riciklimin.
- Eksplorimi i mundësive nepërmjet partneriteteve publiko-private.

6.4 Partneritetet dhe bashkëpunimi me donatorë

- Bashkëpunim me donatorë ndërkombëtarë (BE, KfW, GIZ, BERZH, JICA etj.) për sigurimin e fondeve dhe asistencës teknike.
- Partneritete me sektorin privat, sidomos në projekte të ekonomisë qarkore dhe inovacionit teknologjik.
- Koordinim i ngushtë me komunat dhe institucionet qendrore, për të siguruar që aktivitetet e KMDK janë të harmonizuara me strategjitë kombëtare.
- Marrëveshje bashkëpunimi me OJQ dhe shoqërinë civile, për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme.

7. Objektivat SMART dhe faktorët e që masin suksesin

KMDK do të ndjekë zbatimin e Planit të Biznesit përmes treguesve që lidhen me punën e përditshme, gjendjen financiare dhe ecurinë e projekteve. Qëllimi është të kuptohet farë është realizuar, ku ka vështirësi dhe cilat punë kërkojnë më shumë vëmendje ose mbështetje. Treguesit mbështeten në të dhënat e operimit, financave dhe epartamenteve përkatëse. Aktivitetet, periudhat dhe njësitë e përfshira paraqiten në listën e aktiviteteve 2027–2029 dhe në Planin e Veprimit.

7.1 Treguesit kryesorë të performancës

KPI-të mbulojnë vetëm procese që KMDK mund t'i kontrollojë ose ndikojë drejtpërdrejt. Treguesit më poshtë përdoren gjatë viteve 2027–2029. Për secilin paraqitet çfarë diqet, përmirësimi që synohet dhe të dhënat që shërbejnë për vlerësim.

7.2 Matrica e KPI-ve SMART

KPI	2027	2028	2029	Pronari	Evidenca
Raportimi i zbatimit të Planit të Biznesit	2 raporte; TM2- TM4	4 raporte TM1-TM2-TM3-TM4	4 raporte TM1-TM2-TM3-TM4	DPZh	Raportet/vendimet
Raportimi plan–realizim dhe paraja	12 raporte	12 raporte	12 raporte	DF	Mbyllja mujore
Raporti operativ	12 raporte mujore	12 raporte	12 raporte	DO	Vendime/shkresa
Detektorët e gazit funksionalë	Kontroll/kalibrim	Kontroll/kalibrim	Kontroll/kalibrim	DO	Regjistri i pajisjeve
Kontestet dhe afatet aktive	Përditësim mujor; rishikim TM	Mujor/TM	Mujor/TM	DF/DShM	Regjistri i lëndëve
Trajnimet e planifikuara	20 trajnime	15 trajnime	13 trajnime	DShM	Lista e pjesëmarrësve/vlerësimi
Veprimet e KMDK-së në Programin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta II–IV	100% të përditësuara çdo muaj	100%	100%	DPZh	Raporti i Programit
Konceptet e plota për projekte të reja	1 koncept i dokument	≥1 koncept dokument	≥1 koncept dokument	DPZh	Dokumenti i konceptit
Monitorimi i zbatimit te planit te komunikimit	2 raporte	3 raporte	4 raporte	DPZh	Kalendari/raportet
Përmbledhja ESG/SDG	1 raport	1 raport	1 raport	Të gjitha njësitë	Raporti dhe evidenca
Kontrolli i Planit të Veprimit	Raporti i statusit	Raporti i statusit	Raporti i statusit	Të gjitha njësitë	Regjistri i progresit

Tabela 13. Matrica e treguesve kryesorë të performancës (KPI) për periudhën 2027–2029.

7.3 Lista e aktiviteteve për periudhën trevjeçare 2027–2029

Lista dallon aktivitetet e zbatimit nga ato të përgatitjes. Afati 2029 është fundi i etapës së planifikuar, jo garanci për ndërtimin ose vënien në funksion të çdo impianti. Shënimi "inicuar" i referohet përgatitjes; nuk dëshmon kontratë pune, financim të mbyllur ose realizim fizik. Projektet që vareshin nga afate deri më 2030 në planin e mëparshëm janë zbërthyer në rezultate që mund të përgatiten brenda viteve 2027–2029.

Lista e Aktiviteteve për periudhën 3 vjeçare 2027-2029					
Nr	**Prioriteti strategjik**	**Përshkrim i Aktivitetit**	**Data e Fillimit**	**Data e Realizimit**	**Statusi i realizimit**
1	PS3	ISO 9001 – Përfundimi i auditimit të gatishmërisë, mbyllja e gjetjeve dhe certifikimi i synuar gjatë 2027, brenda buxhetit të miratuar.	2027	2027	Në proces
2	PS2	Deponia e re për rajonin e Prishtinës – Lokacioni, dokumentacioni mjedisor e teknik, lejet dhe prokurimi; punime e funksionalizim sipas kontratës dhe financimit.	2027	2029	Inicuar
3	PS1/PS2/PS3	Kalimi në menaxhim të KMDK-së i deponisë Pejë-KMDK do filloj me operim në deponinë e Sfërkes	2027	2027	Në proces
4	PS2/PS3	Kalimi në menaxhim të KMDK-së i deponisë së Zvecanit	2027	2027	Në proces
5	PS2	Rehabilitimi i Pejës – Përgatitja dhe zbatimi i paketave të Programit II–IV; etapat dhe pranimi sipas planit kontraktual.	2027	2028	Në proces
6	PS2/PS3	Identifikimi i lokacionit te ri te stacionit të transferit Gerlicë (Ferizaj)	2028	2028	Planifikuar
7	PS1	Mbyllja dhe rehabilitimi i deponisë komunale Tuçep (Istog) – Të realizohet mbyllja dhe rehabilitimi në përputhje me standardet mjedisore.	2027	2028	Planifikuar
8	PS2	Zyra qendrore – Analiza e nevojës, lokacionit dhe alternativës ndërtim/qira; projektimi dhe kërkesa për financim. Ndërtimi pas miratimit të buxhetit.	2027	2028	Planifikuar
9	PS2	Fraksioni i pareciklueshëm – Karakterizim më 2027; krahasim i MBT/RDF dhe alternativave më 2028; vendim për teknologjinë dhe financimin më 2029.	2027	2029	Inicuar
10	PS2	Stacionet e transferit – Inventar i flukseve e distancave më 2027 dhe propozim i kostuar për Qeverinë më 2028.	2027	2028	Inicuar
11	PS2	MNRR – Analizë e fluksit dhe lokacionit më 2027; pajisja e planifikuar 300.000 € më 2028, pas vlerësimit teknik; provë dhe vlerësim më 2029.	2027	2029	Inicuar
12	PS2	Gazi i deponive – Matje dhe vlerësim i sigurisë më 2027; fizibilitet më 2028; vendim për djegie të kontrolluar ose shfrytëzim energjetik më 2029.	2027	2029	Planifikuar
13	PS3	ISO 14001 – Regjistri i aspekteve, kontrollet, auditimi dhe certifikimi i synuar më 2028, sipas edicionit të zbatueshëm dhe gatishmërisë.	2027	2028	Planifikuar
14	PS3	ISO 45001 – Vlerësimi i rreziqeve, procedurat, trajnimi dhe certifikimi i synuar më 2027, nëse plotësohen gatishmëria dhe financimi.	2027	2027	Planifikuar
15	PS2	Mirashi – Masa për ujërat dhe gazin, projekt mbylljeje dhe plan pas mbylljes; punimet kushtëzohen me financimin dhe kapacitetin alternativ të pranimit.	2027	2029	Planifikuar
16	PS3	Aktivitete edukative-mjedisore	2027	2027	Planifikuar
17	PS3	Masat për rritjen e përgjegjësisë sociale tek komuniteti lokal afër deponive	2027	2029	Planifikuar

Tabela 14. Lista e aktiviteteve të planifikuara për periudhën 2027–2029.

7.3.1 Kostot dhe mbulimi financiar i aktiviteteve

Aktivitetet e listës kanë kosto të stafit dhe, sipas natyrës, shpenzime për studime, matje, leje, auditim, furnizime, punime dhe operim pas investimit. Puna e stafit mbulohet nga fondi i pagave dhe nuk shtohet përsëri si shpenzim i ri projekti. Një projekt pa preventiv ose marrëveshje financimi nuk ka kosto zero: ka kosto ende të papërcaktuar dhe nuk krijon autorizim për shpenzim.

Tabela 14a. Lidhja e aktiviteteve me buxhetin dhe burimin e financimit

Nr. në tabelën 14	Kostoja dhe trajtimi në plan	Përgjegjësia dhe kushti
1, 13, 14 – ISO	Puna e brendshme në paga; auditimi dhe certifikimi nga mbështetja profesionale. Nuk ka ndarje të veçantë të çmimit të certifikimit në tabelën 27.	DShM/DF; preventiv dhe ndarje brenda kufirit buxhetor para procedurës.
2, 5, 7 – Prishtina, Peja, Istogu	Komponentë të Programit II–IV. Kontributi i KMDK-së ndiqet në llogarinë e veçantë; vlera e çdo kontrate nga plani i miratuar i programit.	PIU/DF; kontratë, financim, leje dhe plan pagesash.
3, 4 – Marrja në menaxhim	Paga, karburant, mirëmbajtje e siguri brenda kostove operative. Struktura parashikon 8 punonjës në Pejë dhe 7 në Zveçan.	DO/BNj/DF; muajt e operimit dhe të punësimit të përputhen me marrëveshjen e transferimit.
6, 10 – Stacionet e transferit	Analizë nga stafi; matje ose projektim i jashtëm vetëm me buxhet. Ndërtimi i rrjetit nuk ka zë të veçantë në investimet vetanake.	DPZh/DO; propozim i kostuar dhe financim para ndërtimit.
8 – Zyra qendrore	Kostoja e ndërtimit nuk përfshihet në 745.000 € të investimeve vetanake 2027. Qiraja është 72.000 € më 2027 dhe 90.000 € për secilin nga vitet 2028–2029.	Menaxhmenti/DF; analizë ndërtim/qira dhe vendim financimi i veçantë.
9, 12 – MBT/RDF dhe gaz	Përgatitja e brendshme në paga; studimet dhe pilotët sipas preventivit. Nuk ka buxhet të veçantë për impiant të plotë.	DPZh/DO/DF; përzgjedhje e prioriteteve dhe kërkesë financimi.
11 – MNRR	300.000 € më 2028 për pajisjen e përpunimit të inerteve, sipas tabelës 32. Kjo nuk është kostoja e një qendre të plotë trajtimi.	DO/DPZh/Prokurimi; verifikim i teknologjisë dhe kostove plotësuese para blerjes.
15 – Mirashi	Masat rutinë nga mirëmbajtja dhe monitorimi; mbyllja përfundimtare dhe sistemi i plotë i gazit/ujërave kërkojnë preventiv dhe financim të posaçëm.	DO/DPZh/PIU; shmangie e mbivendosjes me paketat e Programit II–IV.
16, 17 – Edukimi dhe komuniteti	Komunikimi nga zërat e miratuar; masat sociale sipas planit e fondit përkatës.	DPZh/DF; masat me kosto të re kërkojnë ndarje ose ridestinim të miratuar, jo angazhim jashtë buxhetit.

Për trajnimet e renditura në Shtojcën 3, kostoja e identifikueshme është 43.760 € më 2027, 9.320 € më 2028 dhe 5.740 € më 2029, gjithsej 58.820 €. Numri i aktiviteteve të listuara është 20, 15 dhe 13, gjithsej 48. Këto shuma janë pjesë e kostove për zhvillim profesional dhe nuk i shtohen automatikisht totalit të tabelës 27. Çdo aktivitet shtesë duhet të ketë përmbajtje dhe kosto të miratuar.

DF mban një evidencë për çdo aktivitet, me kosto përgatitjeje, kosto investimi, kosto vjetore operimi, burim, vit pagese dhe status financimi. Për projektet pa kosto të përcaktuar, rezultati i planifikuar është përgatitja e vlerësimit teknik dhe financiar. Kalimi te zbatimi lejohet vetëm pas përfshirjes së shumës në buxhet dhe sigurimit të financimit.

7.4 Miratimi dhe zbatimi i draft-rregulloreve të brendshme

Gjatë vitit 2027, KMDK-ja synon të përfundojë shqyrtimin e draft-rregulloreve të përgatitura dhe t'i paraqesë për miratim te organet kompetente. Njësitë përgjegjëse trajtojnë komentet dhe plotësojnë

përmbajtjen, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore, për të siguruar përputhjen me kërkesat ligjore dhe aktet e kompanisë.

Pas miratimit, rregulloret u komunikohen punonjësve dhe pasqyrohen në procedurat e punës. Gjatë viteve 2028–2029 ndiqet zbatimi dhe bëhen rishikime sipas nevojës. Ky proces përfshihet si aktivitet, dhe afati i miratimit përshtatet me përfundimin e shqyrtimit dhe vendimmarrjen e organit kompetent.

7.5 Sfidat dhe pengesat

KMDK përballet me një sërë sfidash të brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale. Nga aspekti financiar, kufizimet buxhetore dhe vonesat në arkëtimin e pagesave nga konsumatorët publikë përbëjnë një pengesë të vazhdueshme, duke rritur varësinë nga mbështetja e donatorëve. Në nivel operacional, infrastruktura e vjetruar dhe pajisjet e pamjaftueshme e të vjetëruara krijojnë vështirësi për sigurimin e një shërbimi të qëndrueshëm, deri në implementimin e Programit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave II-IV.

Nga perspektiva mjedisore, deponitë ekzistuese paraqesin rrezik për zjarre, shpërthime, ndotjen e tokës, ajrit dhe ujërave deri në përfundimin e projekteve rehabilituese që janë në proces. Proceset e riciklimit dhe ndarjes së mbeturinave në burim janë ende në faza të hershme. Korniza ligjore, ndonëse pjesërisht e harmonizuar me direktivat e BE-së, mbetet sfiduese për t'u zbatuar plotësisht.

7.6 Faktorët e suksesit

Përballë këtyre sfidave, një numër faktorësh kyç kontribuojnë në rritjen e shanseve për sukses të KMDK-së. Së pari, zbatimi i standardeve ndërkombëtare është një element vendimtar: sipas tabelave 14 dhe 16, certifikimi me ISO 9001 dhe ISO 45001 synohet më 2027, ndërsa certifikimi me ISO 14001 synohet më 2028, sipas gatishmërisë dhe buxhetit. Zbatimi dhe mirëmbajtja e këtyre sistemeve do të rrisin besueshmërinë e ndërmarrjes dhe do të forcojnë përputhshmërinë me kërkesat e BE-së. Po ashtu, investimet në infrastrukturë moderne si deponitë sipas standardeve të BE-së, impiantet e trajtimit mekaniko-biologjik, si dhe zhvillimi i kapaciteteve për riciklim e kompostim do të jenë shtylla kryesore të transformimit.

Digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve mbetet një tjetër faktor i rëndësishëm suksesi. Aplikimi i automatizimit të proceseve, përdorimi i inteligjencës artificiale dhe Microsoft 365 për lehtësim të punës dhe monitorim, si dhe integrimi i analizës së të dhënave për vendimmarrje më të mirë do të rrisin ndjeshëm efikasitetin operacional dhe transparencën në KMDK.

Në këtë kuadër, burimet njerëzore përbëjnë një tjetër aset thelbësor: rekrutimi i bazuar në meritë i stafit të kualifikuar, trajnimi i vazhdueshëm dhe motivimi përmes politikave të qarta të zhvillimit profesional janë kusht për sukses. Partneritetet dhe bashkëpunimi me institucionet publike, donatorët do të sigurojnë burime shtesë dhe eksperiencë të vlefshme.

Një faktor tjetër vendimtar është kultura e përmirësimit të vazhdueshëm përmes auditimeve, rishikimeve të menaxhimit dhe aplikimit të mekanizmave të matjes së performancës. Së fundi, përfshirja aktive e shoqërisë civile, qytetarëve dhe ngritja e ndërgjegjësimit publik për reduktim të mbeturinave, riciklim dhe praktika të qëndrueshme do të sigurojnë mbështetje afatgjatë për arritjen e objektivave strategjike të KMDK-së.

8. Analiza SWOT


FUQITË	DOBËSITË
• **Ofruesit i vetëm në nivel shtetëror**: KMDK është kompania e vetme qendrore për menaxhimin e deponive në Kosovë. • **Përvoja shumëvjeçare**: Me përvojë që nga themelimi në vitin 2005, ofron shërbime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. • **Qasje e re menaxheriale**: Struktura e re menaxheriale është profesionale dhe me bazë në meritë. • **Rritja e transparences** Institucion më transparant me të gjitha palët e interesit. • **Kënaqshmëria e klientëve**: Vlerësime pozitive nga klientët për cilësinë e shërbimeve. • **Qëndrueshmëria financiare**: Rritje e vazhdueshme e të hyrave si rezultat i përformacës së mirë të punës. • **Projekte zhvillimore**: Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve për zbatimin e projekteve zhvillimore	• **Mungesa e lejeve institucionale**: Ende mungojnë lejet dhe pëlqimet e nevojshme nga institucionet përkatëse. • **Tarifa të ulëta**: Tarifat aktuale nuk reflektojnë koston reale të shërbimeve. • **Llogaritë e arkëtueshme**: Borxhet e akumuluara të klientëve, pavarësisht uljes së tyre konsiderohen si sfidë në vazhdim. • **Pajisje të amortizuara**: Pamundësi për zëvendësimin e mjeteve të vjetra për shkak të kufizimeve buxhetore. • **Mungesë infrastrukture**: Mungon një objekt i zyreve qëndrore në pronësi të KMDK si dhe infrastruktura për mirëmbajtjen e makinerisë së rëndë.
MUNDËSITË	**KËRCËNIMET**
• **Zgjerimi i infrastrukturës**: Mundësi për ndërtimin e kapaciteteve moderne për menaxhimin e mbeturinave. • **Modernizimi i sistemit të burimeve njerëzore**: Zhvillimi i një sistemi të avancuar të menaxhimit të stafit. • **Zgjerimi gjeografik**: Mundësi për të shtrirë shërbimet në tërë territorin e Kosovës. • **Diversifikimi i shërbimeve**: Zgjerimi i veprimtarive përtej deponimit, përfshirë trajtime të tjera të mbeturinave. • **Digjitalizimi dhe modernizimi**: Zbatimi i sistemeve të mençura për rritjen e cilësisë dhe efikasitetit. • **Rritja e efikasitetit operacional**: Zvogëlim i kostove përmes përmirësimit të proceseve dhe teknologjive. • **Ofrimi i shërbimeve për personat fizik**: Mbrojtja e mjedisit, zvogëlimi i deponive ilegale dhe rritja e të hyrave përmes pranimit të mbeturinave nga personat fizik. • **Përdorimi efektiv i mjeteve digjitale:** Përdorimi i plotë i mjeteve teknologjike në dispozicion të paketës për ndërveprim të stafit (Microsoft 365).	• **Rreziqe mjedisore**: Rreziku nga shembja e deponive (p.sh. DS Mirash), zjarret, shpërthimet, kontaminimi i tokës, ndotja e ujit dhe ajrit. • **Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në punë:** Rreziqet e stafit ndaj ekspozimit të rreziqeve fizike, kimike, biologjike dhe operacionale. • **Konteste ligjore**: Rreziku potencial i humbjes eventuale të rasteve gjyqësore nga kontestet e punës dhe ato me operatorët ekonomik. • **Qasje e pa-autorizuar në deponi**: Rrezik për aksidente për shkak të hyrjes së personave të pa-autorizuar në deponi. • **Problemi me qentë endacak:** Numri i lartë i qenëve endacak nëpër deponi, shkakton rrezik për punëtorët e deponisë. • **Faktorët e jashtme**: Ndryshimet politike, institucionale, inflacioni, pandemitë, ndikimet globale që ndikojnë në funksionimin e kompanisë.

Tabela 15. Analiza SWOT e KMDK-së për periudhën 2027–2029.

9. Struktura Organizative

9.1 Organogrami funksional

Struktura organizative e KMDK përbën bazën e funksionimit të kompanisë dhe përcakton rolet, përgjegjësitë dhe mënyrën e qeverisjes së saj. Ajo siguron koordinim të qartë ndërmjet niveleve menaxheriale, njësive funksionale dhe stafit operativ, duke mundësuar ofrimin efikas të shërbimeve dhe arritjen e objektivave strategjike.



9.2 Qeverisja dhe mbikëqyrja

Qeverisja e KMDK është e strukturuar për të siguruar transparencë, përgjegjësi dhe mbikëqyrje të pavarur. Bordi i Drejtorëve luan rolin kryesor në përcaktimin e strategjive dhe miratimin e politikave, ndërsa Menaxhmenti Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e tyre në nivel operacional.

- Mbikëqyrja e performancës realizohet përmes raporteve periodike financiare dhe operacionale.
- Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm mbështet përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe standardet e planifikuara në tabelën 16. Për ISO 9001 dhe ISO 45001 synohet certifikimi më 2027, ndërsa për ISO 14001 synohet certifikimi më 2028, sipas gatishmërisë dhe buxhetit. Gjatë viteve pasuese parashikohen kontrollet, auditimet, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemeve sipas rezultateve.
- Proceset e qeverisjes janë të orientuara drejt integritetit, transparencës dhe menaxhimit të rrezikut.

9.3 Struktura e stafit

Në fillim të vitit 2027, BNj dhe Financat e përditësojnë numrin e punonjësve me listën e pagave, pozitat e miratuara, vendet vakante dhe shpërndarjen administratë–operativë. Raporti i përditësimit është baza për rekrutim dhe për planifikimin e pagave.

- Stafi drejtues dhe menaxherial – përgjegjës për planifikim strategjik, menaxhim departamental dhe vendimmarrje.
- Stafi teknik dhe operativ – përfshin punonjësit në terren që kryejnë praniminlimin, transportin, shtrirjen dhe kompaktimin e mbeturinave si dhe mirëmbajtjen e pajisjeve.
- Stafi administrativ dhe mbështetës – që mbulon financat, HR, IT dhe shërbimet e tjera të brendshme.

KMDK synon të forcojë kapacitetet e fuqisë punëtore përmes trajnimeve të vazhdueshme, zbatimit të politikave për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe krijimit të një kulture organizative që promovon profesionalizëm, përgjegjësi dhe inovacion.

9.4 Analiza e nevojave për ngritje të kapaciteteve

Për periudhën 2027–2029, KMDK-ja propozon plotësimin e strukturës organizative me pozita të reja dhe shtimin e numrit të punonjësve në disa pozita ekzistuese. Këto nevoja lidhen me zgjerimin e menaxhimit të deponive, mirëmbajtjen e makinerive dhe mbulimin e punëve teknike e administrative.

Propozohen dy (2) pozita të reja:

Pozita	Numri i punëtorëve
Inxhinier i Makinerisë	1 punëtor
Zyrtar për Prokurim	1 punëtor

Për më tepër, shtohet numri i ekzekutueseve (për 2 ekzekutues) tek kategoria mekanik.

Për dy deponitë që planifikohet të merren në menaxhim gjatë vitit 2027 parashihen tetë (8) punonjës në Pejë dhe shtatë (7) në Zveçan. Modeli i sasive parashikon Pejën nga prilli dhe Zveçanin nga janari 2027; këto janë supozime buxhetore dhe jo zëvendësim i datës së përcaktuar në marrëveshjen e transferimit. BNj dhe DF harmonizojnë muajt e pagave me datën efektive të marrjes në menaxhim.

Pozita	DS Pejë	DS Zveçan
Menaxher i deponisë	1 punëtor	1 punëtor
Urëmatës/Mbikëqyrës i Sektorëve	4 punëtor	3 punëtor
Operator i Makinerisë së Rëndë	3 punëtor	2 punëtor
Punëtor Fizik për Hortikulturë	0 punëtor	1 punëtor

Njësia e re organizative për menaxhimin e mbetjeve vëllimore

Gjatë vitit 2027, KMDK Sh.A. planifikon themelimin e një njësie të re organizative për menaxhimin e mbetjeve vëllimore, me qëllim të zgjerimit të veprimtarisë dhe përmirësimit të shërbimeve në fushën e menaxhimit të mbetjeve.

Për funksionalizimin e kësaj njësie parashihet angazhimi i përafërsisht 10 punonjësve, varësisht nga nevojat operative dhe kapacitetet financiare të ndërmarrjes.

Struktura organizative, mënyra e funksionimit, përgjegjësitë, kompetencat, sistematizimi i vendeve të punës dhe çështjet e tjera që lidhen me organizimin e kësaj njësie do të përcaktohen dhe rregullohen përmes akteve të brendshme nënligjore të ndërmarrjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me miratimin e organeve kompetente.

10. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Burimet njerëzore janë një nga asetet më të rëndësishme të KMDK, pasi cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve varen drejtpërdrejt nga profesionalizmi, motivimi dhe siguria e stafit. Politikat e BNj-e janë të orientuara drejt ndërtimit të një fuqie punëtore të aftë, të përkushtuar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të punës dhe sigurisë.

10.1 Planifikimi i fuqisë punëtore dhe rekrutimi

Rekrutimi planifikohet duke vlerësuar, para hapjes së pozitës, ngarkesën reale, kërkesat ligjore, aftësitë ekzistuese, mundësinë e riorganizimit dhe koston e plotë vjetore. Përparësi kanë rolet që lidhen me vazhdimësinë e shërbimit, sigurinë, mirëmbajtjen, monitorimin mjedisor, menaxhimin e kontratave dhe zhvillimin e projekteve.

- Analiza e nevojave kryhet çdo vit dhe dokumenton numrin e vendeve, arsyetimin dhe alternativat.
- Përshkrimet e punës lidhen me kompetencat, licencat kur kërkohen me ligj dhe treguesit e performancës.
- Pozitat për shërbime të reja aktivizohen vetëm pasi projekti të ketë model operimi dhe burim të qëndrueshëm financiar.
- Procesi i rekrutimit, orientimit dhe periudhës provuese dokumentohet dhe rishikohet nga BNj dhe njësia pranuese.

10.4 Performanca dhe rreziku i BNj-së

Rreziqet kryesore janë mungesa e zëvendësimit për role kritike, humbja e njohurive, mungesa e licencave kur kërkohen, mbingarkesa dhe rekrutimi pa analizë. Masat përfshijnë vlerësimin periodik, planin individual të zhvillimit, dokumentimin e proceseve dhe planifikimin e pasardhësve.

10.5 Politikat e Burimeve Njerëzore

Politikat e Burimeve Njerëzore të KMDK janë të ndërtuara mbi parimet e barazisë, transparencës dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke garantuar që çdo punonjës të ketë një ambient pune të drejtë, të sigurt dhe motivues.

Mundësi të barabarta

- Të gjithë punonjësit trajtohen me respekt dhe drejtësi, pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, besimit fetar apo statusit social.
- Politikat e rekrutimit dhe promovimit janë të bazuara në meritë dhe kompetencë, duke siguruar shanse të barabarta për të gjithë kandidatët dhe punonjësit.
- KMDK synon të promovojë diversitetin dhe përfshirjen në vendin e punës, duke e konsideruar atë si një faktor që pasuron kulturën organizative dhe rrit kreativitetin.

Siguria në punë

- Ndërmarrja synon të implementojë në mënyrë të plotë kërkesat e standardit ISO 45001 për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Siguria në punë

- Ndërmarrja synon të implementojë në mënyrë të plotë kërkesat e standardit ISO 45001 për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Realizohen vlerësime të rregullta të rrezikut për të identifikuar dhe minimizuar rreziqet në vendin e punës.
- Punonjësit pajisen me mjete personale mbrojtëse (MPM) dhe trajnohen rregullisht për përdorimin e tyre.
- Promovohet një kulturë sigurie, ku çdo punonjës inkurajohet të raportojë rreziqet dhe incidentet pa frikë nga penalizimi, duke kontribuar në një mjedis pune më të sigurt.

Motivimi

- Zhvillohen politika të qarta për shpërblim financiar dhe jo-financiar, përfshirë bonuse për performancë, njohje publike dhe mundësi zhvillimi profesional.
- Punonjësit përfshihen në proceset vendimmarrëse që lidhen me aktivitetet e përditshme dhe projektet strategjike, duke rritur ndjenjën e përkatësisë dhe përgjegjësisë.
- Krijohen kushte për balancë punë–jetë, përmes orareve fleksibile, pushimeve të rregullta dhe mbështetjes për mirëqenie.
- Implementohen programe të motivimit afatgjatë, si mentorimi, zhvillimi i karrierës dhe fushata për ndërtimin e një kulture organizative pozitive.
- Në këtë mënyrë, politikat e BNj të KMDK kontribuojnë jo vetëm në përmirësimin e klimës së brendshme të punës, por edhe në rritjen e performancës organizative dhe arritjen e objektivave strategjike.

11. Plani Operacional

Plani operacional i KMDK përcakton aktivitetet konkrete dhe prioritetet për zbatim gjatë periudhës së planifikuar, duke siguruar që objektivat strategjike të përkthehen në veprime praktike. Ky plan fokusohet në përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, zgjerimin në fusha të reja të menaxhimit të mbeturinave dhe implementimin e teknologjive moderne për rritjen e efikasitetit.

11.1 Aktivitetet kryesore

- Ofrimi i shërbimeve të rregullta për deponimin e mbeturinave.
- Mirëmbajtja dhe operimi i deponive sanitare sipas standardeve.
- Zbatimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve mjedisore përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe ndërtimit të kapaciteteve monitoruese.

11.2 Zhvillimi i teknologjisë dhe infrastrukturës

- Investime në pajisje moderne për trajtim mbeturinash, me efikasitet më të lartë energjie dhe ndikim më të ulët mjedisor.
- Zhvillimi i qendrave të reja të grumbullimit dhe transferimit për të optimizuar logjistikën.
- Përmirësimi i infrastrukturës së deponive për të përmbushur standardet kombëtare dhe të BE-së, përfshirë sistemet e drenazhimit dhe menaxhimit të gazrave.
- Ndërtimi i deponive të reja moderne, të projektuara dhe të operuara në përputhje me standardet e BE-së, duke garantuar siguri mjedisore, jetëgjatësi dhe kapacitet të mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave në afat të gjatë.

11.3 Digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve

- Digjitalizimi i komunikimit, procesimit dhe ruajtjes së të dhënave përmes adaptimit të infrastrukturës teknologjike të përshtatshme për nevojat e KMDK, duke balancuar prakticitetin dhe kostot e mirëmbajtjes.
- Automatizimi i raportimit dhe integrimi i tij me sistemet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë.

- Aplikimi i analizës së të dhënave për monitorimin e performancës, identifikimin e tendencave dhe përcaktimin e fushave për përmirësim.
- Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) për parashikimin e volumit të mbeturinave, planifikimin proaktiv të burimeve dhe monitorimin në kohë reale të pajisjeve dhe infrastrukturës.
- Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave – integrimi i masave të forta të sigurisë për të mbrojtur informacionin kritik dhe përputhshmërinë me standardet e privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

12. Standardet dhe Kornizat Ndërkombëtare

KMDK synon certifikimin ISO 9001 dhe ISO 45001 gjatë vitit 2027 dhe ISO 14001 gjatë vitit 2028. Afatet janë objektiva planifikimi, të kushtëzuara me auditimin e gatishmërisë, mbylljen e gjetjeve dhe mbulimin e kostos së certifikimit. Për secilin sistem përdoret edicioni dhe periudha kalimtare e zbatueshme në kohën e certifikimit. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit vazhdojnë pas auditimit.

12.1 Udhërrëfyesi i sistemeve ISO

Sistemi	2027 – baza	2028 – zbatimi	2029 – pjekuria/vendimi
ISO 9001: Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë	Auditim gatishmërie dhe certifikim i synuar më 2027.	Përmirësime nga gjetjet dhe auditimet.	Vazhdim sipas performancës dhe vendimit të menaxhmentit.
ISO 14001: Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit	Aspektet, regjistri ligjor dhe kontrollet prioritare.	Auditim dhe certifikim i synuar më 2028, sipas gatishmërisë dhe buxhetit.	Mirëmbajtja e sistemit dhe auditimet përkatëse.
ISO 45001: Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë	Kontrolle, trajnim, auditim dhe certifikim i synuar më 2027, sipas gatishmërisë.	Kontrolle prioritare, trajnim dhe auditim i brendshëm.	Mirëmbajtje dhe përmirësim sipas rezultateve të auditimit.
Sistemi i integruar	Kontroll dokumentesh, auditim dhe CAPA të harmonizuara.	Rishikim i përbashkët menaxherial.	Një kalendar, regjistër veprimesh dhe dashboard.

Tabela 16. Udhërrëfyesi për zbatimin dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit sipas standardeve ISO, 2027–2029.

12.2 Përdorimi proporcional i standardeve dhe kornizave

KMDK përdor vetëm ato pjesë të standardeve që përmirësojnë kontrollin dhe raportimin. Plani nuk premton certifikim të ri pa analizë të boshllëkut, kapacitet dhe buxhet të miratuar.

- **ISO 9001:** kontrolli i proceseve, dokumenteve, ankesave dhe masave korrigjuese.
- **ISO 14001:** aspektet mjedisore, lejet, monitorimi dhe reagimi ndaj devijimeve.
- **ISO 45001:** rreziqet e sigurisë, kontraktorët, kompetencat dhe hetimi i incidenteve.
- **Kërkesat E&S:** zbatohen sipas marrëveshjes së projektit, ESIA/LRP-ve dhe mekanizmit të ankesave.

13. Investimet dhe Aktivitetet e Planifikuara

13.1 Programi për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV

Gjatë periudhës së zbatimit të Planit të Biznesit 2027–2029, pritet të vazhdojë implementimi i Programit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave II–IV, i financuar nga Qeveria Gjermane (përmes KfW), Bashkimi Evropian (BE) dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Ky program synon përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve deponuese dhe avancimin e standardeve mjedisore e operative.

Programi për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV është investimi më i madh zhvillimor i KMDK-së dhe njëkohësisht prova kryesore e aftësisë së ndërmarrjes për të kaluar nga përgatitja e projektit te zbatimi, pranimi dhe operimi i qëndrueshëm i aseteve. Projektimi, prokurimi, kërkesat mjedisore e sociale, pronësia, disbursimi, pranimi i aseteve, trajnimi dhe kostoja pas përfundimit duhet të lidhen në të njëjtin plan. Nëse njëra hallkë mbetet pa pronar ose pa financim, vonesa teknike kthehet shpejt në ekspozim financiar dhe operativ për KMDK-në. Ky program përfaqëson një nga ndërhyrjet më të rëndësishme

infrastrukturore në sektorin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, me synim përmirësimin e standardeve mjedisore, efikasitetit operacional dhe sigurisë publike në deponitë sanitare dhe stacionin e transferit.

Faza e parë (2027–2028)

Në grupin e parë të projekteve pritet të vazhdojnë dhe të përfundojnë punimet për rehabilitimin dhe zgjerimin e deponive, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të reja deponuese, sistemet për menaxhimin e ujërave të ndotura dhe gazrave, si dhe sigurimin e infrastrukturës dhe makinerisë së nevojshme. Projektet e kësaj faze janë:

- **Deponia e Prizrenit-** rehabilitimi, mbyllja dhe hapja e qelizave të reja.
- **Deponia e Gjilanit-** rehabilitimi, mbyllja dhe hapja e qelizave të reja.
- **Deponia e Pejës-** rehabilitimi, mbyllja dhe hapja e qelizave të reja.
- **Deponia e Podujevës** – rehabilitimi dhe zgjerimi i deponisë sanitare.
- **Mbyllja e Deponisë së Istogut** – mbyllja sipas standardeve mjedisore.

Faza e dytë (2027–2029)

Në grupin e dytë parashihet avancimi i projekteve për ndërtimin e infrastrukturës së re, ku përfshihen:

- **Deponia e re për rajonin e Prishtinës – projekt i veçantë nga mbyllja e deponisë ekzistuese në Mirash; avancimi dhe ndërtimi varen nga lokacioni, projektimi, lejet, financimi dhe kontrata.**
- **Stacioni i Transferit në Ferizaj** – ndërtimi i stacionit për përmirësimin e efikasitetit të transportit të mbeturinave në rajonin jugor.

Shtrirja, qeverisja dhe struktura e financimit

Programi mbulon rehabilitimin dhe zgjerimin e deponive në Prizren, Pejë dhe Gjilan; përcaktimin e lokacionit dhe zhvillimin e deponisë së re për regjionin e Prishtinës; mbylljen e deponisë në Istog; si dhe ndërhyrjet në ST Ferizaj dhe deponinë sanitare në Podujevë. Për zbatim më të mirë të projektit është krijuar PIU e cila koordinon produktet teknike, lejet, kërkesat mjedisore e sociale, kontratat dhe përgatitjen për operim.

PIU koordinon projektimin, dokumentet e prokurimit, mbikëqyrjen teknike dhe përgatitjen e pranimit, ndërsa DO përcakton nevojat e operimit e mirëmbajtjes. DF kontrollon burimin, zotimet, disbursimet, pagesat dhe regjistrimin e aseteve. Masat mjedisore dhe sociale, përfshirë ESIA-n, menaxhimin e ankesave dhe rikthimin e mjeteve të jetesës, ndiqen krahas punimeve. Shumat dhe dallimi ndërmjet financimit të programit dhe të hyrave të kompanisë shpjegohen në seksionin 18.4.

Plani i aktiviteteve 2027–2029

Fusha	2027	2028	2029
Projektimi/prokurimi	Mbyllen ose avancohen dokumentet sipas paketave të aprovuara.	Zbatohen vetëm kontratat e lidhura dhe menaxhohen ndryshimet.	Përfundimi/pranimi bëhet sipas afateve kontraktuale.
Lejet, prona dhe aspketi medisor dhe social	Mbyllen kushtet që janë përgjegjësi e KMDK-së dhe institucioneve përkatëse.	Monitorohen kushtet, ankesat dhe masat e projektit.	Detyrimet e mbetura kalojnë me pronar dhe afat.
Punët fizike	Fillojnë vetëm paketat me kushte dhe financim të mbyllur.	Vijojnë sipas planit të kontratës dhe kontrollit të cilësisë.	Testim dhe dorëzim vetëm kur kriteret plotësohen.

Fusha	2027	2028	2029
Financat	Pajtohen kontrata, burimi, kontributet dhe profili i pagesave.	Raportohet zotimi, disbursimi, pagesa dhe devijimi.	Pajtohen asetet, grantet dhe detyrimet.

Tabela 17. Aktivitetet e planifikuara në kuadër të Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV, 2027–2029.

Fazat janë orientuese ku afati i secilit komponent mbetet ai i marrëveshjes dhe kontratës së aprovuar; mosmbyllja e lejes, pronës, financimit ose kriterit të sigurisë e ndalon kalimin në fazën pasuese.

Rreziqet kritike dhe kontrolli

Rreziku i mundshëm	Masat për menaxhimin e rrezikut	Ndikimi i mundshëm
Vonesat në sigurimin e lejeve dhe autorizimeve	Koordinimi me institucionet përgjegjëse dhe monitorimi i procedurave	Shtyrje e afateve të realizimit
Çështjet pronësore dhe lokacionet	Bashkëpunimi institucional për zgjidhjen e çështjeve pronësore	Vonesa në realizimin e investimeve
Ndryshimet në projektim dhe procedurat e prokurimit	Rishikimi teknik dhe monitorimi i procedurave	Vonesa dhe kosto shtesë
Sigurimi i financimit për disa pjesë të projektit	Koordinimi me financuesit dhe institucionet përgjegjëse	Ndikim në dinamikën e investimeve
Funksionalizimi i infrastrukturës së re	Planifikimi i kapaciteteve njerëzore, teknike dhe financiare	Vështirësi në operim dhe mirëmbajtje

Tabela 18. Rreziqet kritike dhe masat e kontrollit në zbatimin e Programit për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV.

Qëndrueshmëria, ESG-ja dhe SDG-të

Programi lidhet me ESG-në përmes rezultateve të drejtpërdrejta, si p.sh. kontrolli i ujërave dhe gazit, siguria, mbyllja e lokacioneve, kushtet e punës, masat për grupet e prekura dhe gatishmëria për mirëmbajtje. Këto rezultate lidhen ngushtë me SDG 6, 8, 9, 11, 12, 13, 15, 16 dhe 17 dhe raportohen vetëm me evidencën e projektit.

Për secilin aset të ri, KMDK përcakton para pranimit koston specifike, stafin, pjesët, monitorimin, përgjegjësinë mjedisore dhe burimin e financimit. Rrjedhimisht, kjo është prova praktike e qëndrueshmërisë së investimit.

13.2 Programet e tjera zhvillimore dhe investive

Programet e mëposhtme përgatiten në bashkëpunim me ministritë, komunat dhe partnerët zhvillimorë, brenda kompetencave të KMDK-së. Për secilin përcaktohen problemi, produktet, përgjegjësitë, kostoja dhe kushtet për investim. Përgatitja e një koncepti nuk krijon detyrim për ndërtim; projektet pa financim të përcaktuar mbeten në fazën e zhvillimit deri në vendimin përkatës.

13.2.1 Pikat ndarëse të mbeturinave

Pika e propozuar pranë deponisë së Gjilanit synon ndarjen e materialeve të rikuperueshme dhe zvogëlimin e fraksionit që deponohet. Modeli duhet të përcaktojë nëse pranon mbeturina të përziera apo fraksione të ndara, sepse kjo ndryshon teknologjinë, cilësinë e produktit, kushtet e punës dhe koston për ton.

Gjatë vitit 2027, DPZh dhe DO përgatisin bilancin e materialeve, analizën e lokacionit, rrjedhën e punës, nevojat për staf dhe krahasimin e alternativave. Fizibiliteti përfshin sasinë e siguruar, përqindjen e materialit të shitshëm, destinacionin e mbetjeve të refuzuara dhe të hyrat vetëm nga tregu i dokumentuar.

Gjatë vitit 2028 synohen projektimi dhe procedurat e financimit e lejeve; zbatimi ose prova gjatë 2029 bëhet vetëm nëse këto kushte plotësohen. Zgjerimi në rajone të tjera mbështetet në rezultatet e pilotit, jo në një vendim paraprak për të njëjtën teknologji kudo.

Në planin e mëparshëm përmendet mbështetja buxhetore e ministrisë. Shuma, destinimi dhe disponueshmëria e saj duhet të dokumentohen në vendimin ose marrëveshjen e financimit përpara kontraktimit. Kostoja e pikës së plotë nuk është zë i veçantë i investimeve vetanake në tabelën 32. Produkti i kësaj faze është një projekt i kostuar dhe i gatshëm për vendimmarrje.

13.2.2 Zgjidhja për rajonin e Mitrovicës

Marrja e deponisë së Zveçanit në menaxhim dhe zgjidhja afatgjatë për rajonin e Mitrovicës janë dy çështje të lidhura, por të ndryshme. E para ka ndikim të menjëhershëm në operim dhe buxhet; e dyta kërkon vlerësim të kapaciteteve, gjendjes mjedisore dhe alternativave për të gjithë zonën e shërbimit.

Gjatë vitit 2027 inventarizohen flukset, kapaciteti i mbetur, pronësia, lejet dhe nevojat urgjente. Gjatë vitit 2028 krahasohen përmirësimi i kapaciteteve ekzistuese, transferimi drejt kapaciteteve të tjera dhe infrastruktura e re. Analiza përfshin distancat, tarifën e nevojshme, ndikimin te komunitetet dhe koston e mbylljes së kapaciteteve të vjetra.

Deri më 2029 synohet propozim ndërinstitucional me alternativën e rekomanduar, përgjegjësinë e operimit dhe planin e financimit. Një deponi e re nuk paraqitet si investim i financuar nga Programi II–IV pa konfirmim të shtrirjes së tij. DPZh koordinon analizën; menaxhmenti dhe institucionet kompetente vendosin për modelin rajonal.

13.2.3 Mbyllja dhe rikultivimi i deponisë së Mirashit

KMDK vazhdon përgjegjësinë për operimin e sigurt dhe masat e kontrollit në Mirash gjatë përgatitjes së mbylljes. Ndërhyrjet për ujërat dhe gazin të përmendura në planifikimin e vitit 2026 trajtohen si veprime për të cilat duhet të dokumentohen realizimi dhe detyrimet e mbetura; kalimi i vitit nuk provon përfundimin dhe nuk arsyeton bartjen automatike të të njëjtit aktivitet si investim i ri.

Për bazën e vitit 2027, DO, DPZh dhe DF përgatisin pasqyrën e gjendjes me kontratat, punët e pranuara, pagesat, kapacitetin e sistemeve dhe mangësitë. Detyrimet e kontraktuara në 2026 paraqiten si bartje, kurse ndërhyrjet shtesë si nevoja të reja. Kjo ndarje shmang financimin dy herë të së njëjtës punë.

Gjatë vitit 2027 prioritet kanë kontrolli i rrjedhjeve, kullimi, matjet e gazit, siguria dhe dokumentacioni i mbylljes. Gjatë 2028–2029 synohet zbatimi me etapa i profilimit, mbulimit përfundimtar dhe sistemeve të menaxhimit të ujërave e gazit, sipas projektit dhe financimit. Mbyllja e pranimit të mbeturinave kushtëzohet me kapacitet alternativ të ligjshëm dhe funksional për rajonin e Prishtinës.

Projekti përmban veçmas koston e punimeve, monitorimit dhe mirëmbajtjes pas mbylljes. Masat rutinë mbulohen nga mirëmbajtja e miratuar; sistemi i plotë dhe mbyllja përfundimtare kërkojnë preventiv e burim të posaçëm. Në këtë plan nuk deklarohet si i përfunduar investim i vitit 2026 pa dokumentin e pranimit, as si i financuar investim i ri pa vendimin përkatës.

13.2.4 Trajtimi i fraksionit të pareciklueshëm

Fraksioni i mbetur pas ndarjes vlerësohet mbi bazën e karakterizimit të mbeturinave sipas stinës, origjinës dhe përbërjes. Përqindja 33% e përdorur në planin e mëparshëm nuk përdoret si parametër projektimi pa matje përfaqësuese. Ndarja e materialeve të riciklueshme dhe largimi i fraksioneve të papranueshme paraprijnë përzgjedhjen e trajtimit.

Gjatë vitit 2027 kryhen kampionimi, bilanci i masës dhe analiza e lagështisë e përbërjes. Gjatë vitit 2028 krahasohen paratrajtimi, trajtimi mekanik-biologjik, përgatitja e RDF-së dhe alternativat e tjera të lejueshme. Për RDF vlerësohen cilësia, fuqia kalorifike, kërkesat e përdoruesit, distanca e transportit dhe kostoja e mbetjes që ende duhet deponuar.

Trajtimi termik vlerësohet vetëm si alternativë teknike, me analizë të emetimeve, mbetjeve të djegies, lejeve dhe kostos gjatë ciklit jetësor. Përzgjedhja nuk paracaktohet në këtë plan. Deri më 2029 synohet një studim me alternativën e rekomanduar, tarifën për mbulimin e kostos, modelin e kontraktimit dhe kërkesën

për financim. Nuk planifikohen të hyra nga shitja e RDF-së ose energjisë pa treg dhe kapacitet të dokumentuar.

13.2.5 Rrjeti i stacioneve të transferit

Planifikimi i stacioneve mbështetet në krahasimin e kostos së transportit të drejtpërdrejtë me koston e transferimit dhe transportit të konsoliduar. Analiza merr parasysh tonët vjetorë, distancat, kohën e udhëtimit, ngarkesën e automjeteve, numrin e udhëtimeve dhe kapacitetin e deponisë pranuese.

Gjatë vitit 2027 DO dhe DPZh përgatisin inventarin dhe hartën e flukseve; gjatë 2028 propozojnë lokacionet dhe renditjen sipas përfitimit ekonomik e mjedisor. Për Gerlicën/Ferizajn qartësohen lokacioni dhe lidhja me komponentin përkatës të Programit II–IV. Propozimi përcakton pronësinë, përgjegjësinë e menaxhimit, pajisjet dhe pagesën e shërbimit.

Gjatë vitit 2029 zbatohen vetëm projektet me financim dhe kushte të plotësuara. Kostoja e rrjetit të ri nuk konsiderohet e mbuluar nga buxheti i zakonshëm i një stacioni ekzistues. Produkti për vendimmarrje është plan i kostuar dhe marrëveshje institucionale, jo vetëm listë lokacionesh.

13.2.6 Trajtimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi

Shërbimi i propozuar përfshin pranimin e kontrolluar, ndarjen, thërrmimin dhe klasifikimin e fraksioneve minerale të përshtatshme. Mbetjet me përbërës të rrezikshëm dhe materialet e papërshtatshme përjashtohen nga linja dhe dërgohen për menaxhim sipas kërkesave përkatëse. Cilësia e agregatit përcakton përdorimin dhe vlerën e tij.

Gjatë vitit 2027 bëhet analiza e sasive, lokacionit, kërkesave mjedisore dhe tregut. Për vitin 2028 planifikohen 300.000 € për pajisjen e përpunimit të inerteve. Para prokurimit verifikohet nëse kërkohet thërrmues, sitë, ndarës ose kombinim pajisjesh; emërtimi "Pajisje për përpunimin e inerteve" në tabelën 32 nuk zëvendëson specifikimin teknik.

Shuma 300.000 € mbulon zërin e pajisjes së planifikuar, jo automatikisht tokën, platformën, kullimin, energjinë, peshimin, kontrollin e pluhurit dhe operimin. Preventivi i plotë dhe burimi për këto komponentë miratohen përpara blerjes. Gjatë 2029 synohet prova operative dhe vlerësimi i kostos për ton, rendimentit dhe cilësisë së produktit; të hyrat nga agregati përfshihen vetëm pas dokumentimit të tregut.

13.2.7 Trajtimi i mbeturinave organike

Zgjidhja për organiket fillon me sigurinë e furnizimit me fraksion të ndarë dhe kontrollin e ndotjes me plastikë, metale e materiale të tjera. Përqindja orientuese 40% nuk mjafton për dimensionimin e një impianti; përdoren matje përfaqësuese të sasisë dhe cilësisë së fluksit që mund të mblidhet veçmas.

Gjatë vitit 2027 përcaktohen burimet e mundshme dhe marrëveshjet me komunat e operatorët. Gjatë 2028 krahasohen kompostimi dhe biodigjestioni, duke përfshirë sipërfaqen, aromat, ujërat, energjinë, stafin, koston për ton dhe përdorimin e kompostit ose digestatit. Mbetja biologjikisht e stabilizuar nga mbeturinat e përziera nuk trajtohet automatikisht si kompost i tregtueshëm.

Deri më 2029 synohet fizibiliteti dhe një pilot vetëm kur ka lokacion, leje, financim dhe përdorues të produktit. DPZh, DO dhe DF përcaktojnë koston e investimit e operimit dhe modelin e tarifimit. Shtrirja në disa rajone bëhet pas vlerësimit të pilotit; lista e qyteteve në planin e mëparshëm nuk përbën angazhim për ndërtim paralel në secilin qytet.

13.3 Vlerësimi dhe miratimi i investimeve

Projektet kalojnë nëpër hallka vendimmarrjeje, si, identifikimi i problemit, filtrimi, parafizibiliteti, fizibiliteti dhe analiza financiare, sigurimi i financimit, prokurimi dhe përgatitja për operim. Në çdo hallkë mund të merret vendim për vazhdim, ripunim, shtyrje ose ndalim.

- Përputhshmëria ligjore, mjedisore dhe pronësore verifikohet para projektimit të detajuar.
- Kostoja e plotë dhe ndikimi në tarifë, likuiditet e personel verifikohen para angazhimit financiar.
- KMDK nuk mban më shumë projekte aktive se sa mund të menaxhojë me ekipin dhe sistemet ekzistuese.

- Përfitimet mjedisore, energjetike dhe sociale maten me tregues dhe nuk përdoren si pretendime pa evidencë.

14. Plani i Marketingut dhe Komunikimit

Komunikimi i KMDK-së synon të shpjegojë qartë rolin e kompanisë, shërbimet që ofron dhe ecurinë e punëve e të projekteve. Përmes tij, klientët, institucionet, partnerët dhe qytetarët informohen për çështjet që i prekin dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Në punëtorinë e vitit 2026 u evidentua nevoja për të sqaruar më mirë përgjegjësitë e KMDK-së dhe për të informuar më rregullisht mbi përmirësimet në organizimin dhe punën e saj. Në veçanti, roli i kompanisë shpesh ngatërrohet me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave nga ekonomitë familjare

KMDK menaxhon deponitë sanitare dhe stacionet e transferimit nën përgjegjësinë e saj. Ajo pranon mbeturinat që dorëzohen nga operatorët dhe klientët dhe kujdeset për deponimin e tyre në kushte të kontrolluara, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga ekonomitë familjare kryhen nga operatorët përkatës.

14.1 Qëllimet dhe rezultatet e komunikimit

Qëllimi	Ndryshimi që po ndodh	KPI
COM1 · Mandati	Të kuptohet qartë çfarë bën KMDK.	FAQ e perditesuar.
COM2 · Progresi	Reformat, operimi dhe projektet të shpjegohen me fakt, datë dhe ndikim.	4 përmbledhje në vit
COM3 · Besimi ne KMDK	Transparenca, integriteti, standardet dhe përgjegjësia të duken në prova.	100% e pretendimeve të validuara para publikimit.
COM4 · Dobia	Bordi, klientët, ofertuesit, partnerët dhe akademia të gjejnë informacion të përdorshëm.	Burim zyrtar i përditësuar
COM5 · Sistemi	Komunikimi të mos varet nga përpjekja ad hoc e një personi.	Pronar/aprovues, verifikim.

Tabela 19. Qëllimet, rezultatet e synuara dhe treguesit e komunikimit.

14.2 Audiencat, temat dhe kanalet

Audienca	Cka nevojitet	Mjeti kyresor
Bordi, aksionari dhe institucionet	Performancë, rrezik, projekte, financa dhe vendim i kërkuar.	Raport/dashboard, memo vendimi dhe webfaqja zyrtare.
Komunat, KRM-të dhe klientët	Kapacitet, procedurë, tarifë, faturim, ndryshim shërbimi dhe çështje të hapura.	Takime operative, njoftime, FAQ dhe raport klienti.
Qytetarët dhe komunitetet	Mandati, ndikimi mjedisor, siguria, ankesat dhe progresi i konfirmuar.	Webfaqja, Facebook/Instagram, takime dhe materiale shpjeguese.
Ofertuesit dhe furnitorët	Njoftime, afate, kërkesa dhe lidhje te dokumenti zyrtar.	Webfaqja/prokurimi si burim
IFI-të, partnerët dhe akademia	Status projekti, të dhëna, standarde, nevoja financimi dhe mundësi bashkëpunimi.	Project fiche
Punonjësit	Prioritetet, faktet, rolet, afatet e inputit dhe i njëjti shpjegim institucional.	Briefime të brendshme, modeli i inputit dhe banka e përmbajtjes.

Tabela 20. Audiencat, nevojat për informacion dhe mjetet e komunikimit.

Webfaqja është burimi zyrtar i referencës për mandatin, shërbimet, raportet, projektet, prokurimin, FAQ-të dhe kontaktet. Facebook dhe Instagram shpjegojnë rolin dhe punën në terren; LinkedIn mbështet besueshmërinë institucionale e profesionale; përmbledhja tremujore u shërben palëve që kanë nevojë për një pamje të strukturuar, si vijon.

- **Roli dhe vlera publike:** mandati, rruga e mbeturinës, mjedisi dhe shëndeti publik.
- **Transformimi dhe qeverisja:** sistemet, raportimi, financat, integriteti dhe standardet.
- **Operimi dhe infrastruktura:** deponitë, pajisjet, siguria, kapaciteti dhe Programi II–IV.

- **Mjedisi dhe e ardhmja:** monitorimi, energjia, klima, ekonomia qarkore dhe projektet e reja pa tejkaluar mandatin aktual.
- **Transparenca dhe shërbimet:** prokurimi, njoftimet, kërkesat e klientëve dhe të dhënat e aprovuara.
- **Njerëzit dhe partneritetet:** aftësitë, puna në terren, akademia, komunat dhe financuesit.

16. Digjitalizimi

Digjitalizimi është një nga shtyllat strategjike të transformimit të KMDK-së dhe një parakusht për rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare. Investimi në teknologji digjitale jo vetëm që përmirëson performancën operative, por gjithashtu rrit besimin e publikut, ulë kostot dhe kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm. Digjitalizimi ka vlerë kur heq futjen e dyfishtë, zbulon gabimin më herët dhe i jep drejtuesit një shifër të njëjtë në raportin operativ e financiar. KMDK nis nga sistemet që tashmë përdor, si p.sh. Microsoft 365 dhe peshoret; dhe i lidh ato gradualisht me faturimin, asetet, mirëmbajtjen, mjedisin dhe raportimin.

16.1 Prioritetet e të dhënave dhe sistemeve

Fusha	Rezultati	Pronari
Peshore–financa	Kode të njëjta për klientin, shërbimin dhe tarifën; pajtim i çdo impianti.	Financa/IT/Operativa
Sistemi i menaxhimit te burimeve njerezore	Sistem elektronik i menaxhimit të burimeve njerëzore	DSHM
E-arkiva	Digjitalizim i arkivës dhe protokolit, software	DSHM
Active directory (Microsoft 365)	Sistem elektronik i komunikimit dhe aplikimit të Microsoft 365	DSHM
Asetet dhe mirëmbajtja	Regjistër, urdhra pune, servis, pjesë, ndalesa dhe kosto.	Operativa/Financa/IT
Dashboard-i	Tonazh, arkëtim, kosto/ton, pajisje, mjedis, siguri dhe projekte.	IT/DPZh
GIS	Lokacione, pika monitorimi, kapacitete, incidente dhe projekte.	DPZh
Dokumentet/workflow	Emërtim, versionim, aprovime, afate dhe arkivim.	Sh.mbeshtetese
Siguria kibernetike	MFA, privilegje, antivirus, backup 3-2-1 dhe test rikuperimi.	IT
Cilësia e të dhënave	Rregulla validimi, pronarë, burim primar dhe toleranca të miratuara.	Pronarët e të dhënave

Tabela 21. Prioritetet për digjitalizimin, rezultatet e synuara dhe njësitë përgjegjëse.

17. Sasitë historike dhe projeksionet e mbeturinave 2027–2029

17.1 Mbeturinat komunale nga KRM dhe operatorët privatë

Në këtë plan, emërtimi i mëparshëm "mbeturina nga amvisëritë" i referohet fluksit të mbeturinave komunale të dorëzuara nga KRM-të dhe operatorët privatë. Ai nuk nënkupton se KMDK kryen grumbullimin te amvisëritë dhe as se e gjithë sasia vjen vetëm nga familjet. Kategoria e klientit dhe lloji i mbeturinës regjistrohen veçmas në peshore dhe në faturim.

Viti 2025 është periudhë historike. Tabela 30 paraqet 415.154 tonë për këtë vit dhe 434.238 tonë për vitin 2026; shtesa është 19.084 tonë, ose rreth 4,60%. Për vitin 2026, tabela 23 e ndan totalin në 338.839 tonë nga KRM-të dhe 95.399 tonë nga operatorët privatë. Këto vlera shërbejnë si bazë krahasimi për planin 2027 dhe nuk janë provë e realizimit të plotë të vitit 2026.

Sasitë e stacionit të transferit përdoren për planifikimin e shërbimit të tij. Në raportimin e fluksit fizik kombëtar, e njëjta ngarkesë që transferohet dhe më pas pranohet në deponi numërohet vetëm një herë. DO dhe DF mbajnë lidhjen ndërmjet fletëpeshimeve dhe shërbimit të faturuar, që të mos ngatërrohet sasia e shërbimeve me masën unike të deponuar.

Periudha	Total 2026	DS Gjilan	DS Podujeve	DS Prishtinë	DS Prizren	STF Ferizaj	DS Pejë	DS Zveçan	Total 2027	Total 2028	Total 2029
Janar	**30,734**	4,085	1,512	15,258	9,555	1,860	-	566	**32,837**	**34,807**	**36,547**
Shkurt	**25,480**	3,207	1,250	13,111	7,532	1,654	-	469	**27,223**	**28,857**	**30,299**
Mars	**34,480**	4,124	1,485	18,525	10,394	1,676	-	635	**36,839**	**39,050**	**41,002**
Prill	**34,593**	5,059	1,684	17,367	10,617	1,596	4,223	637	**41,183**	**43,654**	**45,837**
Maj	**33,994**	4,840	1,548	17,051	10,696	1,558	4,150	626	**40,470**	**42,898**	**45,043**
Qershor	**34,948**	4,820	1,490	19,268	9,268	1,850	4,267	644	**41,606**	**44,102**	**46,307**
Korrik	**48,511**	6,850	1,864	26,358	13,101	2,763	5,923	894	**57,752**	**61,218**	**64,279**
Gusht	**45,720**	6,694	2,046	21,217	15,428	2,621	5,582	842	**54,431**	**57,696**	**60,581**
Shtator	**37,895**	5,441	1,763	18,450	12,264	1,871	4,627	698	**45,114**	**47,821**	**50,212**
Tetor	**35,819**	5,027	1,629	18,109	10,922	1,923	4,373	660	**42,643**	**45,202**	**47,462**
Nentor	**34,113**	4,793	1,553	17,231	10,412	1,829	4,165	628	**40,612**	**43,049**	**45,201**
Dhjetor	**37,951**	5,356	1,733	19,113	11,623	2,024	4,633	699	**45,181**	**47,892**	**50,287**
Total	**434,238**	**60,297**	**19,558**	**221,059**	**131,812**	**23,225**	**41,943**	**8,000**	**505,892**	**536,246**	**563,058**

Tabela 22. Planifikimi mujor i sasive të mbeturinave sipas deponive dhe Stacionit të Transferit në Ferizaj, 2026–2029.

Sasia e planifikuar prej 505.892 tonësh për vitin 2027 është 71.654 tonë, ose 16,50%, mbi bazën 434.238 tonë të vitit 2026. Kjo rritje ndahet në 21.711 tonë në perimetrin ekzistues (+5,00%) dhe 49.943 tonë nga përfshirja e Pejës e Zveçanit. Rritja 16,50% nuk përdoret si normë e rritjes organike të lokacioneve ekzistuese. Sasitë në tabelat e këtij kapitulli paraqiten të rrumbullakosura; për këtë arsye, mbledhja e zërave të shfaqur mund të japë diferenca të vogla ndaj totalit të tabelës. Shpjegimet dhe grafiqet përdorin vlerat e paraqitura në tabelat përkatëse.

Tabela 22a. Ndarja e rritjes sipas perimetrit të shërbimit


Elementi	Tonë	Ndikimi kundrejt bazës 2026
Lokacionet ekzistuese – baza 2026	434.238	100,00%
Rritja në lokacionet ekzistuese	21.711	5,00 pikë përqindjeje
Lokacionet ekzistuese – 2027	455.949	Rritje e krahasueshme 5,00%
Peja – prill–dhjetor 2027	41.943	9,66 pikë përqindjeje
Zveçani – janar–dhjetor 2027	8.000	1,84 pikë përqindjeje
Gjithsej 2027	505.892	Rritje totale 16,50%

Për vitet 2028 dhe 2029, totali i planit rritet me 6% dhe 5%, në 536.246 dhe 563.058 tonë. Këto janë supozime të planifikimit dhe duhen testuar kundrejt kontratave, kapaciteteve pritëse dhe të dhënave mujore. Për Pejën, baza 2027 përmban nëntë muaj; një vit i plotë operimi në 2028 kërkon rillogaritje të veçantë të efektit të tre muajve shtesë. Norma 6% nuk dëshmon vetvetiu se ky efekt është përfshirë.

DS Prishtinë përfaqëson 221.059 tonë ose 43,7% të planit 2027, ndërsa DS Prizren 131.812 tonë ose 26,1%. Peja paraqitet ndaras me 41.943 tonë dhe Zveçani me 8.000 tonë. Datat e fillimit të tyre janë supozime të modelit mujor; ndryshimi i datës efektive kërkon përditësim të sasive, faturimit, pagave dhe shpenzimeve të operimit në të njëjtin rishikim buxhetor.

Shpërndarja mujore parashikon ngarkesën më të lartë gjatë muajve të verës, veçanërisht në korrik, me 57.752, dhe gusht, me 54.431. Vëllimi më i ulët parashikohet në shkurt, me 27.223. Këto projeksione shërbejnë si bazë për planifikimin e kapaciteteve operative, angazhimin e personelit dhe makinerive, si dhe vlerësimin e të hyrave dhe kostove për periudhën 2027–2029.

Grafiku në vijim paraqet sasitë mujore të shërbimeve të planifikuara për vitin 2027.



Sasitë e pranuara sipas kategorive të klientëve

Periudha	Total 2026	DS Gjilan	DS Podujeve	DS Prishtinë	DS Prizren	STF Ferizaj	DS Pejë	DS Zveçan	Total 2027	Total 2028	Total 2029
Unit	**338,839**	56,416	17,575	149,375	118,478	13,937	31,716	6,242	**393,740**	**417,364.14**	**438,232.35**
Unit Private	**95,399**	3,881	1,983	71,683	13,334	9,288	10,226	1,758	**112,153**	**118,881.74**	**124,825.83**
Total	**434,238**	**60,297**	**19,558**	**221,059**	**131,812**	**23,225**	**41,943**	**8,000**	**505,892**	**536,246**	**563,058**

Tabela 23. Përmbledhja e sasive të mbeturinave sipas kategorive dhe deponive për periudhën 2026–2029.


Ndarja e sasive të planifikuara sipas kategorive të klientëve tregon se kompanitë rajonale të mbeturinave (KRM) do të përbëjnë burimin kryesor të mbeturinave të pranuara në deponi dhe në stacionin e transferimit. Për vitin 2027, nga sasia e përgjithshme e planifikuar prej 505,892 tonësh, rreth 393,740 tonë, ose 77.8%, parashikohen nga KRM-të, ndërsa 112,153 tonë, ose 22.2%, nga operatorët privatë.

Krahasuar me vitin 2026, sasia e përgjithshme për vitin 2027 parashikohet të rritet me 16.5%. Sasitë nga KRM-të planifikohen të rriten me 16.2%, ndërsa ato nga operatorët privatë me 17.6%. Për vitet 2028 dhe 2029 parashikohet rritje vjetore përkatësisht prej 6% dhe 5% në të dyja kategoritë, duke e çuar vëllimin e përgjithshëm në rreth 536,246 dhe 563,058 tonë. Pesha relative e dy kategorive mbetet pothuajse e pandryshuar gjatë periudhës planifikuese.

Për KRM-të, pas veçimit të Pejës dhe Zveçanit, vëllimi i krahasueshëm 2027 është rreth 355.782 tonë kundrejt 338.839 tonëve më 2026, afërsisht +5%. Për privatët është rreth 100.169 tonë kundrejt 95.399 tonëve, gjithashtu afërsisht +5%.

Sipas lokacioneve, DS Prishtinë dhe DS Prizren përbëjnë peshën kryesore të sasive të planifikuara nga KRM-të. Ndërkohë, sasitë nga operatorët privatë janë të përqendruara kryesisht në DS Prishtinë, ku parashikohen 71,683 tonë, ose rreth 63.9% e totalit të kësaj kategorie për vitin 2027. Kjo shpërndarje shërben si bazë për planifikimin e kapaciteteve pritëse, angazhimin e personelit dhe mekanizimit, si dhe përllogaritjen e të hyrave sipas lokacioneve dhe kategorive të klientëve.

Grafiku në vijim paraqet sasitë e planifikuara për vitin 2027 sipas lokacioneve.



17.2 Mbeturinat për asgjësim, produktet e pakonsumueshme, dheu dhe personat fizikë

Periudha		Total 2026	DS Gjilan	DS Podujeve	DS Prishtinë	DS Prizren	STF Ferizaj	DS Pejë	DS Zveçan	Total 2027	2028	2029
Asgjesim	Ton	5,787	228	13	3,621	369	1,821	393	-	6,444	6,767	7,105
Pa konsumueshme	Ton	1,400	8	17	524	403	501	421	-	1,873	1,967	2,065
Persona Fizik	Ton	333	481	107	208	31	26	110	-	964	1,012	1,063
Dheu	Ton	7,432	-	201	7,603	-	-	7,432	-	15,237	15,998	16,798
Total - Ton		**14,952**	**717**	**339**	**11,956**	**803**	**2,348**	**8,356**	**-**	**24,518**	**25,744**	**27,031**


Tabela 24. Planifikimi i sasive të mbeturinave për asgjësim dhe kategorive të tjera, 2026–2029.

Për periudhën 2027–2029 parashikohet rritje e sasive të pranuara në kategoritë: mbeturina për asgjësim, produkte të pakonsumueshme, mbeturina nga persona fizikë dhe dhe. Për vitin 2027, sasia e përgjithshme planifikohet të arrijë në 24,518 tonë, krahasuar me 14,952 tonë në vitin 2026, duke shënuar rritje prej 9,566 tonësh, ose rreth 64%. Për vitet 2028 dhe 2029 parashikohet rritje vjetore prej rreth 5%, me sasi përkatësisht prej 25,744 dhe 27,031 tonësh.

Peshën kryesore në strukturën e vitit 2027 e përbën dheu, me 15,237 tonë, ose rreth 62.1% të totalit. Pasojnë mbeturinat për asgjësim me 6,444 tonë, produktet e pakonsumueshme me 1,873 tonë dhe mbeturinat nga persona fizikë me 964 tonë. Rritja e sasisë së dheut përbën rreth 81.6% të shtesës së përgjithshme të planifikuar kundrejt vitit 2026, duke qenë faktori kryesor i ndryshimit të vëllimit.

Sipas shpërndarjes së planifikuar, DS Prishtinë dhe DS Pejë së bashku përfaqësojnë rreth 82.8% të sasisë së përgjithshme për vitin 2027. Ky përqendrim kërkon që planifikimi i kapaciteteve pritëse, mekanizimit dhe personelit të mbështetet në sasitë dhe karakteristikat e materialeve që parashikohen të pranohen në këto lokacione.

Grafiku në vijim paraqet sasitë e kategorive të tjera të planifikuara për vitin 2027 sipas lokacioneve.



18. Projeksionet Financiare

18.1 Përmbledhje e Përgjithshme

Projeksionet 2027–2029 mbështeten në shitjen e shërbimeve ekzistuese, zgjerimin e perimetrit të operimit dhe të hyrat e planifikuara nga interesi. Në pasqyrën bazë, të hyrat nga grantet janë 0 € për secilin vit. Financimi kapital i Programit II–IV ndiqet veçmas; ai nuk përdoret si shtesë automatike e të hyrave operative ose e fitimit. Rezultatet janë parashikime para tatimit dhe kushtëzohen nga realizimi i sasive, arkëtimi, kostot dhe supozimet financiare. Vlerat financiare në tabela paraqiten të rrumbullakosura në euro të plota. Përmbledhjet dhe shpjegimet mbështeten në totalet e tabelave përkatëse; diferencat e vogla nga mbledhja ose zbritja e zërave të rrumbullakosur nuk trajtohen si zëra shtesë buxhetorë.

18.2 Të hyrat, shpenzimet dhe rezultati para tatimit

Kategoritë (zërat) e të hyrave dhe shpenzimeve		Rishikimi 2026	PASH (€)			Rishikimi 2026 vs PASH 2027 (€)	
		Total 2026	Total 2027	Total 2028	Total 2029	Ndryshimi	Ndryshimi ne %
I - TË HYRAT							
A	**Totali i të hyrave nga shitjet (A.5+A.10)**	**4,844,234**	**6,145,143**	**6,501,618**	**6,826,699**	**1,300,909**	**27%**
B	**A.14 Totali i të hyrave tjera(a11+a12+a13)**	**40,219**	**160,843**	**256,248**	**348,620**	**120,624**	**300%**
C	**Totali i të hyrave të përgjithshme (Sek. A+B)**	**4,884,453**	**6,305,986**	**6,757,865**	**7,175,319**	**1,421,533**	**29%**
II- SHPENZIMET							
D	**Totali i Shpenzimeve ne Direkte**	**1,922,750**	**2,876,476**	**2,766,549**	**2,903,127**	**953,726**	**49.6%**
	Totali I shpenzimeve Indirekte	**967,960**	**1,160,815**	**1,245,859**	**1,337,549**	**192,856**	**20%**
	Totali i shpenzimeve operative (SEK.D)	**2,890,709**	**4,037,291**	**4,012,408**	**4,240,675**	**1,146,582**	**40%**
	Shpenzimet për provizionet e llogarive të arkëtueshme (P)	50,000	50,000	100,000	150,000	-	0%
D	**III. Fitimi operativ para zhvlerësimit (C-D-P)**	**1,943,744**	**2,218,695**	**2,645,457**	**2,784,643**	**274,951**	**14.1%**
H	IV. Amortizimi-Shpenzimet e zhvlerësimit	338,646	400,000	450,000	500,000	61,354	18%

Kategoritë (zërat) e të hyrave dhe shpenzimeve		Rishikimi 2026	PASH (€)			Rishikimi 2026 vs PASH 2027 (€)	
		Total 2026	Total 2027	Total 2028	Total 2029	Ndryshimi	Ndryshimi ne %
	V. Fitimi/humbja para të hyrave jo operative (III-IV)	**1,605,097**	**1,818,695**	**2,195,457**	**2,284,643**	**213,598**	**13%**
	VI. Të hyrat jo-operative		0			-	
	VII. Fitimi/humbja e vitit para tatimit (V+VI)	**1,605,097**	**1,818,695**	**2,195,457**	**2,284,643**	**213,598**	**13%**

Tabela 25. Projeksioni i të hyrave, shpenzimeve dhe rezultatit financiar për periudhën 2027–2029.

Pasqyra e planifikuar e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2027–2029 parashikon rritje të të hyrave dhe rezultat pozitiv financiar në të tri vitet. Për vitin 2027, të hyrat e përgjithshme planifikohen në 6,305,986 €, kundrejt 4,884,453 € sipas rishikimit të vitit 2026, duke shënuar rritje prej 1,421,533 €, ose rreth 29.1%. Kontributin kryesor në këtë rritje e japin të hyrat nga shitjet, të cilat parashikohen të arrijnë në 6,145,143 €, ndërsa të hyrat tjera planifikohen në 160,843 €.

Shpenzimet operative për vitin 2027 parashikohen në 4,037,291 €, me rritje prej rreth 39.7% krahasuar me vitin 2026. Shpenzimet direkte planifikohen në 2,876,476 €, ndërsa shpenzimet indirekte në 1,160,815 €. Ritmi më i lartë i rritjes së shpenzimeve kundrejt të hyrave ndikon në uljen e marzhit të fitimit para tatimit nga rreth 32.9% në vitin 2026 në 28.8% në vitin 2027, megjithëse fitimi në vlerë absolute parashikohet të rritet.

Pas përfshirjes së shpenzimeve për provizionet e llogarive të arkëtueshme prej 50,000 € dhe zhvlerësimit prej 400,000 €, fitimi para tatimit për vitin 2027 planifikohet në 1,818,695 €, ose rreth 13.3% më shumë se në vitin 2026. Për vitet 2028 dhe 2029, të hyrat e përgjithshme parashikohen përkatësisht në 6,757,865 € dhe 7,175,319 €, ndërsa fitimi para tatimit në 2,195,457 € dhe 2,284,643 €. Realizimi i këtyre rezultateve do të varet nga përmbushja e planit të shitjeve, kontrolli i shpenzimeve dhe menaxhimi i arkëtimit të kërkesave.

18.2.1 Të Hyrat (2027–2029)

Kategoritë (zërat) e të hyrave dhe shpenzimeve		Rishikimi 2026	PASH (€)			Rishikimi 2026 vs PASH 2027 (€)	
		Total 2026	Total 2027	Total 2028	Total 2029	Ndryshimi	Ndryshimi ne %
I - TË HYRAT							
	a.1 Të Hyrat nga KRM-të	3,515,403	4,453,197	4,720,388	4,956,408	937,794	27%
	a.2 Të hyrat nga mbeturinat e pakonsumueshme nga KRM-të	51,292	73,104	76,760	80,597	21,812	43%
	a.3 Të hyrat nga asgjesimet Klient Publik	68,820	134,756	141,494	148,569	65,937	96%
	a.4 Të hyrat tjera nga sherbimet Publike	-		0	0	-	
	A.5 Totali i të hyrave nga Klientet Publike (a1+a2+a3+a4)	**3,635,514**	**4,661,057**	**4,938,642**	**5,185,574**	**1,025,543**	**28%**
A	a.6 Të Hyrat nga Bizneset Private	982,686	1,268,446	1,344,553	1,411,780	285,760	29%
	a.7 Të hyrat nga mbeturinat e pakonsumueshme nga bizneset private	118,205	20,554	21,581	22,661	(97,652)	-83%
	a.8 Të hyrat nga asgjësimet	100,251	187,468	196,841	206,684	87,217	87%
	a.9 Të hyrat tjera - Dheu	7,577	7,618			41	1%
	A.10 Totali i të hyrave nga Klientet Private (a6+a7+a8+a9)	**1,208,720**	**1,484,086**	**1,562,975**	**1,641,124**	**275,366**	**23%**
	Totali i të hyrave nga shitjet (A.5+A.10)	**4,844,234**	**6,145,143**	**6,501,618**	**6,826,699**	**1,300,909**	**27%**
	a.11 Të hyrat nga grantet	-	0	0	0	-	
	a.12 Të hyrat nga interesi	-	149,940	244,800	336,600	149,940	
B	a.13 Të hyrat tjera P.Fizik	40,219	10,903	11,448	12,020	(29,316)	-73%
	A.14 Totali i të hyrave tjera(a11+a12+a13)	**40,219**	**160,843**	**256,248**	**348,620**	**120,624**	**300%**
C	**Totali i të hyrave të përgjithshme (Sek. A+B)**	**4,884,453**	**6,305,986**	**6,757,865**	**7,175,319**	**1,421,533**	**29%**

Tabela 26. Planifikimi i të hyrave sipas kategorive për periudhën 2027–2029.

Të hyrat e përgjithshme për vitin 2027 planifikohen në 6,305,986 €, krahasuar me 4,884,453 € sipas rishikimit të vitit 2026, duke shënuar rritje prej 1,421,533 €, ose rreth 29.1%. Burimin kryesor e përbëjnë të hyrat nga shitjet e shërbimeve, të planifikuara në 6,145,143 €, të cilat përfaqësojnë rreth 97.4% të të hyrave të përgjithshme.

Të hyrat nga klientët publikë parashikohen në 4,661,057 €, me rritje prej 28.2% kundrejt vitit 2026, dhe përbëjnë rreth 75.8% të shitjeve të planifikuara. Kontributin kryesor e japin shërbimet ndaj KRM-ve, me të hyra prej 4,453,197 €. Gjithashtu, parashikohet rritje e të hyrave nga mbeturinat e pakonsumueshme dhe shërbimet e asgjësimit për klientët publikë, përkatësisht në 73,104 € dhe 134,756 €.

Të hyrat nga klientët privatë planifikohen në 1.484.086 €, ose rreth 22,8% më shumë se në vitin 2026. Rritja mbështetet kryesisht në shërbimet e zakonshme, 1.268.446 €, dhe asgjësimet, 187.468 €. Të hyrat nga produktet e pakonsumueshme të privatëve ulen nga 118.205 € në 20.554 €, me ulje të paraqitur në tabelë prej 97.652 €; kjo lëvizje kërkon kontroll të sasive dhe klasifikimit sipas klientëve.

Të hyrat tjera për vitin 2027 planifikohen në 160,843 €, prej të cilave 149,940 € nga interesi dhe 10,903 € nga shërbimet për personat fizikë. Për vitet 2028 dhe 2029, të hyrat e përgjithshme parashikohen të arrijnë përkatësisht në 6,757,865 € dhe 7,175,319 €, me rritje vjetore prej rreth 7.2% dhe 6.2%. Realizimi i këtij projeksioni kërkon përmbushjen e sasive të planifikuara, zbatimin e tarifave përkatëse dhe realizimin e supozimeve mbi të hyrat nga interesi.

Baza e llogaritjes së të hyrave të planifikuara

Sipas tabelës 26, të hyrat nga shitjet rriten nga 4.844.234 € në vitin 2026 në 6.145.143 € në vitin 2027. Shtesa prej 1.300.909 € përfaqëson rritje rreth 26,9%. Për vitet 2028 dhe 2029, shitjet planifikohen përkatësisht në 6.501.618 € dhe 6.826.699 €.

Tabela 26 parashikon 0 € të hyra nga grantet në secilin nga vitet 2027–2029. Të hyrat nga interesi planifikohen në 149.940 €, 244.800 € dhe 336.600 €, ndërsa të hyrat nga personat fizikë në 10.903 €, 11.448 € dhe 12.020 €, përkatësisht. Këta janë zërat që përbëjnë të hyrat tjera të planifikuara; financimi kapital i programit trajtohet veçmas.

Tabela 26a. Faktorët e planifikimit për kategoritë e të hyrave

Kategoria	Vlera 2027	Baza dhe kontrolli i supozimit
a.1 KRM	4.453.197 €	Tonët e planifikuar sipas lokacionit × tarifa kontraktuale × muajt e shërbimit. Mesatarja e nënkuptuar është rreth 11,31 €/ton; nuk zëvendëson tarifën e miratuar.
a.2 Të pakonsumueshme nga KRM	73.104 €	Sasia e kësaj kategorie dhe tarifa përkatëse; ndarje nga mbeturinat e zakonshme dhe nga asgjësimet.
a.3 Asgjësime nga klientët publikë	134.756 €	Kërkesa/kontrata të identifikuara, tonazhi dhe tarifa e shërbimit; certifikatat e asgjësimit dhe faturat të rakorduara.
a.4 Shërbime të tjera publike	0 €	Nuk përfshihen të hyra pa shërbim të përcaktuar dhe bazë për faturim.
a.6 Biznese private	1.268.446 €	Tonazhi i privatëve dhe tarifa për lokacion; mesatarja e nënkuptuar është rreth 11,31 €/ton.
a.7 Të pakonsumueshme nga privatët	20.554 €	Ulja 97.652 € ndaj 118.205 € më 2026 kërkon kontroll të listës së klientëve, sasive dhe klasifikimit. Nuk interpretohet si ulje tarife pa vendim.
a.8 Asgjësime nga privatët	187.468 €	Kontratat, sasitë e posaçme dhe tarifa; të kontrollohet nëse ndonjë fluks është zhvendosur nga a.7, pa deklaruar riklasifikim të paprovuar.
a.9 Dheu	7.618 €	Tonazhi i parashikuar dhe tarifa e zbatueshme; vlera nënkupton afërsisht 0,50 €/ton. Sasitë për përdorim të brendshëm nuk trajtohen si shitje.

Kategoria	Vlera 2027	Baza dhe kontrolli i supozimit
a.11 Grantet	0 €	Skenari bazë nuk njeh të hyra të reja nga grantet. Çdo ndryshim kërkon dokumentacion të grantit dhe analizë kontabël.
a.12 Interesi	149.940 €	Gjendja mesatare e depozitueshme × norma kontraktuale × kohëzgjatja. Fondet me destinim dhe nevojat e likuiditetit kufizojnë shumën që mund të depozitohet.
a.13 Persona fizikë	10.903 €	Sasitë, regjistrimi i çdo pranimi dhe tarifa; pagesat e menjëhershme rakordohen me peshoren dhe arkën.

Në përputhje me Vendimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. prot. 3148, të datës 02.12.2022, i cili përcakton rritjen vjetore të tarifës së deponimit të mbeturinave komunale për 1 € për ton deri në vitin 2027, duke filluar nga 1 janari 2027, tarifa në deponitë e menaxhuara nga KMDK Sh.A. rritet nga 10.31 €/ton në 11.31 €/ton. Ky ndryshim përfaqëson rritje prej 9.70% kundrejt tarifës së vitit 2026 dhe është marrë për bazë në planifikimin e të hyrave për vitin 2027, në funksion të qëndrueshmërisë financiare, operative dhe mjedisore të ndërmarrjes.

Rritja e të hyrave vetëm nga shtesa e tarifës prej 1 €/ton është rreth 505,892 € për vitin 2027, nëse tarifa prej 11.31 €/ton zbatohet për të gjithë sasinë e planifikuar në këto dy kategori.

Llogaritja bëhet duke mbajtur të pandryshuar sasinë e planifikuar për vitin 2027:

Kategoria	Të hyrat me tarifën 10.31 €/ton	Të hyrat me tarifën 11.31 €/ton	Efekti i rritjes së tarifës
410-01 – Hedhja e mbeturinave, klientë publikë	4,059,457 €	4,453,197 €	393,740 €
420-01 – Hedhja e mbeturinave, klientë privatë	1,156,293 €	1,268,446 €	112,153 €
Totali	5,215,751 €	5,721,643 €	505,892 €

Vlerat janë rrumbullakosur veçmas në euro; për këtë arsye, shuma e rreshtave mund të dallojë nga totali për 1 €.

Duhet dalluar efekti i tarifës nga rritja e përgjithshme: këto dy kategori rriten gjithsej me 1,221,923 € ndaj buxhetit 2026. Nga kjo shumë, rreth 505,892 € i atribuohen ndryshimit të tarifës, ndërsa pjesa tjetër lidhet me ndryshimin e sasive të planifikuara, nën supozimin e së njëjtës tarifë për të dyja kategoritë.

Të hyrat e planifikuara nga deponitë e Pejës dhe Zveçanit arrijnë së bashku në 564,851 €, duke përbërë 8.96% të të hyrave të përgjithshme të buxhetit 2027.

Deponia	Të hyrat e planifikuara 2027	Pjesëmarrja në të hyrat e përgjithshme
Pejë	474,371 €	7.52%
Zveçan	90,480 €	1.43%
Gjithsej	564,851 €	8.96%

Përqindjet janë llogaritur ndaj totalit të buxhetit prej 6,305,986 €. Nëse krahasimi bëhet vetëm me të hyrat nga hedhja e mbeturinave të klientëve publikë dhe privatë, prej 5,721,642 € sipas tabelës së bashkëngjitur, pjesëmarrja e këtyre dy deponive është 9.87%.

18.2.2 Shpenzimet operative (2027–2029)

	Kategoritë (zërat) e të hyrave dhe shpenzimeve	Rishikimi 2026	PASH (€)			Rishikimi 2026 vs PASH 2027 (€)	
		Total 2026	Total 2027	Total 2028	Total 2029	Ndryshimi	Ndryshimi ne %
II- SHPENZIMET							
	Shp.Pagave Direkte	915,070	1,143,393	1,200,562	1,260,590	228,322	25%
	Shpenzimet e derivateve	302,000	466,700	490,035	514,537	164,700	55%
	Shpenzimet e mirembajtjes DS	499,775	702,000	714,350	748,318	202,225	40%
	Shpenzimet elektrike DS	13,526	13,613	14,294	15,008	87	1%
	Shpenzimet e Komunkimit DS	8,879	11,040	11,592	12,172	2,161	24%
	Shpenzimet e Admin Zyreve DS	33,550	21,600	22,680	23,814	(11,950)	-36%
	Kostot e Sigurimit DS	84,827	184,740	193,977	203,676	99,913	118%
	Shpenzimet e Qumeshtit dhe Ujit DS	3,120	2,800	2,940	3,087	(320)	-10%
	SHpenzimet e Udhetimit DS	2,000	15,000	15,750	16,538	13,000	650%
	Shpenz. me material DS	7,000	10,000	10,500	11,025	3,000	43%
	Shp.zhvill. mbesht. profes DS	36,000	273,790	56,480	59,303	237,790	661%
	Shp. Mirem.Veturave DS	17,000	31,800	33,390	35,060	14,800	87%
	Kontribute per komunitetitn	-	0			-	
	Totali i Shpenzimeve ne Direkte	**1,922,750**	**2,876,476**	**2,766,549**	**2,903,127**	**953,726**	**49.6%**
	Shpenzimet e pagave	475,773	519,723	545,710	572,995	43,950	9%
D	Shp.zhvill. dhe mbesht. profes	31,000	60,300	41,240	43,832	29,300	95%
	Shpenzimet e Komunikimit	600	7,800	8,190	8,600	7,200	1200%
	Shpenzimet e Qerasë	60,000	72,000	90,000	90,000	12,000	20%
	Shpenzimet Komunale	17,041	23,100	24,255	25,468	6,059	36%
	Materiali Harxhues per Zyre	25,800	42,116	44,222	46,433	16,316	63%
	Mirembatja e veturave	29,700	11,400	11,970	12,569	(18,300)	-62%
	Shpenzimet e Sigurimeve	7,000	12,300	12,915	13,561	5,300	76%
	Shpenzimet e Reprezenacionit	16,800	18,000	21,740	23,169	1,200	7%
	Shpenzimet e transportit	14,298	22,512	23,638	24,819	8,214	57%
	Regjistrimi i veturave	2,001	3,600	3,780	3,969	1,600	80%
	Shpenzimet e Publikimit	2,500	6,400	6,300	6,615	3,900	156%
	Auditimi I jashtëm	986	3,000	2,000	2,000	2,014	204%
	Shpenzimet tjera	284,461	358,564	409,900	463,520	74,103	26%
	Totali I shpenzimeve Indirekte	**967,960**	**1,160,815**	**1,245,859**	**1,337,549**	**192,856**	**20%**
	Totali i shpenzimeve operative (SEK.D)	**2,890,709**	**4,037,291**	**4,012,408**	**4,240,675**	**1,146,582**	**40%**
	Shpenzimet për provizionet e llogarive të arkëtueshme (P)	50,000	50,000	100,000	150,000	-	0%
	III. Fitimi operativ para zhvlerësimit (C-D-P)	**1,943,744**	**2,218,695**	**2,645,457**	**2,784,643**	**274,951**	**14.1%**
	IV. Amortizimi-Shpenzimet e zhvlerësimit	338,646	400,000	450,000	500,000	61,354	18%
D H	**V. Fitimi/humbja para të hyrave jo operative (III-IV)**	**1,605,097**	**1,818,695**	**2,195,457**	**2,284,643**	**213,598**	**13%**
	VI. Të hyrat jo-operative		0			-	
	VII. Fitimi/humbja e vitit para tatimit (V+VI)	**1,605,097**	**1,818,695**	**2,195,457**	**2,284,643**	**213,598**	**13%**

Tabela 27. Planifikimi i shpenzimeve operative sipas kategorive për periudhën 2027–2029.

Shpenzimet operative për vitin 2027 planifikohen në 4,037,291 €, krahasuar me 2,890,709 € sipas rishikimit të vitit 2026, duke shënuar rritje prej 1,146,582 €, ose rreth 39.7%. Shpenzimet direkte përbëjnë rreth 71.2% të totalit, ndërsa shpenzimet indirekte rreth 28.8%.

Shpenzimet direkte parashikohen në 2,876,476 €, me rritje prej 49.6% kundrejt vitit 2026. Zërat kryesorë janë pagat direkte me 1,143,393 €, mirëmbajtja e deponive me 702,000 € dhe derivatet me 466,700 €. Rritje të theksuar paraqesin edhe shpenzimet për zhvillim dhe mbështetje profesionale, të planifikuara në 273,790

€, si dhe kostot e sigurimit të deponive, në 184,740 €. Këta pesë zëra përbëjnë rreth 97.8% të rritjes neto të shpenzimeve direkte.

Shpenzimet indirekte planifikohen në 1,160,815 €, me rritje prej rreth 19.9%. Peshën kryesore e zënë pagat me 519,723 € dhe shpenzimet tjera me 358,564 €. Rritja përfshin gjithashtu shpenzimet për zhvillim dhe mbështetje profesionale, materialin harxhues për zyre dhe transportin. Shpenzimet e përgjithshme të pagave, direkte dhe indirekte, arrijnë në 1,663,116 €, duke përfaqësuar rreth 41.2% të shpenzimeve operative.

Për vitin 2028, shpenzimet operative parashikohen në 4,012,408 €, me ulje të lehtë prej rreth 0.6% kundrejt vitit 2027. Faktori kryesor i kësaj uljeje është reduktimi i shpenzimeve direkte për zhvillim dhe mbështetje profesionale nga 273,790 € në 56,480 €. Për vitin 2029, shpenzimet operative planifikohen në 4,240,675 €, me rritje prej rreth 5.7%.

Pas përfshirjes së provizioneve për llogaritë e arkëtueshme dhe shpenzimeve të zhvlerësimit, fitimi para tatimit parashikohet në 1,818,695 € për vitin 2027, 2,195,457 € për vitin 2028 dhe 2,284,643 € për vitin 2029. Realizimi i këtyre rezultateve kërkon kontroll të shpenzimeve dhe përmbushje të planit të të hyrave.

18.2.3 Pagat dhe faktorët e ndryshimit

Fondi aktual i pagave për 2027 është 1.663.116 €: 1.143.393 € për operimet dhe 519.723 € për administratën. Sipas kolonës së ndryshimeve të tabelës 27, shtesa e pagave direkte është 228.322 €, ndërsa ajo e pagave indirekte 43.950 €. Në tabelën e parasë, fondi i pagave për 2026 paraqitet në 1.390.844 € dhe rritja për 2027 në 272.272 €, ose 19,58%. Diferencat prej 1 € ndaj shumës së zërave të paraqitur në tabelën 27 rrjedhin nga rrumbullakimi.

Për 2028, pagat direkte dhe indirekte arrijnë gjithsej 1.746.272 €, ndërsa për 2029 në 1.833.585 €, me rritje afërsisht 5% në vit. Kjo është rritje e fondit të përgjithshëm dhe nuk përbën vendim për rritje uniforme të pagës individuale. Kostoja duhet të ndahet në numrin e punonjësve, muajt e angazhimit, pagën bazë, shtesat e lejueshme, kompensimet dhe kontributet e punëdhënësit.

Nevojat e paraqitura në tabelat e seksionit 9.4 përfshijnë dy pozita të reja qendrore, tetë punonjës në Pejë dhe shtatë në Zveçan. Seksioni parashikon gjithashtu shtimin e mekanikëve, me dy persona në numër, dhe angazhimin e përafërsisht 10 punonjësve për njësinë e mbetjeve vëllimore, varësisht nga nevojat dhe kapacitetet financiare. Këto nevoja nuk shumëzohen automatikisht me 12 muaj. BNj dhe DF përgatisin listën pozicion–pagë–muaj, duke dalluar rekrutimet, transferimet, zëvendësimet dhe pozitat vakante, për të verifikuar mbulimin brenda fondit të planifikuar të pagave.

Për vitin 2028, tabela 27 ndan fondin e pagave në 1.200.562 € shpenzime direkte dhe 545.710 € shpenzime indirekte, gjithsej 1.746.272 €. Për vitin 2029, këto kategori janë përkatësisht 1.260.590 € dhe 572.995 €, gjithsej 1.833.585 €.

Fondi i pagave për secilin vit përfshihet në shpenzimet operative të tabelës 27. Shpenzimet direkte lidhen me operimet, ndërsa shpenzimet indirekte me administratën. Planifikimi i fondit nuk përbën vetvetiu miratim të çdo pozite ose vendim për rritje uniforme të pagës individuale.

18.2.4 Baza e planifikimit të shpenzimeve

Shpenzimet planifikohen nga njësitë fizike dhe detyrimet konkrete: numër punonjësish dhe muaj angazhimi, orë makinerie, litra karburanti, kontrata mirëmbajtjeje, sipërfaqe, pika shërbimi dhe çmime. Rritja e perimetrit me Pejën e Zveçanin analizohet veçmas nga ndryshimi i çmimeve. Normat afërsisht 5% të disa zërave për 2028–2029 janë supozime buxhetore; ato nuk provojnë se çdo kosto do të rritet me të njëjtën normë.

Tabela 27a. Baza e kostimit të shpenzimeve operative

Kategoria	2027	Faktori i kostos dhe kontrolli
Pagat direkte / indirekte	1.143.393 € / 519.723 €	Pozita, paga, muajt, shtesat dhe kontributet; sipas 18.2.3.
Derivatet	466.700 €	Orët e makinerive dhe kilometrat × konsumi specifik × çmimi. Kontroll mujor i litrave për ton dhe i furnizimeve.

Kategoria	2027	Faktori i kostos dhe kontrolli
Mirëmbajtja e deponive	702.000 €	Preventiv sipas lokacionit: punë, materiale dhe ndërhyrje. Ndahen riparimet rutinë nga investimet që krijojnë ose përmirësojnë një aset.
Energjia elektrike DS	13.613 €	KWh sipas pikave të matjes, pajisjeve dhe muajve × tarifat përkatëse.
Komunikimi DS	11.040 €	Numri i lidhjeve dhe paketave × muajt e kontratës; kontroll me zërin e komunikimit qendror.
Administrimi i zyrave DS	21.600 €	Nevojat sipas lokacioneve dhe çmimet e furnizimeve; ulja ndaj 2026 të mbështetet në listën e njësive.
Sigurimi DS	184.740 €	Ndarja mes shërbimit fizik të sigurisë dhe policave të sigurimit; pika, orë ose asete të mbuluara × çmim.
Qumështi dhe uji DS	2.800 €	Numri i përfituesve, ditët e punës dhe sasia për njësi sipas politikës së miratuar.
Udhëtimet DS	15.000 €	Vizitat dhe ditët e angazhimit × kostot e lejuara; pa dyfishim me karburantin ose transportin.
Materialet DS	10.000 €	Lista e materialeve, sasia dhe çmimi; gjendja e magazinës zbritet nga nevoja e blerjes.
Zhvillimi dhe mbështetja profesionale DS	273.790 €	Ndarje e detyrueshme në trajnim, studim, matje ose shërbim tjetër, me produkt dhe kontratë; vlera nuk trajtohet e gjitha si konsulencë.
Mirëmbajtja e veturave DS	31.800 €	Flota, intervalet e servisit, pjesët dhe riparimet e parashikuara.
Zhvillimi dhe mbështetja profesionale qendrore	60.300 €	Produkti, numri i aktiviteteve dhe çmimi; koordinim me trajnimet dhe asistencën e financuar nga partnerët.
Komunikimi qendror	7.800 €	Përdorues, paketa dhe muaj; ndarje nga komunikimi DS.
Qiraja	72.000 €	Kontratat dhe muajt e përdorimit; buxheti rritet në 90.000 € për 2028 dhe 2029.
Shpenzimet komunale	23.100 €	Konsumi dhe tarifat e shërbimeve; ndarje nga shpenzimet elektrike të deponive.
Materiali harxhues i zyrës	42.116 €	Lista e artikujve dhe përdoruesve; pajisjet me jetë të gjatë shqyrtohen për trajtim kapital.
Mirëmbajtja e veturave qendrore	11.400 €	Serviset dhe riparimet për flotën administrative, pa mbivendosje me DS.
Sigurimet qendrore	12.300 €	Policat, periudha dhe rreziku i mbuluar; kontroll që i njëjti aset të mos buxhetohet dy herë.
Reprezentacioni	18.000 €	Aktivitetet e autorizuara dhe kufijtë përkatës; dokumentim i qëllimit dhe shpenzimit.
Transporti	22.512 €	Udhëtime, shërbime ose njësi transporti × çmim; kontroll ndaj derivateve dhe mirëmbajtjes.
Regjistrimi i veturave	3.600 €	Numri i automjeteve × kostoja dhe afati i regjistrimit.
Publikimet	6.400 €	Numri dhe lloji i publikimeve ose njoftimeve × çmim.

Kategoria	2027	Faktori i kostos dhe kontrolli
Auditimi i jashtëm	3.000 €	Fushëveprimi dhe kontrata; vlerat 2.000 € për 2028–2029 verifikohen me kërkesat e auditimit.
Shpenzimet e tjera	358.564 €	Ndarje analitike: rezerva operative 300.000 € dhe pjesa tjetër 58.564 €, sipas rakordimit me tabelën 28. Çdo shpenzim real klasifikohet sipas natyrës.
Provizionet dhe zhvlerësimi	50.000 € / 400.000 €	Provizionet sipas 18.2.5; zhvlerësimi sipas regjistrit të aseteve, jetës së dobishme dhe datës së vënies në përdorim.

Shpenzimet direkte të zhvillimit dhe mbështetjes profesionale bien nga 273.790 € më 2027 në 56.480 € më 2028, një ulje prej 217.310 €. Së bashku me mbështetjen qendrore, kjo kategori arrin 334.090 € më 2027, 97.720 € më 2028 dhe 103.135 € më 2029. Kjo shpërndarje është e përqendruar në vitin e parë dhe kërkon një listë produktesh e kontratash për të provuar cilat shpenzime janë njëherëshe.

18.2.5 Provizionet për llogaritë e arkëtueshme

Shumat 50.000 €, 100.000 € dhe 150.000 € për 2027–2029 janë shpenzime të planifikuara për zhvlerësimin e kërkesave; nuk janë automatikisht saldoja përfundimtare e provizionit dhe as pagesa në para. Ato nuk duhet të përdoren si përqindje arbitrare e të hyrave. Vlerësimi bëhet mbi llogaritë e arkëtueshme që ekzistojnë në datën e raportimit dhe rrezikun e mosarkëtimit.

DF përgatit analizën sipas klientit dhe faturës, duke veçuar kërkesat pa afat të kaluar, 1–30, 31–90, 91–180, 181–365 dhe mbi 365 ditë vonesë. Grupet ndahen edhe sipas karakteristikave të përbashkëta të rrezikut. Për secilin grup përcaktohet norma historike e humbjes, e përshtatur me informacionin aktual dhe pritjet e arsyeshme; rastet me kontest ose vështirësi të veçantë vlerësohen individualisht, pa numërim të dyfishtë.

Provizioni i kërkuar në fund = shuma e ekspozimit të secilit grup × norma përkatëse e humbjes së pritshme, plus vlerësimet individuale. Shpenzimi neto i vitit = provizioni në fund − provizioni në fillim + kërkesat e fshira kundrejt provizionit, me rregullimet përkatëse të lëvizjeve të tjera. Arkëtimi i një kërkese të vjetër dhe rikthimi i provizionit të saj janë transaksione të ndryshme dhe evidentohen veçmas.

Për kërkesat tregtare pa komponent të rëndësishëm financimi, qasja e thjeshtuar e IFRS 9 përdor humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës së kërkesës; matrica e vjetërsisë është një mënyrë praktike zbatimi, sipas politikës kontabël të kompanisë. Pa regjistrin e debitorëve, historikun e arkëtimeve dhe provizionin fillestar, shumat e buxhetit nuk mund të konsiderohen përllogaritje e verifikuar e humbjes. DF kryen vlerësimin në mbylljet periodike dhe propozon rishikim kur rezultati ndryshon materialisht nga buxheti.

18.3 Buxheti i Planifikuar (qarkullimi i përgjithshëm i parasë)

Nr.	Pozicionet e planifikuara	Buxheti I Rishikuar 2026	Buxheti Fillestar 2027	Ndryshimi (+/-)
	Saldo fillestare e mjeteve monetare	**2,519,561**	**5,100,886**	**2,581,325**
1	Arkëtimet nga aktiviteti operativ	4,844,234	6,156,046	1,311,811
2	Arkëtimet tjera	40,219	149,940	109,721
3	Arkëtimet nga llogaritë e arkëtueshme	2,000,049	1,000,000	(1,000,049)
B	**Gjithsej hyrjet operative**	**6,884,502**	**7,305,986**	**421,484**
4	Pagat	(1,390,844)	(1,663,116)	(272,272)
5	Shpenzimet operative në deponi	(1,007,679)	(1,733,083)	(725,403)
6	Shpenzimet administrative	(242,186)	(341,092)	(98,906)
7	Rezerva për shpenzime të paparashikuara	(250,000)	(300,000)	(50,000)
C	**Gjithsej shpenzime operative**	**-2,890,709**	**-4,037,291**	**-1,146,582**
8	Investimet kapitale	(1,162,468)	(745,000)	417,468
9	Rezerva kapitale (Kontingjenca)	(250,000)	(300,000)	(50,000)
D	**Gjithsej investime**	**-1,412,468**	**-1,045,000**	**367,468**
E	**Saldo e planifikuar e mjeteve financiare**	**5,100,886**	**7,324,581**	**2,223,695**

Tabela 28. Buxheti i planifikuar i qarkullimit të parasë për vitin 2027.

Plani i rrjedhës së parasë për vitin 2027 parashikon saldo fillestare të mjeteve monetare prej 5,100,886 €, e cila përputhet me saldon përfundimtare të planifikuar për vitin 2026. Hyrjet e përgjithshme operative planifikohen në 7,305,986 €, duke përfshirë arkëtimet nga aktiviteti operativ prej 6,156,046 €, arkëtimet tjera prej 149,940 € dhe arkëtimin e llogarive të arkëtueshme prej 1,000,000 €.

Daljet e planifikuara operative arrijnë në 4,037,291 €, prej të cilave 1,663,116 € për paga, 1,733,083 € për shpenzime operative në deponi, 341,092 € për shpenzime administrative dhe 300,000 € rezervë për shpenzime të paparashikuara. Pas mbulimit të këtyre daljeve, teprica e planifikuar nga aktiviteti operativ është 3,268,695 €.

Për investime kapitale dhe rezervën përkatëse parashikohen gjithsej 1,045,000 €, nga të cilat 745,000 € për investime dhe 300,000 € për kontingjencë kapitale. Pas përfshirjes së këtyre shumave, rritja neto e mjeteve monetare gjatë vitit 2027 planifikohet në 2,223,695 €, duke e çuar saldon përfundimtare në 7,324,581 €.

Projeksioni paraqet kapacitet për mbulimin e daljeve operative dhe investimeve të planifikuara. Realizimi i tij mbështetet në përmbushjen e objektivave të arkëtimit, veçanërisht të kërkesave të bartura, si dhe në respektimin e kufijve të planifikuar të shpenzimeve dhe investimeve.

Rezervat dhe kufizimet e përdorimit të parasë

Sipas tabelës 28, rezerva për shpenzime të paparashikuara operative rritet nga 250.000 € në vitin 2026 në 300.000 € në vitin 2027. Edhe kontingjenca kapitale rritet nga 250.000 € në 300.000 €. Shtesa është 50.000 € për secilën rezervë; ato kanë qëllime të ndryshme dhe nuk shkëmbehen pa vendim.

Rezerva operative 300.000 € është tashmë pjesë e totalit të planifikuar 4.037.291 € dhe përkon me pjesën e rezervuar brenda shpenzimeve të tjera. Ajo nuk i shtohet edhe një herë PASH-it. Kontingjenca kapitale është jashtë këtij totali dhe shtohet vetëm në planin e daljes së parasë për investime: 745.000 € + 300.000 € = 1.045.000 €.

Rezerva operative përfaqëson rreth 7,43% të shpenzimeve operative, ndërsa kontingjenca kapitale rreth 40,27% të investimeve vetanake 2027. Niveli i dytë është material dhe kërkon ndarje sipas rrezikut të çmimeve, ndërhyrjeve të paparashikuara dhe pasigurisë së projektimit; nuk është shtesë automatike në çdo kontratë. Çdo përdorim kërkon përshkrim të nevojës, preventiv, konfirmim të burimit dhe vendim sipas kompetencës.

Në raportimin financiar real, mbajtja e rezervës buxhetore nuk mjafton për njohjen e një shpenzimi ose provizioni. Shpenzimi njihet sipas natyrës dhe periudhës kur krijohet detyrimi përkatës. Mjetet e papërdorura mbeten para të disponueshme ose të destinuara, sipas kushteve; ato nuk raportohen si të shpenzuara vetëm sepse ishin planifikuar.

Projeksioni i parasë supozon arkëtimin e të hyrave të planifikuara të vitit dhe 1.000.000 € nga kërkesat e bartura. Arkëtimi i borxhit të vjetër nuk është e hyrë e re në PASH. Buxheti i provizioneve nuk zbritet si pagesë, sepse është zë jomonetar. Tatimet dhe çdo diferencë ndërmjet faturimit e arkëtimit trajtohen në parashikimin mujor të thesarit; saldoja 7.324.581 € nuk interpretohet si para e lirë për investim pa këto kontrolle dhe pa kufizimet e llogarisë së veçantë.

Tabela 29. Struktura e planifikuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre për vitin 2027.

Informacion shtesë – Struktura e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre

Përshkrimi	Gjendja më 01.01.2027 (€)	Ndryshimet gjatë vitit 2027 (€)	Gjendja e planifikuar më 31.12.2027 (€)
Llogaria e veçantë – Programi KfW	3,900,000	2,100,000	6,000,000
Llogaria rrjedhëse	1,200,886	123,695	1,324,581
Gjithsej mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	**5,100,886**	**2,223,695**	**7,324,581**

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre parashikohet të rriten nga 5,100,886 € në fillim të vitit 2027 në 7,324,581 € në fund të vitit, duke shënuar rritje neto prej 2,223,695 €, ose rreth 43.6%.

Në strukturën e planifikuar, llogaria e veçantë e Programit KfW parashikohet të rritet nga 3,900,000 € në 6,000,000 €, ndërsa llogaria rrjedhëse nga 1,200,886 € në 1,324,581 €. Në fund të vitit, këto llogari do të përfaqësojnë përkatësisht rreth 81.9% dhe 18.1% të mjeteve monetare të përgjithshme.

Rreth 94.4% e rritjes neto të planifikuar përqendrohet në llogarinë e Programit KfW, ndërsa llogaria rrjedhëse rritet me 123,695 €, ose rreth 10.3% kundrejt gjendjes fillestare. Për këtë arsye, planifikimi i likuiditetit për aktivitetin e zakonshëm duhet të mbështetet në disponueshmërinë reale të mjeteve dhe afatet e arkëtimeve e pagesave, duke marrë parasysh kushtet e përdorimit të fondeve të Programit KfW.

18.4 Programi II–IV dhe kontributi i KMDK-së në llogarinë e veçantë

Programi për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II–IV përfshin infrastrukturën në Prizren, Gjilan, Pejë, Podujevë, rajonin e Prishtinës, stacionin e transferit në Ferizaj dhe mbylljen e deponisë së Istogut. Objektet dhe fazat shpjegohen në seksionin 13.1. Menaxhimi financiar dallon financimin e jashtëm, kontributet vendore, shërbimet e konsulencës dhe asetet që pranohen nga KMDK-ja.

Tabela 30a. Referencat financiare të programit dhe kufijtë e krahasimit

Burimi ose komponenti	Vlera	Trajtimi në planin 2027–2029
Programi dhe shërbimet e lidhura	54.000.000 €	Referencë e vlerës së programit; nuk paraqitet e gjitha si të hyrë ose dalje vjetore e KMDK-së.
Masa Shoqëruese AMC	850.000 € pas rishikimit nga 1.000.000 €	Shërbime mbështetëse, jo buxhet për makineri. Dokumenti i vjetër jep 54.850.000 € të kombinuara; nuk shtohen përsëri komponentët e përfshirë.
Financimi i jashtëm në tabelën e mëparshme të investimeve	31.336.299 €	Shifër e një tabele me shtrirje dhe periudhë tjetër; profili i pagesave përditësohet sipas kontratave.
Kontributi i Komunës së Pejës	3.000.000 €	Marrëveshja nr. 02-108/01, datë 15.08.2025. Disponueshmëria ndiqet sipas afateve dhe pagesave reale.
Kontributi i KMDK-së	8.000.000 €	Burim vetanak i dedikuar, jo grant i KfW. Ndiqet veçmas në tabelat 30–31.
Totali i tabelës së mëparshme të burimeve	42.336.299 €	31.336.299 + 3.000.000 + 8.000.000. Nuk i shtohet vlerës 54.850.000 €; kërkohet pajtim i përmbajtjes së dy tabelave.

Shumat e mësipërme identifikojnë referencat ekzistuese dhe nuk zëvendësojnë marrëveshjet ose buxhetin e përditësuar të programit. Për çdo paketë, PIU dhe DF mbajnë kontratën, shumën fillestare, ndryshimet e miratuara, financuesin, pjesën e KMDK-së, disbursimin dhe pagesën. Ndarja e saktë ndërmjet punimeve, pajisjeve dhe konsulencës merret nga kjo evidencë; nuk nxirret duke mbledhur tabela me shtrirje të ndryshme.

Grantet për asetet trajtohen sipas kushteve të marrëveshjes dhe politikës kontabël. Kur zbatohet IAS 20, njohja kërkon siguri të arsyeshme për përmbushjen e kushteve dhe pranimin e grantit; efekti në rezultat lidhet sistematikisht me kostot përkatëse. Granti për aset mund të paraqitet si e ardhur e shtyrë ose duke zbritur vlerën kontabël të asetit. Pagesa e drejtpërdrejtë e financuesit te kontraktori nuk është automatikisht hyrje në llogarinë bankare të KMDK-së. Referencë: IFRS Foundation, IAS 20, paragrafët 7, 12 dhe 24, https://www.ifrs.org/issued-standards/list-of-standards/ias-20-accounting-for-government-grants-and-disclosure-of-government-assistance/.

Pershkrimi	2023	2024	2025	2026	2027	Totali
Tonë bazë të skemës; 2027 sasi ekuivalente deri te objektivi	369,462	377,736	415,154	434,238	382,677	1,979,267
Pjesa e tarifës e dedikuar projektit (€/ton)	2	3	4	5	6	
Shitjet e destinuara për llogari te veçantë	738,925	1,133,208	1,660,618	2,171,189	2,296,060	8,000,000
Kumulativi	738,925	1,872,133	3,532,751	5,703,940	8,000,000	

Tabela 30. Të hyrat e dedikuara për investime në programin për Menaxhimin e Mbeturnave të Ngurta II-IV, 2023–2027.

Tabela 30 paraqet skemën e destinimit të një pjese të të hyrave vetanake drejt objektivit kumulativ 8.000.000 €. Për vitet 2023–2025 ajo është referencë historike; 2026 dhe 2027 përmbajnë planifikim. Shuma e shitjeve të destinuara nuk është e barabartë domosdoshmërisht me arkëtimin ose me saldon e bankës.

Vlera 382.677 tonë për 2027 është sasi ekuivalente për plotësimin e objektivit financiar: (8.000.000 € − 5.703.940 €) ÷ 6 €/ton = rreth 382.676,67 tonë. Ajo nuk është projeksioni i përgjithshëm i mbeturinave për vitin 2027 dhe nuk zëvendëson 505.892 tonët e kapitullit 17.

Shuma e dedikuar për ton rritet nga 2 € më 2023 në 6 € më 2027. Kjo është pjesa e tarifës së destinuar për projektin dhe jo tarifa e plotë e shërbimit. Aplikimi i 6 €/ton mbi të gjithë planin 505.892 tonë do të jepte 3.035.352 €, ose 739.292 € më shumë se 2.296.060 € të nevojshme për objektivin; trajtimi i diferencës përcaktohet sipas marrëveshjes dhe vendimit për destinim, jo me njohje të dyfishtë të të hyrave.

Kumulativi 8.000.000 € i tabelës 30 është objektiv i destinimit deri më 2027. Ai nuk dëshmon se e njëjta shumë është arkëtuar, transferuar ose ka mbetur e pashpenzuar në bankë. Tabela 31 parashikon saldon bankare 6.000.000 € në fund të 2027 dhe 8.000.000 € në fund të 2028. Dallimi ndërmjet këtyre dy treguesve shpjegohet dhe rakordohet me evidencën financiare.

Rakordimi financiar ndjek veçmas:

- të hyrat e faturuara dhe pjesën e destinuar për projektin;
- arkëtimet e klientëve dhe transferimet reale në llogarinë e veçantë;
- pagesat e projektit, interesin dhe saldon e mbetur, të mbështetura në dokumentet bankare.

Rritja e saldos nuk përdoret si tregues i vetëm i progresit të investimeve: mund të pasqyrojë grumbullim mjetesh ndërsa punimet ende nuk janë paguar. Raporti i programit paraqet paralelisht progresin fizik, zotimet dhe pagesat.

Projeksioni i llogarisë së veçantë sipas skemës së kontributit

Llogaria e veqante per programin me KFW	Referencë 2025	Vlerësim 2026	Plan 2027	Plan 2028
Saldo Fillestare	945,740	1,400,000	3,900,000	6,000,000
Shtesat Vjetore	454,260	2,500,000	2,100,000	2,000,000
Saldo Perfundimtare	1,400,000	3,900,000	6,000,000	**8,000,000**

Tabela 31. Planifikimi financiar i llogarisë së veçantë për Programin KfW.

Tabela 31 paraqet një skemë të akumulimit të kontributit të KMDK-së; nuk është kalendar i plotë i fluksit të parasë së programit. Ajo nuk përmban rresht të veçantë për pagesat e projektit dhe, në formën e paraqitur, saldoja është saldo fillestare plus shtesat e planifikuara.

Për 2025, referenca paraqet 945.740 € në fillim, 454.260 € shtesë dhe 1.400.000 € në fund. Meqenëse kolona është emërtuar "Referencë 2025", këto shuma nuk etiketohen automatikisht si realizim i audituar pa pasqyrën bankare dhe rakordimin përkatës.

Për 2026, parashikimi është 1.400.000 € + 2.500.000 € = 3.900.000 €. Deri në mbylljen e vitit kjo mbetet vlerë e planifikuar/rishikuar, jo konfirmim i gjendjes përfundimtare.

Për 2027, plani është 3.900.000 € + 2.100.000 € = 6.000.000 €. Shtesa përputhet me ndryshimin e llogarisë së veçantë në tabelën 29 dhe përbën transferim të brendshëm të mjeteve të KMDK-së.

Për 2028, skema parashikon 6.000.000 € + 2.000.000 € = 8.000.000 €. Nëse kryhen pagesa të projektit nga kjo llogari, saldoja faktike ulet për ato pagesa; arritja e kontributit kumulativ nuk kërkon që e gjithë shuma të mbetet e pashpenzuar në bankë.

Diferenca 2.000.000 € ndërmjet objektivit të destinimit 2027 dhe saldos së planifikuar të atij viti nuk mund të klasifikohet e gjitha si borxh i paarkëtuar ose si pagesë projekti pa dokumente. DF përgatit urën: saldo fillestare + transferime + interes dhe hyrje të tjera − pagesa = saldo përfundimtare. Për 2029, plani i llogarisë plotësohet nga kalendari kontraktual i pagesave; nuk supozohet rritje e re ose saldo e pandryshuar pa këtë kalendar.

18.6 Projektet kapitale të financuara nga KMDK

Projektet Kapitale			Projektet Kapitale	Projektet Kapitale	Projektet Kapitale
Nr.	Emri i Projektit	Burimi i financimit	2027	2028	2029
1	Buldozer – 1 copë	KMDK	350,000		
2	Kamion i ri	KMDK	280,000		
3	Pajisje për përpunimin e inerteve	KMDK	0.00	300,000.00	
4	Stacion i motit	KMDK	15,000		
5	Inventar për zyre	KMDK	7,000		
6	Instalimi i Kamerave	KMDK	10,000		
7	Pajisje të TI	KMDK	8,000		10000
8	Gjenerator 4 copë	KMDK	10,000		
9	Automjet i tipit Pick-up	KMDK	65,000		
10	Furnizim me Vetura	KMDK	0.00		90,000.00
	Total		**745,000**	**300,000**	**100,000**

Tabela 32. Projektet kapitale të planifikuara për financim nga KMDK, 2027–2029.

1. **Blerja e një buldozeri me buxhet 350.000 €**

Plani aktual parashikon një buldozer me vlerë buxhetore 350.000 € gjatë vitit 2027, të financuar nga KMDK. Ky është zëri që hyn në totalin 745.000 € të tabelës 32. Qëllimi është sigurimi i kapacitetit për sistemim të mbeturinave dhe materialeve mbuluese, mirëmbajtje të sipërfaqeve dhe vazhdimësi operative. Përzgjedhja mbështetet në ngarkesën reale, gjendjen e flotës dhe planin e furnizimeve të Programit II–IV.

Në tabelën 32 parashihet një buldozer me vlerë 350.000 € për vitin 2027. Për këtë pajisje nuk është paraqitur investim shtesë në vitet 2028 dhe 2029; shpjegimi dhe totali i investimeve mbështeten vetëm në këtë zë.

Para prokurimit krahasohen riparimi, marrja me qira, blerja e përdorur dhe blerja e re, me koston e ciklit jetësor dhe kohën e furnizimit. PIU konfirmon nëse programi i jashtëm parashikon pajisje për të njëjtën nevojë, që të shmanget mbivendosja. Buxheti 350.000 € është kufi planifikimi, jo çmim i kontraktuar; sasia dhe specifikimi përfundimtar mbështeten në vendimin dhe procedurën përkatëse.

2. **Blerja e kamionit të ri – 280,000 €**

Projekti parashikon furnizimin me një kamion të ri për nevojat e transportit në kuadër të veprimtarisë së KMDK-së. Investimi synon të përmirësojë kapacitetin dhe besueshmërinë e transportit, duke mbështetur

realizimin e detyrave operative. Lloji i kamionit, kapaciteti bartës dhe pajisjet përcjellëse do të përcaktohen në përputhje me destinimin dhe kushtet e përdorimit.

3. **Furnizimi me stacion të motit – 15,000 €**

Projekti përfshin furnizimin dhe instalimin e një stacioni meteorologjik për matjen dhe regjistrimin e të dhënave, si temperatura, reshjet, lagështia, shpejtësia dhe drejtimi i erës. Të dhënat do të mbështesin monitorimin mjedisor dhe planifikimin e punëve në deponi sipas kushteve atmosferike. Lokacioni dhe parametrat e matjes do të përcaktohen sipas nevojave të monitorimit.

4. **Furnizimi me inventar për zyre – 7,000 €**

Projekti parashikon blerjen e inventarit të nevojshëm për pajisjen dhe funksionalizimin e hapësirave të punës. Investimi synon përmirësimin e kushteve të punës dhe organizimin më efikas të ambienteve administrative. Furnizimi do të bazohet në evidentimin e mungesave dhe vlerësimin e gjendjes së inventarit ekzistues.

5. **Instalimi i kamerave të sigurisë – 10,000 €**

Projekti parashikon instalimin e kamerave dhe pajisjeve përcjellëse për monitorimin e pikave të hyrjes dhe daljes, hapësirave operative dhe zonave ku ruhen asetet e kompanisë. Investimi synon të përmirësojë mbikëqyrjen dhe dokumentimin e incidenteve. Numri i kamerave dhe shtrirja e sistemit do të përcaktohen pas vlerësimit të nevojave të sigurisë në lokacionet përkatëse.

6. **Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative – 8,000 €**

Projekti përfshin blerjen ose zëvendësimin e pajisjeve të TI-së për mbështetjen e proceseve administrative dhe operative. Investimi synon të përmirësojë përpunimin e të dhënave, raportimin dhe funksionimin e sistemeve të përdorura nga kompania. Lista e pajisjeve do të përcaktohet sipas nevojave të përdoruesve, gjendjes së pajisjeve ekzistuese dhe kërkesave të përputhshmërisë teknike.

7. **Furnizimi me katër gjeneratorë – 10,000 €**

Projekti parashikon blerjen e katër gjeneratorëve, me vlerë të përgjithshme prej 10,000 €, për sigurimin e furnizimit rezervë me energji elektrike. Gjeneratorët do të mbështesin funksionimin e pajisjeve esenciale gjatë ndërprerjeve të energjisë. Fuqia dhe shpërndarja e tyre do të përcaktohen sipas ngarkesës elektrike dhe nevojave të secilit lokacion.

8. **Blerja e automjetit të tipit pick-up – 65,000 €**

Projekti parashikon blerjen e një automjeti të tipit pick-up për lëvizjen e ekipeve në terren dhe transportin e veglave e pajisjeve të punës. Investimi synon të lehtësojë qasjen në deponi dhe ndërhyrjet operative, veçanërisht në rrugë me kushte të vështira. Karakteristikat teknike do të përcaktohen sipas terrenit, ngarkesës dhe natyrës së detyrave.

Pajisja për përpunimin e inerteve më 2028

Investimi 300.000 € në vitin 2028 lidhet me projektin MNRR të seksionit 13.2.6. Përpara furnizimit verifikohen materiali hyrës, kapaciteti, lloji i pajisjes, shërbimi pas shitjes dhe kostoja e lokacionit e operimit. Për vitin 2029, investimet vetanake 100.000 € përbëhen nga 90.000 € për vetura dhe 10.000 € për TI; furnizimi me vetura nuk ka vlerë të planifikuar për vitin 2027. Këto furnizime nuk janë të hyra të reja dhe zhvlerësimi i tyre nis sipas datës së vënies në përdorim.

19. Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi

Monitorimi i planit bazohet në një burim të përcaktuar të të dhënave, pronar, afat dhe prag veprimi. Raporti nuk kufizohet në përshkrimin e aktivitetit por krahason planin me realizimin, shpjegon devijimin, tregon ndikimin dhe emërton veprimin korrigjues.

19.2 Mekanizmi i rishikimit vjetor

- Çdo fund viti, KMDK kryen një rishikim të plotë të performancës duke analizuar realizimin e objektivave dhe performancën kundrejt KPI-ve.
- Rishikimi përfshin inpute nga auditimet e brendshme, rishikimet menaxheriale dhe konsultimet me palët e interesit.

- Rezultatet e rishikimit shërbejnë si bazë për përcaktimin e objektivave për vitin pasues dhe për përmirësimin e planeve strategjike.

19.3 Raportimi te aksionarët dhe palët e interesit

- Raportim periodik përmes raporteve tremujore dhe vjetore që përfshijnë performancën financiare, operacionale dhe mjedisore.
- Transparencë ndaj komunave dhe institucioneve qendrore, duke ndarë rezultatet dhe sfidat kryesore.
- Angazhim me komunitetin përmes publikimit të rezultateve në faqen zyrtare të KMDK-së, organizimit të takimeve publike dhe aktiviteteve informuese.

20. Përmbyllje

Plani i Biznesit 2027–2029 përcakton veprimet për vazhdimësinë e shërbimeve, përmirësimin e kushteve në deponi dhe zhvillimin e investimeve të KMDK-së. Zbatimi mbështetet në përgjegjësi të qarta, buxhet të miratuar, financim të dokumentuar dhe raportim të rezultateve. Aktivitetet përgatitore dhe investimet e kushtëzuara ndiqen veçmas nga kontratat dhe punët e realizuara.

KMDK hyn në këtë periudhë të re me një bazë të fortë organizative dhe profesionale, me fokus në zbatimin e programeve të mëdha kapitale, digjitalizimin e proceseve, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe përfshirjen në ekonominë qarkore. Përmes implementimit të standardeve ndërkombëtare ISO, forcimit të qeverisjes korporative dhe orientimit drejt inovacionit, kompania synon të sigurojë një transformim të qëndrueshëm dhe të prekshëm për komunitetet që shërben.

Ky plan nuk është vetëm një dokument teknik, por një zotim institucional për një Kosovë më të pastër, më të gjelbër dhe më të drejtë ku mbeturinat trajtohen si burim dhe jo si problem, dhe ku përgjegjësia mjedisore shndërrohet në kulturë shoqërore dhe vlerë ekonomike.

Shtojca 1. Plani i Veprimit 2027–2029

Veprimet prioritare

Kodi	Aktiviteti	Prioriteti / objektivi	Rezultati i pritshëm	Përgjegjësit	Periudha
A01	Operimi dhe raportimi për shërbimet	PS1 / OS1	Raporte mujore për sasitë, kapacitetet, sigurinë dhe nevojat për ndërhyrje.	DO	2027–2029
A02	Mirëmbajtja dhe plotësimi i nevojave për makineri e pajisje	PS1 / OS1	Plan mirëmbajtjeje, evidencë e ndërhyrjeve dhe furnizime sipas buxhetit e procedurave përkatëse.	DO / Prokurimi / DF	2027–2029
A03	Marrja në menaxhim e deponive të Pejës dhe Zveçanit	PS1 / OS1	Marrëveshjet, përgjegjësitë, personeli dhe kushtet e operimit të qartësuara. Afatet e transferimit harmonizohen me institucionet përkatëse.	Menaxhmenti / DO / DF / DShM	2027
A04	Monitorimi mjedisor dhe përmbushja e kushteve të lejeve	PS1 / OS2	Evidencë e lejeve dhe afateve; monitorim dhe mostra të ujërave sipas kërkesave përkatëse; masa për mangësitë e identifikuara.	Eksperti mjedisor dhe social / DO / Zyra Ligjore	2027–2029
A05	Menaxhimi i ujërave, siguria nga gazi dhe masat ndaj rreziqeve klimatike	PS1 / OS1 / OS2	Kontrolle të pajisjeve dhe matje të gazit; mirëmbajtje e kullimit dhe sistemeve të ujërave; vlerësim i rreziqeve të motit dhe masa sipas përparësisë.	DO / Eksperti mjedisor dhe social	2027–2029
A06	Zbatimi i Programit II–IV dhe projekti i deponisë së re të Prishtinës	PS2 / OS3	Ndjekja e projektimit, lejeve, punimeve dhe përgatitjes për operim sipas fazave e marrëveshjeve të projektit; raportim mujor për veprimet e KMDK-së.	PIU / DPZh / DO	2027–2029
A07	Rehabilitimi i Pejës dhe mbyllja e rehabilitimi i Tuçepit e Mirashit	PS2 / OS3	Pejë gjatë 2027–2028 dhe Tuçep gjatë 2027–2028 sipas paketave të programit; Mirash gjatë 2027–2029 me masa, projekt mbylljeje dhe zbatim sipas financimit e kapacitetit alternativ.	PIU / DO / DPZh	2027–2029
A08	Përgatitja e projektit për zyrën qendrore	PS2 / OS3	Analiza e nevojës dhe alternativës ndërtim/qira, lokacioni, preventivi dhe kërkesa për financim; ndërtimi vetëm pas miratimit të buxhetit.	Menaxhmenti / DPZh / DF / Prokurimi	2027–2028
A09	Zhvillimi i projekteve për RDF, MBT dhe mbeturinat nga ndërtimi e demolimi	PS2 / OS3	2027: karakterizim dhe analiza e flukseve; 2028: krahasim MBT/RDF dhe përgatitja/furnizimi i pajisjes MNRR sipas buxhetit; 2029: vendim financimi dhe pilot sipas kushteve.	DPZh / DO / DF	2027–2029
A10	Vlerësimi i mundësive për menaxhimin e stacioneve të transferit	PS2 / OS3	Vlerësim i nevojave dhe propozime për institucionet përkatëse, me kostot dhe përgjegjësitë e menaxhimit.	DPZh / DO / Menaxhmenti	2027–2028
A11	Vlerësimi i shfrytëzimit të gazit të deponive për energji	PS2 / OS3	Studim i mundësive teknike dhe financiare, i mbështetur në matje; propozim për hapat e mëtejshëm sipas rezultateve dhe financimit.	DPZh / DO / DF	2027–2029

Kodi	Aktiviteti	Prioriteti / objektivi	Rezultati i pritshëm	Përgjegjësit	Periudha
A12	Përgatitja e projekteve, studimeve dhe aplikimeve për financim	PS2 / OS3	Konceptet, studimet dhe aplikimet prioritare, përfshirë pikën ndarëse, Mitrovicën dhe organiket sipas 13.2; deri në dy studime dhe një aplikim kryesor paralel pa mbështetje shtesë.	DPZh / DF	2027–2029
A13	Arkëtimi, kontrolli i shpenzimeve dhe planifikimi i parasë	PS3 / OS4	Raporte mujore plan–realizim, ndjekje e arkëtimit dhe parashikim i pagesave e nevojave financiare.	DF	2027–2029
A14	Rishikimi i buxhetit dhe projeksioneve financiare	PS3 / OS4	Projeksione të përditësuara sipas sasive, tarifave, kostove dhe investimeve; rishikim vjetor dhe kur ka ndryshime të rëndësishme.	DF / DPZh	2027–2029
A15	Ndjekja e rreziqeve, kontratave, kontesteve dhe detyrimeve të mundshme	PS3 / OS4	Regjistër i përditësuar i rreziqeve dhe lëndëve; shqyrtim i akteve e kontratave sipas përgjegjësive; ndjekje e afateve dhe vlerësim juridik e financiar i detyrimeve.	Zyra Ligjore / DF / DO	2027–2029
A16	Planifikimi i stafit dhe plotësimi i pozitave të nevojshme	PS3 / OS5	Vlerësim i nevojave për staf dhe rekrutim për pozitat e miratuara e të financuara.	DShM / DF / Njësitë përkatëse	2027–2029
A17	Zbatimi i planit të trajnimeve dhe vizitave studimore	PS3 / OS5	20 aktivitete më 2027, 15 më 2028 dhe 13 më 2029; gjithsej 48, sipas rreshtave të Shtojcës 3. Evidencë e kostos, pjesëmarrjes dhe realizimit.	DShM / Departamentet	2027–2029
A18	Zbatimi i sistemeve të menaxhimit dhe standardeve ISO	PS3 / OS5	Përgatitje dhe zbatim për ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001. Certifikimi ndiqet sipas gatishmërisë; sistemet e zbatuara mirëmbahen dhe rishikohen.	Zyrtari i certifikimeve / Njësitë përkatëse	2027–2029
A19	Digjitalizimi dhe rakordimi i të dhënave operative e financiare	PS3 / OS5	Përmirësim i regjistrimeve dhe kontroll i përputhjes ndërmjet peshimit, faturimit e raportimit; prova fillestare më 2027 dhe zbatim gradual më pas.	IT / DF / DO	2027–2029
A20	Komunikimi me publikun dhe aktivitetet edukative mjedisore	PS3 / OS5	Informim për mandatin, shërbimet dhe rezultatet e KMDK-së; aktivitete edukative të planifikuara më 2027 dhe ndjekje e planit të komunikimit gjatë periudhës.	DPZh / Zyrtari për Komunikim / IT	2027–2029
A21	Bashkëpunimi me komunitetin dhe zbatimi i masave sociale	PS3 / OS5	Regjistër dhe trajtim i ankesave; informim i komuniteteve dhe ndjekje e masave sociale të miratuara, përfshirë rikthimin e mjeteve të jetesës kur kërkohet.	DPZh / Eksperti mjedisor dhe social / DO	2027–2029
A22	Harmonizimi, miratimi dhe zbatimi i draft-rregulloreve të brendshme	PS3 / OS5	Shqyrtim dhe paraqitje për miratim gjatë 2027 te organi kompetent; njoftim i stafit dhe zbatim pas miratimit; ndjekje dhe rishikim sipas nevojës më 2028–2029.	Zyra Ligjore / Njësitë përgjegjëse / Menaxhmenti	2027–2029
A23	Rishikimi dhe raportimi i zbatimit të Planit të Biznesit	PS3 / OS5	Rishikim vjetor në TM4; 2 raporte progresi më 2027 (TM2 dhe TM4) dhe 4 raporte në vit më 2028–2029, sipas matricës së treguesve.	DPZh / DF / Të gjitha njësitë	2027–2029

Tabela 33. Plani i Veprimit 2027–2029: aktivitetet, rezultatet, treguesit dhe njësitë përgjegjëse.

Shtojca 2. Afatet e zbatimit sipas tremujorëve

Kodi	Aktiviteti	TM1 2027	TM2 2027	TM3 2027	TM4 2027	TM1 2028	TM2 2028	TM3 2028	TM4 2028	TM1 2029	TM2 2029	TM3 2029	TM4 2029
A01	Operimi dhe raportimi për shërbimet	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A02	Mirëmbajtja dhe plotësimi i nevojave për makineri e pajisje	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A03	Marrja në menaxhim e deponive të Pejës dhe Zveçanit	•	•	•	•								
A04	Monitorimi mjedisor dhe përmbushja e kushteve të lejeve	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A05	Menaxhimi i ujërave, siguria nga gazi dhe masat ndaj rreziqeve klimatike	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A06	Zbatimi i Programit II–IV dhe projekti i deponisë së re të Prishtinës	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A07	Rehabilitimi i Pejës dhe mbyllja e rehabilitimi i Tuçepit e Mirashit	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A08	Përgatitja e projektit për zyrën qendrore	•	•	•	•	•	•	•	•				
A09	Zhvillimi i projekteve për RDF, MBT dhe mbeturinat nga ndërtimi e demolimi	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A10	Vlerësimi i mundësive për menaxhimin e stacioneve të transferit	•	•	•	•	•	•	•	•				
A11	Vlerësimi i shfrytëzimit të gazit të deponive për energji	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A12	Përgatitja e projekteve, studimeve dhe aplikimeve për financim	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A13	Arkëtimi, kontrolli i shpenzimeve dhe planifikimi i parasë	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A14	Rishikimi i buxhetit dhe projeksioneve financiare			•	•			•	•			•	•
A15	Ndjekja e rreziqeve, kontratave, kontesteve dhe detyrimeve të mundshme	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A16	Planifikimi i stafit dhe plotësimi i pozitave të nevojshme	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A17	Zbatimi i planit të trajnimeve dhe vizitave studimore	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A18	Zbatimi i sistemeve të menaxhimit dhe standardeve ISO	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A19	Digjitalizimi dhe rakordimi i të dhënave operative e financiare	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•

Kodi	Aktiviteti	TM1 2027	TM2 2027	TM3 2027	TM4 2027	TM1 2028	TM2 2028	TM3 2028	TM4 2028	TM1 2029	TM2 2029	TM3 2029	TM4 2029
A20	Komunikimi me publikun dhe aktivitetet edukative mjedisore	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A21	Bashkëpunimi me komunitetin dhe zbatimi i masave sociale	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A22	Harmonizimi, miratimi dhe zbatimi i draft-rregulloreve të brendshme	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•	•
A23	Rishikimi dhe raportimi i zbatimit të Planit të Biznesit		•		•	•	•	•	•	•	•	•	•

Tabela 34. Afatet tremujore të zbatimit të Planit të Veprimit 2027–2029 (Gantt).

Shtojca 3. Plani i trajnimeve 2027–2029

Plani përmban trajnime të përcaktuara nga departamentet e KMDK-së. Trajnimet teknike ose të detyrueshme që mund të lindin gjatë vitit aktivizohen vetëm me analizë të dokumentuar dhe brenda buxhetit të miratuar.

Viti	Trajnimi	Pozitat	Rezultati i synuar	Buxheti €
BNj				
2027	Komunikimi Profesional, Sjellja Kolegiale dhe Menaxhimi i lKonflikteve	Të gjitha pozitat	Komunikim dhe menaxhim i situatave konfliktuoze	700
2027	Menaxhimi i Dokumenteve, Arkivimi dhe Administrimi Elektronik	Të gjitha pozitat	Sistemim, ruajtje dhe arkivim i dokumenteve	600
2027	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, AI dhe Legjislacioni i Punës	BNj dhe Zyra Ligjore	Procedurat e BNj-së, legjislacioni i punës dhe përdorimi i mbikëqyrur i AI	800
2028	Menaxhimi i Stresit, Komunikimi Profesional dhe Sjellja Kolegiale në Vendin e Punës	Ligjore, BNj, Asete dhe Asistentët Administrativë	Menaxhim i ngarkesës, bashkëpunim dhe parandalim i konfliktit	800
2028	Menaxhimi i Aseteve, Inventarit dhe Kontrollit të Pasurisë	Asete, IT, BNj dhe Asistentët Administrativë	Evidentim, inventarizim, transferim dhe kontroll i aseteve	700
2028	Rekrutimi, Përzgjedhja dhe Menaxhimi i Performancës së Punonjësve	BNj dhe Zyra Ligjore	Intervistim, vlerësim dhe menaxhim performance	800
2029	Siguria Kibernetike dhe Mbrojtja e të Dhënave	Të gjitha pozitat, me fokus IT	Phishing, mbrojtja e sistemeve dhe reagimi ndaj incidenteve	800
2029	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Zhvillimi Profesional dhe Planifikimi i Trajnimeve	BNj dhe Zyra Ligjore	Planifikimi i nevojave, zhvillimi i karrierës dhe motivimi	800
DPZH				
2027	Trajnim për ciklin e zhvillimit dhe menaxhimit te projekteve	Të gjitha pozitat	Rritje profesionale	1000
2027	Trajnim për shkrim të projekteve	Të gjitha pozitat	Rritje profesionale dhe ndikim direkt tek KMDK	1900

Viti	Trajnimi	Pozitat	Rezultati i synuar	Buxheti €
2027	Trajnim për përpilim të Planit të Biznesit	Të gjitha pozitat	Rritje profesionale dhe ndikim direkt tek KMDK	2100
2028	Trajnimi për kompozicionin e mbeturinave	Të gjitha pozitat	Rritje profesionale	2500
2028	Trajnimi për de-gazifikim te deponive.	Të gjitha pozitat	Rritje profesionale	1500
2029	Trajnimi për ndarje të mbeturinave	Të gjitha pozitat	Rritje profesionale	1000
		Operimet		
2027	Certifikatat per vozitje te makinerive te renada	Manipulues	Rritje profesionale	12,000
2027	Trajnimi per Perdorimin e PPM dhe Menaxhimin e Rreziqeve	Punotret e Deponive Sanitare	Rritje profesionale	5000
2027	Trajnimi per Sigurine gjate Operimit me Makineri te Renda dhe Levizjen në Deponi	Manipuluesit	Rritje profesionale	10,000
2027	Urematesit per sis elektronik, edhe trajnime baze per word edhe exel.	Punotoret e Deponive	Rritje profesionale	7000
		Financat		
2027	Menaxhimi dhe administrimi i aseteve/pasurisë publike	Zyrtar për Menaxhimin e Aseteve	Regjistri i aseteve, inventarizimi, transferimi, nxjerrja jashtë përdorimit, kontrolli i aseteve	300
2027	IPSAS – Kontabiliteti dhe raportimi financiar në sektorin publik	Zyrtar për Menaxhimin e Aseteve	IPSAS 16, 17, 19, 27, 31 dhe trajtimi i aktiveve/provizioneve	250
2028	Kontrolli i brendshëm dhe auditimi i menaxhimit të aseteve	Zyrtar për Menaxhimin e Aseteve	Planifikimi, optimizimi dhe përdorimi efikas i aseteve	300
2028	Menaxhimi strategjik i pasurisë publike	Zyrtar për Menaxhimin e Aseteve	Kontrollet, inventarizimi, risku dhe rekomandimet e auditimit	220
2029	Menaxhimi digjital i aseteve dhe sistemi i regjistrit të aseteve	Zyrtar për Menaxhimin e Aseteve	Digjitalizimi, barcode/QR, databaza dhe raportimi	320
2029	IPSAS/IFRS – Raportimi financiar dhe pasqyrat financiare	Zyrtar për Menaxhimin e Aseteve	Lidhja e regjistrit të aseteve me pasqyrat financiare	320
2027	Raportimi Financiar dhe Analiza Financiare	Analist financiar	Zhvillimi i aftësive për analizimin e treguesve financiarë, krahasimin e rezultateve financiare, analizimin e kostove dhe devijimeve dhe përgatitjen e analizave për mbështetjen e vendimmarrjes së menaxhmentit.	300

Viti	Trajnimi	Pozitat	Rezultati i synuar	Buxheti €
2027	Planifikimi Buxhetor dhe Ekzekutimi i Buxhetit	Analist financiar	Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të Analistit Financiar në procesin e planifikimit buxhetor, përgatitjen e buxhetit, monitorimin e realizimit të tij dhe analizimin e devijimeve ndërmjet planifikimit dhe realizimit.	220
2028	Menaxhimi Strategjik Financiar	Analist financiar	Zhvillimi i kapaciteteve të Analistit Financiar për të analizuar ndikimin financiar të vendimeve të menaxhmentit, për të vlerësuar performancën dhe për të kontribuar në planifikimin financiar afatmesëm dhe strategjik.	350
2028	Trajnim i avancuar në Excel për Financë	Analist financiar	Të zhvillosh aftësi të avancuara në Excel për përpunimin, analizimin dhe prezantimin e të dhënave financiare. Si analist financiar, Excel është një nga mjetet kryesore që do të përdorësh në punën e përditshme.	250
2029	IPSAS / Standardet e Kontabilitetit në Sektorin Publik	Analist financiar	Të zhvillohen njohuritë dhe aftësitë profesionale për zbatimin e standardeve IPSAS në përgatitjen, analizimin dhe raportimin e informacionit financiar në institucionet e sektorit publik.	300
2029	Trajnim në Modelimin Financiar	Analist financiar	Të mësosh se si të ndërtosh një model financiar profesional që mund të përdoret për të analizuar performancën e një kompanie dhe për të parashikuar rezultatet e saj financiare në të ardhmen.	300
2027	Menaxhimi dhe kontrolli i shpenzimeve dhe faturave	Zyrtare për Shpenzime	Forcimi i njohurive për kontrollin, verifikimin, regjistrimin dhe përcjelljen e faturave dhe shpenzimeve.	220
2027	Kontrolli i brendshëm financiar dhe parandalimi i parregullsive në shpenzime	Zyrtare për Shpenzime	Forcimi i kontrolleve financiare dhe identifikimi/parandalimi i gabimeve dhe parregullsive.	220
2028	Kontabiliteti praktik dhe regjistrimi i transaksioneve financiare	Zyrtare për Shpenzime	Përmirësimi i aftësive praktike në regjistrimin dhe kontrollin e transaksioneve financiare.	300
2028	Menaxhimi i obligimeve, pagesave dhe detyrimeve ndaj furnitorëve	Zyrtare për Shpenzime	Rritja e efikasitetit në administrimin e obligimeve dhe kontrollin e pagesave.	300
2029	Raportimi financiar dhe analiza e shpenzimeve	Zyrtare për Shpenzime	Zhvillimi i aftësive për përgatitjen dhe analizimin e raporteve të shpenzimeve.	350
2029	Auditimi financiar, përgatitja e dokumentacionit dhe bashkëpunimi me auditorët	Zyrtare për Shpenzime	Përgatitja profesionale për auditime dhe administrimin e dokumentacionit financiar.	350
2027	Trajnim për Faturimin dhe Menaxhimin e Faturave të Shitjes	Zyrtare për të hyra	Të sigurohet që faturat e shitjes të përgatiten dhe regjistrohen në mënyrë të saktë dhe që të dhënat e faturimit të jenë të sakta për qëllime të kontabilitetit dhe arkëtimit.	250
2027	Menaxhimi i Llogarive të Arkëtueshme	Zyrtare për të hyra	Të zhvillohen njohuritë dhe aftësitë për menaxhimin e saktë të llogarive të arkëtueshme dhe monitorimin e hyrjeve nga klientët.	300
2028	Përdorimi i sistemeve elektronike për menaxhimin e të hyrave	Zyrtare për të hyra	Zhvillimi i aftësive për përdorimin e sistemeve dhe raportimit elektronik	350
2028	Kontrolli i brendshëm dhe menaxhimi i rrezikut financiar	Zyrtare për të hyra	Forcimi i kontrollit dhe zvogëlimi i rreziqeve në menaxhimin e të hyrave	300

Viti	Trajnimi	Pozitat	Rezultati i synuar	Buxheti €
2029	Analiza financiare dhe parashikimi i të hyrave	Zyrtare për të hyra	Përmirësimi i analizës dhe parashikimit të të hyrave	300
2029	Trajnim për Excel të Avancuar për Financë	Zyrtare për të hyra	Të aftësohet zyrtari për të analizuar një numër të madh faturash dhe klientësh dhe për të përgatitur raporte të sakta mbi të hyrat dhe llogaritë e arkëtueshme.	250
2027	Menaxhimi Strategjik Financiar dhe Planifikimi Buxhetor	ZKFTH	Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive dhe aftësive profesionale në fushën e menaxhimit strategjik financiar, planifikimit dhe monitorimit të buxhetit, analizës së të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe përdorimit të të dhënave financiare për marrjen e vendimeve menaxheriale.	300
2027	Menaxhimi i Thesarit, Likuiditetit dhe Fluksit të Parasë	ZKFTH	Qëllimi i trajnimit është zhvillimi i kompetencave profesionale për menaxhimin efektiv të mjeteve financiare, planifikimin dhe kontrollin e fluksit të parasë, menaxhimin e likuiditetit dhe planifikimin e obligimeve dhe pagesave.	300
2028	Kontrolli i Brendshëm, Auditimi dhe Menaxhimi i Rrezikut Financiar	ZKFTH	Qëllimi i këtij trajnimi është forcimi i njohurive mbi sistemet e kontrollit të brendshëm, identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve financiare, parandalimin e parregullsive dhe përmirësimin e procedurave të kontrollit financiar.	300
2028	Prokurimi Publik dhe Menaxhimi Financiar i Kontratave	ZKFTH	Qëllimi i trajnimit është avancimi i njohurive mbi ndërlidhjen ndërmjet planifikimit financiar, procesit të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave.	350
2029	Raportimi Financiar, IFRS dhe Analiza e Pasqyrave Financiare	ZKFTH	Qëllimi i këtij trajnimi është përmirësimi i njohurive dhe aftësive për përgatitjen, interpretimin dhe analizën e pasqyrave financiare.	300
2029	Digjitalizimi i Menaxhimit Financiar dhe Analiza e të Dhënave	ZKFTH	Qëllimi i trajnimit është avancimi i aftësive në përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale për menaxhimin financiar, automatizimin e proceseve të raportimit dhe analizën e të dhënave financiare.	350

Tabela 35. Plani i trajnimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve për periudhën 2027–2029.

Aprovoi:

Mirjeta Heta
Kryesuese e Bordit të Përkohshëm